

Njegosh

**Mal i Zi
Enti i Shkollimit**

PROGRAMI I LËNDËS MËSIMORE

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
Për vitin I, II, III dhe IV të gjimnazit

Podgoricë, 2019

A. PËRKUFIZIMI I LËNDËS

a) Pozita, natyra dhe qëllimi i lëndës

Lënda gjuhë shqipe dhe letërsi në gjimnazin e përgjithshëm është lëndë mësimore e detyrueshme katërvjeçare dhe nxënësit i nënshtrohen provimit të pjekurisë (maturës) nga kjo lëndë. Kjo është lëndë më e rëndësishme mësimore e detyrueshme në shkollën fillore dhe të mesme, sepse ajo zhvillon aftësitë e përgjithshme intelektuale dhe psiko-emocionale. Ajo ka një rëndësi të veçantë në programin mësimor për shkak se aftësitë që zhvillohen në këtë rast janë të nevojshme edhe në të gjitha lëndët e tjera.

Lënda gjuhë shqipe dhe letërsi përfshin dy fusha njësoj të rëndësishme: mësimin e gjuhës dhe mësimin e letërsisë. Nxënësi aftësohet për të komunikuar në mënyrë të qartë, të kuptueshme, korrekte dhe funksionale me gojë dhe me shkrim në gjuhën standarde shqipe, në rrethana të ndryshme. Duke mësuar gjuhën shqipe nxënësit zotërojnë kompetencat gjuhësore të komunikimit dhe marrin bazat e kompetencave të leximit, medias, informatës dhe interkulturalizmit, që është një parakusht për zhvillimin e personalitetit, arsimim të suksesshëm dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Me kurrikulën e lëndës inkurajohet zhvillimi i veprimtarive gjuhësore të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit dhe zotërimi i tyre që arrihet me pranimin, të kuptuarit, të vlerësuarit dhe krijimin e teksteve me gojë dhe me shkrim. Vlerësohen fazat njohëse dhe gjuhësore të zhvillimit të nxënësve dhe inkurajohet realizimi i plotë i potencialit të tyre.

Duke mësuar për letërsinë nxënësi merr njohuri teoriko-letrare dhe zhvillon shkathtësinë e interpretimit të tekstit. Duke receiptuar vepra letrare nxënësit zhvillojnë ndjenjat emocionale dhe estetike, imagjinatën, pasurojnë imazhin e vet mbi botën, thellojnë njohuritë për veten dhe për njerëzit e tjerë, krijojnë shprehitë e leximit dhe formojnë shijen estetike. Letërsia shpreh mesazhe dhe ide universale, kështu që për studentët takimi me letërsinë kombëtare dhe botërore është burim i njohurive, përvojës dhe vlerave.

Mësimi i lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë kontribuon që nxënësi të zhvillohet si një personalitet i pavarur, i lirë, krijues dhe me kulturë, i vetëdijshëm për identitetin e vet personal dhe kombëtar. Nxënësi edukohet për ta vlerësuar kulturën dhe gjuhën e tij, si dhe gjuhën e popujve pakicë në mjedisin e vet dhe trashëgiminë e përgjithshme gjuhësore dhe kulturore të njerëzimit.

Nxënësi nxitet që arritjet e nxëna t'i zbatojë dhe të fusë në veprim në jetën e përditshme dhe në bashkëveprim me individë, komunitete dhe kulturën në përgjithësi.

b) Numri i orëve dhe format e mësimdhënies

Lënda mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi mësohet gjatë katër vjetëve të mësimimit në gjimnazin e përgjithshëm me 4 orë në javë, dmth me gjithsej 140 orë në vit: I, II dhe III dhe 128 orë në vitin IV, të shpërndara në 35 javë pune (32 javë pune në vitin IV).

Për arritjen e rezultateve të detyrueshme të programit janë të parashikuara 126 orë në vitin e parë, të dytë dhe të tretë dhe 115 orë në vitin e katërt (90% e fondit të përgjithshëm të mësimdhënies), kurse për realizimin e rezultateve të planifikuara në shkollë 14 orë në vitin e parë, të dytë dhe të tretë dhe 13 orë në vitin e katërt (10% e fondit të përgjithshëm mësimor).

Vitet	Gjithsej orë në javë	Numri i orëve – pjesa e obligueshme	Numri i orëve – pjesa e hapur	Gjithsej orë	Mësimi teorik	Ushtrime dhe forma të tjera të mësimimit
I	4	126	14	140	56	84
II	4	126	14	140	56	84
III	4	126	14	140	56	84
IV	4	115	13	128	48	80

Për mësimin e gjuhës janë të parapara 40% e orëve, kurse për mësimin e letërsisë 60% e orëve. Për çdo vit ekziston një pjesë e programit që e krijon mësimdhënësi në përputhje me nevojat e nxënësve me të cilët punon dhe në bashkëpunim me komunitetin lokal ku ndodhet shkolla. Ky fond përfshin deri në 10% të numrit të përgjithshëm të orëve të parashikuara. Nga letërsia aty mund të përfshihen vepra të letërsisë shqipe, letërsisë së vendeve të rajonit apo letërsisë botërore, si dhe vepra të rëndësishme letrare nëpërmjet të cilave nxënësi njih specifikat kulturore dhe gjuhësore të mjedisit lokal. Nxënësve mund t'u sugjerohet që ata vetë të zgjedhin dhe analizojnë tekste letrare në mënyrë të pavarur, për ta zhvilluar kulturën e leximit dhe për t'i nxitur që të lexojnë me kënaqësi. Në kontekstin e gjuhës mund të jenë përmbajtje gjuhësore për studimin e së folmes së zonës ku është vendosur shkolla, përpilimet e gramatikave diferenciale dhe fjalorëve të së folmes lokale. Numri i deklaruar i orëve (14) mund të përdoret edhe për përforsimin e pjesës së obligueshme të programit. Përshtatja e mësimimit nevojave të nxënësve dhe hapja e programit ka të bëjë edhe me vëllimin e lëndës, prandaj mësimdhënësi mund të zgjedhë që një rezultat të caktuar edukativo-arsimor ta realizojë, duke punuar me një numër të madh ose të vogël veprash (p.sh. këngët epike - kur ka të bëjë me letërsinë popullore etj.).

Rezultatet edukativo-arsimore realizohen me anë të mësimimit problemor-krijues, hulumtues dhe me të nxënit dhe mësimdhënien që bazohet në projekte, me forma të mësimimit bashkëpunues dhe qasje të individualizuar, si dhe duke përdorur mjete të teknologjisë dhe të komunikimit.

C. QËLLIMET E LËNDËS

Qëllimi i përgjithshëm i lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë është që nxënësi të zhvillojë shkathtësitë e të shprehurit, komunikimit dhe përçimit të informatave, mendimeve, ndjenjave dhe qëndrimeve me kuptim dhe dedikim.

Nxënësi:

- krijon qëndrim pozitiv ndaj gjuhës shqipe si gjuhë e tij amtare, duke u bërë i vetëdijshëm se gjuha është pjesa më e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe baza më e rëndësishme e identitetit të njeriut;
- zhvillon katër shkathtësitë e komunikimit:
 - për të dëgjuar (kupton çfarë dëgjon);
 - për të folur (qartë, me kuptim dhe drejt);
 - për të lexuar (kupton çfarë lexon);
 - për të shkruar (në përputhje me normat gramatikore dhe drejtshkrimore dhe në kuadër të stileve të ndryshme funksionale).
- me anë të dëgjimit dhe leximit veprues aftësohet për të zgjedhur fakte dhe për të nxjerrë përfundime nga teksti, për ta mbindërtuar dhe vlerësuar tekstin në mënyrë kritike dhe për t'i paraqitur idetë e veta në mënyra të ndryshme;
- me ushtrimet gjuhësore nxënësi nxitet për ta zhvilluar fjalorin aktiv dhe për ta krijuar shprehinë dhe nevojën për të lexuar;
- në shembujt e teksteve të ndryshme joletrare dhe letrare formon tablonë e plotë të strukturave fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore të gjuhës shqipe;
- zotëron forma të ndryshme stilistike dhe fiton aftësinë për të përdorur stile të përshtatshme funksionale në të folur dhe në të shkruar; zhvillon kompetencat për të kuptuar dhe për të krijuar tekste të llojeve dhe strukturave të ndryshme, për qëllime dhe përdorime të ndryshme;
- aftësohet për të kuptuar, interpretuar dhe vlerësuar tekstin letrar me synimin për t'u zhvilluar personalisht, për të arritur aftësitë dhe qëndrimet, si dhe për të zhvilluar krijimtarinë e vet; nga shembujt e zgjedhur të letërsisë shqipe dhe botërore;
- njih zhvillimet themelore teoriko-letrare dhe zhvillimin e formave zhanrore, si dhe rolin krijues e artistik të gjuhës dhe rëndësinë e saj kulturore;
- fiton aftësinë e vlerësimit njohës, etik e estetik të veprave letrare dhe zhvillon të menduarit kritik si dhe shijen letrare;
- lidh përvojën e vet me përvojën e fiksionit letrar;
- kupton trashëgiminë e përgjithshme kulturore dhe zhvillon identitetin e vet personal dhe atë kombëtar kulturor, duke studiuar zhvillimin historik të gjuhës dhe periodizimin e letërsisë;
- zhvillon aftësitë e komunikimit dhe socializohet me sukses (shkëmben ide, mendime, përvoja, ndjenja me të tjerët, në kontekste të ndryshme);
- zhvillon siguri, vetëbesim dhe gatishmëri për bashkëpunim dhe punë ekipore;
- udhëzohet për të respektuar bashkëbiseduesin dhe kulturën e dialogut;

- merr pjesë në interaksione të ndryshme mësimore me të cilat nxit individualizmin dhe nismat;
- zhvillon ndjeshmërinë për nevojat e të tjerëve dhe pranon diversitetet;
- gjen, në burime të ndryshme, përmbajtje dhe informata për të cilat mendon në mënyrë kritike,
- gjykon për besueshmërinë dhe dobinë e tyre;
- dallon kontekstin dhe qëllimin e autorit dhe në mënyrë të pavarur i zgjidh problemet dhe merr vendimet;
- ndërgjegjësohet për mundësinë e ndikimit në mjedisin e vet dhe jetën shoqërore si dhe formon vetëdijen qytetare;
- zhvillon strategjitë e veprimtarisë së pavarur me çka aftësohet për nxënie të vazhdueshme.

Ç. KORRELACIONI ME LËNDËT E TJERA DHE ME TEMAT NDËRLËNDORE (NDËRKURRIKULARE)

Realizimi i rezultateve të mësimimit dhe shkathtësive si rezultat përfundimtar nënkupton lidhjen e mësimimit të gjuhës shqipe dhe letërsisë me lëndët e tjera mësimore. Qasja korrelative ndikon në cilësinë, zbatueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e njohurive të fituara. Temat/fushat ndërlëndore janë përmbajtje të cilat bëjnë të mundur që në kurrikulën e arsimit të përgjithshëm të futen arritje të caktuara të të nxënimit që nuk janë pjesë e disiplinave formale / lëndëve të veçanta, ose që kanë strukturë interdisiplinare. Këto përmbajtje i kontribuojnë qasjes integrative në arsimin e përgjithshëm.

Për mësimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë përveç lidhjes së brendshme (korrelacioni vertikal) është e nevojshme edhe lidhja funksionale me fushat e lëndëve me të cilat është e mundur të bëhet një lidhje logjike (korrelacioni horizontal). Periodizimi i letërsisë duhet studiuar nga: aspekti historik përmes ndikimit të rrethanave shoqërore dhe historike për autorin dhe krijimin e veprës dhe të aspektit të stilit, përmes analizës krahasuese të veprës letrare me veprat e artit të pikturës, skulpturës, arkitekturës dhe muzikës, të së njëjtës periudhë.

Shprehja e qëndrimeve dhe ideve kritike gjatë interpretimit të teksteve bën të mundur lidhjen e mësimimit të letërsisë me fushën socio-humanistike.

- Zotërimi i gjuhës shqipe ndihmon që të kuptohen, mësohen dhe zbatohen më mirë njohuritë dhe shkathtësitë në gjuhë të huaja.
- Zotërimi i ligjshmërive gjuhësore zhvillon të menduarit analitik dhe ndihmon realizimin e lidhjes me lëndët mësimore natyrore.

Gjetja e informatave të nevojshme me përdorimin e kompetencave informatike, nxënësi nxitet për të gjykuar në mënyrë kritike lidhur me burimet dhe për të mësuar në mënyrë të pavarur.

Duke lexuar tekste të ndryshme letrare dhe joletrare nxënësit udhëzohen për të respektuar trashëgiminë kulturore dhe letrare, tolerancën për tjetrët dhe për të ndryshmen dhe në këtë mënyrë zhvillojnë kompetencat qytetare. Zgjidhja e situatave problemore të motivuara nga teksti letrar zhvillon ndjenjën për të marrë nisma, për të shprehur qëndrime në mënyrë të pavarur dhe me vetëbesim, kurse hapja ndaj ideve dhe mundësive të reja e ndihmon zhvillimin e kompetencave të sipërmarrjes.

Gatishmëria për bashkëpunim dhe punë ekipore, aftësia për empatinë, si dhe vlerësimi kritik i mundësive dhe dobësive personale ndihmon zhvillimin e kompetencave sociale. Duke vlerësuar modelet metodike të mësimit të gjuhës nxënësi udhëzohet për të bërë zgjidhjen e strategjive vepruese të mësimit dhe ashtu të përdorë në mënyrë efikase kohën dhe informatat.

Mësimdhënësve u rezervohet mundësia për të bërë ndërlidhjen funksionale me ato lëndë dhe fusha ndërlëndore për të cilat mendojnë se do të jenë të rëndësishme gjatë zbatimit të praktikës mësimore nga Gjuha shqipe dhe letërsia.

PROGRAMI I LËNDËS MËSIMORE – GJIMNAZ I PËRGJITHSHËM – VITI I

A. REZULTATET EDUKATIVO – ARSIMORE TË LËNDËS

VITI I

MËSIMI I GJUHËS

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të dëgjuar, lexuar, kuptuar dhe krijuar tekste joletrare në përshtatje me moshën, si dhe të dëgjojë bisedat e regjistruara dhe të përgatisë në mënyrë të pavarur biseda të tilla.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- dalluar temën dhe të identifikojë bashkëbiseduesin/bashkëbiseduesen;
- nxjerrë të dhënat kryesore nga teksti;

- treguar se a është arritur marrëveshja në fund të bisedës apo jo; kush ka dalë fitues dhe kush humbës, në bazë të marrëveshjes së arritur;
 - argumentuar mendimin e vet;
 - dalluar bisedën si fornale/jozyrtare;
 - treguar cili folës e ka drejtuar (udhëhequr) bisedën;
 - gjykuar korrektësinë e bashkë-biseduesit/bashkëbisedueses;
- bashkë me nxënësit/nxënëset të demonstrojnë një bisedë të tillë (mundet edhe me telefon).

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 1

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas dëgjimit të parë:

- thonë kush ka biseduar;
- tregojnë për atë që kanë folur apo debatuar bashkëbiseduesit-/bashkëbisedueset;
- u përgjigjen pyetjeve të mësimdhënësit/mësimdhënëses për gjëra të rëndësishme; thonë se a kanë marrë informata apo kanë negociuar;
- tregojnë si ka përfunduar biseda (me apo pa marrëveshje) dhe e argumentojnë mendimin e vet;
- tregojnë përse është/nuk është arritur marrëveshja, gjegjësisht kush e mban përgjegjësinë për këtë gjë; e argumentojnë mendimin e vet;
- nxjerrin përfundime për qëndrimet fillestare dhe përfundimtare të të dy negociuesve;
- bisedojnë për kontestimet e mundshme ndërmjet njerëzve (për shembull – të brezave).

Pas dëgjimit të dytë:

- thonë a është bisedë zyrtare apo jozyrtare;
- thonë çfarë raportesh kanë bashkëbiseduesit/bashkëbisedueset (për shembull të barabarta apo hierarkike);
- tregojnë për gjendjen emocionale të bashkëbiseduesve/ (për shembull dashamirëse/jodashamirëse, e këndshme/e pakëndshme
- thonë cili nga bashkëbiseduesit/bashkëbisedueset e ka udhëhequr dhe drejtuar bisedën;
- vlerësojnë maturinë e bashkëbiseduesve/bashkëbiseduesëve, a është biseda e tyre me gjeste (duar) dhe me lëvizje të përshatshme etj;
- bisedojnë për ndikimin e emocioneve gjatë hartimit të tekstit;
- bisedojnë për nevojën e njeriut për ta dëgjuar dhe kuptuar të tjerët;
- formojnë mendimin e vet lidhur me bisedën/negocimin.

Përgatisin bisedën dhe gjatë bisedës:

- marrin parasysh gjestikulacionet, mimikën dhe pamjen e fytyrës;
- marrin pjesë në lojën e roleve; bëjnë dramatizimin e tekstit;
- përgatisin pyetjet (me gojë/me shkrim);
- ushtrojnë negocimin në grupe të vogla
- bashkëbiseduesit/bashkëbisedueset formojnë mendimin e përbashkët, gjegjësisht raportin për bisedimet dhe atë ua prezantojnë shokëve/shoqeve në klasë.

Rezultati edukativo – arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të dëgjuar dhe analizuar tekste joletrare të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara dhe për të krijuar tekste të ngjashme e tekste shkencore me përmbajtje nga lëndët e tjera mësimore (për shembull nga kimia, fizika, biologjia, matematika, gjeografia, historia; përshkrimi i një procesi të punës...)

Arritjet e të nxënit**Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:**

- identifikuar qëllimin dhe temën e tekstit;
- përgjigjur me gojë dhe me shkrim në pyetjet e mësimitdhënësit/mësimitdhënëses lidhur me përmbajtjen e tekstit;
- identifikuar nocionet kryesore në tekst dhe të dhënat e rëndësishme lidhur me to dhe t'i shkruajë në hartën e nocioneve të përgatitur për atë punë;
- hartuar planin e paraqitjes me fjalë, që të ligjërojë vetë, duke pasur përgatitjen me shkrim;
- folur qartë, drejt dhe kuptueshëm, duke pasur parasysh intonacionin, tempon dhe theksin e saktë;
- përdorur në të folur kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm, si dhe domethënien e përgjithshme dhe konkrete të fjalës;
- kumtuar lidhur me ngjarjet dhe përjetimet, duke pasur parasysh të shprehurit me stil.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 2**Përmbajtja / nocionet:****Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:*****Pas dëgjimit:***

- shënojnë përgjigjet të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme;
- bëjnë sistematizimin dhe klasifikimin e të dhënave të fituara, i vërejnë dhe i ndajnë të rëndësishmet nga të parëndësishmet;

- nocionet kryesore dhe të dhënat që kanë lidhje me to i fusin në fletoren e parapërgatitur të nocioneve;
- e përsërisin tekstin (gjegjësisht bëjnë prezantimin me gojë/me shkrim të fletores së plotësuar të nocioneve);
- e shprehin mendimin e vet dhe provojnë ta arsyetojnë;
- tregojnë për përvojat dhe mendimet e veta;
- e plotësojnë vetë tekstin (për shembull parashikojnë vazhdimin ose përfundimin e një teksti narrativ);
- paraqiten vetë me gojë (me një temë të përgatitur paraprakisht):
- para paraqitjes me fjalë mendojnë çfarë do të mund të thonin për atë temë dhe e hartojnë planin e ligjërimit;
- kërkojnë në burime të ndryshme të dhënat që u mungojnë dhe i shënojnë në planin e ligjërimit, duke e shndërruar në një bazament me shkrim të ligjërimit/paraqitjes me fjalë;
- flasin në mënyrë të pavarur gjatë ligjërimit, qartë dhe natyrshëm, me ndihmën e fletores së shënimeve (**vademekum**);
- thonë mendimin e vet pas ligjërimit dëgjuesit/dëgjueset lidhur me ligjërimit (paraqitjen me fjalë).

Rezultati edukativo – arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për ta kuptuar rëndësinë dhe qëllimin e teksteve zyrtare dhe jozyrtare.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- identifikuar dërguesin dhe marrësin, si dhe raportet emocionale dhe shoqërore ndërmjet tyre;
- kuptuar qëllimin e dërguesit dhe mënyrën se si ai i drejtohet marrësit;
- kuptuar se a bëhet fjalë për një tekst zyrtar apo jozyrtar;
- shkruar vetë një tekst të ngjashëm zyrtar ose jozyrtar, me ç'rast do të respektojë bazat e njohurive për hartimin e teksteve zyrtare dhe jozyrtare, të zbatojë rregullat drejtshkrimore dhe të shkruajë lexueshëm.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 3

Përmbajtja/nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas leximit të parë:

- tregojnë kush e shkruan tekstin, kujt i drejtohet dhe në tekst kërkojnë elementet në bazë të të cilave e kanë kuptuar;
- sqarojnë cilat janë raportet shoqërore dhe emocionale ndërmjet atij të cilit teksti i drejtohet dhe atij që e ka shkruar;
- në tekst kërkojnë elementet në bazë të të cilave e kanë nxjerrë përfundimin;
- tregojnë çfarë pret dërguesi nga ai që e pranon mesazhin (tekstin), gjegjësisht përse ia dërgon tekstin, dhe me tekst e vërtetojnë mendimin e vet; gjykojnë a janë shprehjet në tekst të përshtatshme apo jo dhe, po të jetë e nevojshme, i zëvendësojnë.

Pas leximit të përsëritur::

- e thonë mendimin e vet lidhur me mënyrën si do të përgjigjet marrësi i tekstit, duke e argumentuar;
- i caktojnë elementet themelore të formës së jashtme të teksteve zyrtare dhe jozyrtare;
- në rrethana të përshtatshme (p. sh. në rast feste, shëtitjeje, shfaqjeje) hartojnë vetë tekste të tilla, duke pasur kujdes që të shkruajnë lexueshëm, bukur dhe drejt;
- shkruajnë tekste për gazetën e klasës, buletin...;
- përgatisin revistën e shkollës.

Rezultati edukativo – arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të lexuar dhe shkruar në mënyrë të pavarur një shpallje, urim, ftesë.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur qëllimin dhe temën e tekstit;
- veçuar fjalët/nocionet kryesore dhe të dhënat e rëndësishme në tekst dhe t'i përpunojë në listën e nocioneve;
- gjetur të dhënën e kërkuar në përmbajtje (edhe nga pjesa jotekstore);
- gjykuar lidhur me (pa)vërtetësinë e të dhënave të përmendura;
- përcaktuar se a është shkruar teksti në gjuhën standarde;
- përcaktuar a është teksti letrar apo joletrar;
- dalluar stilet e ndryshme të të shkruarit;
- njohur termat shkencorë dhe t'i sqarojë me ndihmën e fjalorit;
- hartuar planin e ligjërimit (paraqitjes me fjalë);

- vërejtur dhe kuptuar përdorimin e stileve të ndryshme në tekste të llojeve të ndryshme;
- përdorur drejt parimet e hartuarit me shkrim (kohezionin, përzgjedhjen, harmoninë, proporcionin, theksimin, larminë);
- zbatuar parimet e kompozicionit të tekstit – tërësitë në tekst i dallon përmes paragrafeve;
- përpunuar stilistikisht tekstin e shkruar;
- shkruar një tekst narrativ dhe një tekst deskriptiv;
- dalluar narracionin nga deskripcioni (narracionin e lidh me rrëfimin e ngjarjes, ndërsa deskripcionin me përshkrimin e peizazheve, eksteriereve, veprimeve, proceseve).

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 4

- **Përmbajtja/nocionet:** shpallje, urim, falënderim, letër (zyrtare dhe jozyrtare)

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Lexojnë tekste të shkurtra joletrare.

Pas leximit:

- sqarojnë domethënien e fjalës së panjohur në kontekst, shikojnë në fjalor/leksikon;
- gjatë leximit i nënvizojnë të dhënat e rëndësishme dhe i shënojnë në listën e nocioneve.

Pas leximit të përsëritur:

- tekstin e përsërisin me gojë/me shkrim (gjegjësisht bëjnë prezentimin e listës së nocioneve);
- e shprehin mendimin e vet për tekstin;
- tregojnë përvojat dhe mendimet e veta lidhur me tekstin;
- kërkojnë në tekst, por edhe në pjesën jotekstore (skemë, tabelë, grafikë...) të dhënën e caktuar dhe japin sqarime;
- sqarojnë dallimin ndërmjet stilit letrar-artistik dhe atij shkencor;
- caktojnë a është teksti letrar apo joletrar, a është i shkruar në gjuhën popullore apo standarde dhe mendimin e vet e arsyetojnë;
- marrin qëndrim për faktin se teksti është objektiv apo subjektiv dhe arsyetojnë mendimin e vet;
- një tekst subjektiv e shndërrojnë në objektiv.

Shkruajnë tekste vetë:

- rrëfejnë për jetën e një personi të cilin e kanë zgjedhur vetë;
- përshkruajnë një veprimtari/lojë/sport që vetë e kanë zgjedhur.

- komentojnë një tekst/libër/film etj. që vetë e kanë zgjedhur;
- rrefejnë për një ngjarje sipas zgjedhjes së vet.

Para se shkruajnë:

- mendojnë çfarë mund të bëjnë dhe e punojnë planin e tekstit;
- kërkojnë të dhëna në burime të ndryshme dhe i shënojnë në **planin e tekstit**;
- në bazë të planit hartojnë projektin dhe krijojnë një lloj të caktuar teksti.

Gjatë të shkruarit:

- shfrytëzojnë të dhëna nga plani i tekstit;
- janë të kujdesshëm ndaj kompozicionit të tekstit (tërësitë në tekst i theksojnë përmes paragrafeve);
- në fund të tekstit përmendin burimet;
- për një tekst të shkurtër (një ngjarje interesante muzikore/ngjarje sportive) krijojnë sa më shumë tituj dhe përmes shkëmbimit të ideve dhe mendimeve arrijnë të hartojnë një titull.

Pas shkrimit:

- e lexojnë tekstin dhe i korrigjojnë gabimet përmbajtësore, gramatikore dhe drejtshkrimore;
- vlerësojnë kuptueshmërinë e tekstit;
- e përshkruajnë tekstin, me ç'rast janë të kujdesshëm lidhur me formën e tij të jashtme dhe lexueshmërinë;
- tekstin e vet e krahasojnë me punimet e shokëve/shoqeve të klasës dhe bëjnë vlerësimin e tij.

Rezultati edukativo – arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të lexuar, kuptuar e analizuar tekste joletrare (shkencore dhe publicistike) dhe për të shkruar tekste vetë (për shembull të bëjë përshkrimin e një procesi, veprimtarie, hapësire, ngjarjeje, përjetimi...).

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar gjuhën si sistem shenjash që realizohet përmes të folurit dhe të shkruarit;
- kuptuar rëndësinë që gjuha ka për komunikimin dhe fuqinë e saj në krahasim me mënyrat e tjera të marrëveshjes;
- kuptuar funksionet e gjuhës;
- kuptuar natyrën, prejardhjen dhe tiparet e gjuhës;
- kuptuar nocionin (konceptin) *metagjuhë*;
- kuptuar se dukuritë gjuhësore studiohen në diakroni dhe në sinkroni;
- kuptuar se gjuhët shfaqen dhe zhduken.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 5

Përmbajtja/nocionet: funksionet dhe veçoritë e gjuhës, sistemi i shenjave, komunikimi, metagjuha, diakronia dhe sinkronia

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- e shpjegojnë gjuhën si një dukuri psikologjike, biologjike dhe sociologjike;
- temën apo nocionin e zgjedhur provojnë ta paraqesin me gjestikulacion dhe mimikë, e pastaj ta krahasojnë me tekstin e shkruar ose të folur;
- e krahasojnë gjuhën me mënyrat e tjera të komunikimit.

Rezultati edukativo – arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për ta kuptuar gjuhën si mjet të komunikimit.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të :

- kuptuar si bëhet normëzimi i gjuhës, çka quajmë **normë**, e çka **standardizim**;
- kuptuar dallimin ndërmjet gjuhës standarde dhe gjuhës letrare;
- kuptuar se norma mund të jetë drejtshqiptimore, drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore dhe leksikore;
- kuptuar se norma gjuhësore pëson ndryshime dhe se norma është marrëveshje.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 6

Përmbajtja/nocionet: standardizimi dhe norma

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- i hetojnë shmangiet dialektore në tekstin e folur dhe të shkruar dhe i krahasojnë ato me normën gjuhësore;
- i përshtasin me normën tekstet që nuk janë të normëzuara (shkruar në dialekt);
- gjatë përshtatjes së teksteve në përputhje me normën, zbatojnë në mënyrë parimore rregullat drejtshqiptimore, drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore dhe leksikore;
- i gjejnë njësitë e dhëna në fjalorë dhe në Drejtshkrim.

Rezultati edukativo – arsimor 7

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për ta kuptuar gjuhën si mjet të komunikimi.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- dalluar dhe për t'i sqaruar shtresat e gjuhës;

- njohur dhe kuptuar si shfaqen: sociolektet (zhargoni, argoja, slengu); idiolektet, variantet, dialektet; stilet funksionale (shkencor, bisedor, letrar dhe publicistik);
- dalluar stilet funksionale, duke i lidhur me tekste të caktuara;
- kuptuar përse për të shkruar tekste të ndryshme përdoren stile të ndryshme;
- shkruar vetë një tekst publicistik;
- vërejtur raportin e dialekteve me gjuhën standarde.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 7

- **Përmbajtja/nocionet:** shtresat e gjuhës, sociolektet, zhargoni, argoja, slengu, idiolektet, variantet, dialektet; stilet funksionale

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë tekste me shprehje në dialekt;
- hetojnë dhe veçojnë shmangiet dialektore, analizojnë, krahasojnë, vërejnë dallimet në raport me normën gjuhësore;
- përdorin fjalorin e zhargonit dhe të slengut;
- shkruajnë leksema për fjalorin e zhargonit të brezit të vet;
- lexojnë tekstin e shkruar me stilin e të folurit dhe një tekst letrar, duke qenë të vëmendshëm për tempon e shqiptimit, intonacionin, theksimin e fjalës apo grupit të fjalëve;
- ushtrojnë stilin bisedor, simulojnë bisedën në stacion, në pushime verore, me telefon;
- përdorin slengun, e pastaj e përshtasin me normën;
- i gjejnë dhe i krahasojnë tekstet e shkruara me stile të ndryshme;
- komentojnë dallimet ndërmjet stileve;
- gjejnë shembuj të dialogëve letrarë dhe të stilit bisedor në një vepër letrare.

Rezultati edukativo – arsimor 8

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë /ei aftë për të folur kuptueshëm dhe natyrshëm; gradualisht i përvetëson normat gjuhësore të gjuhës shqipe, si dhe aftësinë për të dalluar varietetet gjuhësore jo të standardizuara dhe evitimin e tyre në të folur dhe në të shkruar, si dhe për të kuptuar zhvillimin historik të gjuhës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të dëgjuar, lexuar, hulumtuar dhe fituar njohuri për fillimet e shkrimit shqip.

Nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur origjinën e gjuhës shqipe;
- njohur familjen e madhe të gjuhëve ku bën pjesë gjuha shqipe dhe gjuhët e popujve fqinjë;
- ndjekur evolucionin e gjuhës/gjuhëve letrare shqipe deri në shekullin XIX (gegërishtja e vjetër letrare – e Buzukut, e Budit, e Bogdanit etj., toskërishtja e vjetër letrare - Perikopeja e Pashkëve, gjuha letrare e veprave të autorëve arbëreshë në Itali, karakteristikat e gjuhës shqipe në veprat e bejtexhinjve;
- njohur ndryshimet historike ose evolucionin e gjuhës shqipe;
- ditur se cilat janë dokumentet më të vjetra të shkruara në gjuhën shqipe;
- kuptuar dhe sqaruar gjendjen gjuhësore aktuale.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 8

- ***Përmbajtja/nocionet:** gjuhët letrare shqipe deri në shekullin XIX, dokumentet e para të shkruara në gjuhën shqipe*

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në libra të vjetër, antologji, botime enciklopedike, në studime me përmbajtje historiko-letrare dhe në burime të tjera gjejnë tekste të shkruara në njërën nga variantet e vjetra letrare shqipe, vërejnë grafemat, ornamentikën, inicialet;
- njohin (nëse munden) fjalë të afërta me trajtat e sotme, bëjnë krahasime), kërkojnë ngjashmëri dhe dallime.

Rezultati edukativo – arsimor 9

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar vendin, rolin dhe rëndësinë e shkencës së gjuhësisë (linguistikës) dhe disiplinave të saj (fonetika e fonologjia, morfofonologjia, morfologjia, sintaksa, leksikologjia, stilistika dhe semantika) për hulumtimin dhe njohjen e gjuhës si sistem, si dhe objektin e hulumtimit të tyre.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar me çka merret shkenca e gjuhësisë;
- dalluar disiplinat e gjuhësisë;
- kuptuar dhe sqaruar me çka merret fonetika;
- kuptuar dhe sqaruar me çka merret fonologjia (sistemi tingullor);
- sqaruar ç’është fonema;
- kuptuar dhe sqaruar me çka merret morfofonologjia;
- kuptuar dhe sqaruar me çka merret morfologjia;
- treguar me çka merret sintaksa;
- kuptuar dhe sqaruar se me çka merret leksikologjia;

- sqaruar çka është leksema;
- sqaruar çka është stilistika;
- sqaruar çka është semantika.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 9

- **Përmbajtja/nocionet:** shkenca e gjuhës dhe disiplinat e saj; fonetika dhe fonologjia (sistemi tingullor); fonema, morfofonologjia

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- mësojnë për përdorimin dhe ndryshimin e tingujve;
- ushtrojnë të gjejnë llojet e fjalëve në tekst;
- sqarojnë përmbajtjen dhe trajtën stilistike të fjalisë së caktuar;
- sqarojnë klasifikimin e tingujve;
- sqarojnë dallimin e tingullit dhe fonemës.

Rezultati edukativo – arsimor 10

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të vërejtur ndryshimet e tingujve në fjalë, për t'i emërtuar ato dhe për t'i përdorur në mënyrë të saktë gjatë të folurit dhe të shkruarit, si dhe për të vërejtur kushtëzimin fonetik të alternimit tingullor për ndryshimin dhe krijimin e fjalës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- artikuluar tingujt dhe në bazë të shqiptimit të vërejtë rolin e organeve të të folurit në prodhimin e zërit;
- klasifikuar tingujt sipas vendit të krijimit dhe shqiptimit;
- klasifikuar tingujt sipas nyjetimit, veçorive akustike.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 3

Përmbajtja/nocionet: ndarja e tingujve

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- të njohë ndarjen e tingujve
- të njohë klasifikimin e zanoreve, ushtrime të artikulimit
- të njohë klasifikimin e bashkëtingëlloreve për nga vendi dhe mënyra e formimit

Rezultati edukativo – arsimor 11

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të folur qartë dhe natyrshëm, duke zbatuar normat e gjuhës (gjuha standarde) në komunikimin me gojë dhe me shkrim.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur klasifikimin e tingujve të të folurit në gjuhën shqipe (klasifikimi i zanoreve, klasifikimi i bashkëtingëlloreve)
- identifikuar barazimin e bashkëtingëlloreve sipas pjesëmarrjes së zërit dhe të zhurmës, llojit të pengesës (mënyrës së formimit), sipas organit aktiv gjegjësisht vendit ku formohen,
 - të identifikojë ndryshimet e tingujve: **k-q /qe** (k – q, k – qe); **g –gj /gje** (g – gj, g – gje); **ll - j /je** (ll – j, ll-je,);
 - të identifikojë palatalizimin e fundores N në J/NJ, te shumësi i emrave mashkullorë, shndërrimin e N-së ose R-së në J,
 - të shkruajë drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës;
 - të përdorë saktë bashkëtingëlloret: sh, zh, ç, s, z;
 - të përdorë drejt zanoret: e, ë, i/y, u/y.
 - të kuptojë se hallkat më të vogla në të cilat ndahet rrjedha e të folurit, janë **rrokjet**; se në gjuhën shqipe rrokjet janë të hapura ose të mbyllura.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore

Përmbajtja/nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në tekstin e zgjedhur i njohin fjalët që kanë pësuar ndryshime tingullore, japin sqarime dhe shembuj.
- bëjnë lidhjen e njohurive me shembuj të figurave të theksit dhe „lojës“fonetike“;
- bëjnë ndarjen e fjalës në rrokje dhe vërejnë tiparet e rrokjes.

Rezultati edukativo – arsimor 12

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë t'i sqarojë dhe zbatojë rregullat drejtshkrimore.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar sistemin e theksit (llojet e theksit, vendin e theksit, shqiptimin e theksit, funksionin e theksit, fjalët proklitike dhe enklitike, theksin logjik të fjalisë);
- kuptuar rregullat e theksimit të standardizuar;

- vërejtur dallimet e theksimit në nivelin e dialektit, në gjuhët fqinje dhe në gjuhët e tjera.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore

- **Përmbajtja/nocionet:** theksi, sistemi theksor, proklitiket, enklitiket

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- gjejnë theksin e fjalisë, vërejnë se disa fjalë në fjali janë të theksuara e disa jo (dhe cilat janë ato), si dhe që fjala mund të ketë vetëm një theks; vërejnë veçoritë cilësore-sasiore të theksit;
- rendisin në mënyrë korrekte fjalët enklitike dhe proklitike;
- ushtrojnë për të folur qartë dhe natyrshëm, duke respektuar normat gjuhësore (theksimin e drejtë etj.);
- në fjalë gjejnë rrokjen e theksuar;
- bëjnë krahasimin e vendit të theksit në gjuhën standarde dhe në shprehjet jostandarde të të folmes lokale;
- vërejnë dhe veçojnë fjalët të cilat theksi kalon në parafjalë dhe fjalët e patheksuara;
- vërejnë intonacionin në rënie (fjalja dëftore) dhe në ngritje (fjalja pyetëse), në fjali;
- gjejnë pozicionin e theksit në fjalë dhe e caktojnë vlerën e tij;
- vërejnë dhe përmendin dallimin ndërmjet theksit të gjuhës standarde dhe të folmes lokale;
- dëgjojnë audio-regjistrime në dialekt/të folme lokale, që e kanë bërë vetë nxënësit, vërejnë shmangiet dialektore dhe krahasojnë me normën gjuhësore;
- gjejnë në fjali theksin logjik të fjalisë.

MËSIMI I LETËRSISË

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar letërsinë si art; për t'i përjetuar, kuptuar dhe interpretuar tekstet letrare artistike.

Arritjet e të nxënësit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- dalluar mjetet me të cilat shprehen llojet e ndryshme të artit;
- shpjeguar me fjalë të veta natyrën e letërsisë dhe lidhjen e saj me artet e tjera;
- kuptuar nocionet: letërsi, beletristikë, literaturë, poezi dhe t'i përdorë ato;

- kuptuar funksionet e letërsisë, në zhvillimin individual të secilit si dhe të shoqërisë (moral, didaktik dhe estetik);
- shpjeguar me fjalë të veta fushën e studimit të letërsisë në kuadër të shkencës së letërsisë;
- vënë në dukje nevojën e studimit të letërsisë nga aspekti i teorisë së letërsisë, historisë së letërsisë dhe kritikës letrare;
- kuptuar se studimet e para për letërsinë si art lidhen me Aristotelin (dukuria e katarzës; kodifikimi i zhanreve).

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: Letërsia dhe shkenca letrare

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- dëgjojnë vepra të inçizuara muzikore;
- shikojnë krijime nga arti figurativ, krijime arkitektonike, skulpturore
- shikojnë balet, shfaqje teatrale, film;
- lexojnë/dëgjojnë tekste letrare artistike
- bisedojnë për mënyrën specifike të të shprehurit të disa krijimeve artistike si dhe vetë nxjerrin përfundime se cilat janë llojet themelore të tekstit letrar-artistik;
- formulojnë mendimin e vet për rëndësinë e letërsisë në zhvillimin e njeriut dhe shoqërisë;
- në grupe shfletojnë teorinë e letërsisë, fjalorin me terma letrarë, historinë e letërsisë, kritikën letrare duke përfunduar se letërsisë si art mund dhe duhet t'i qasemi në mënyrë shkencore;
- bisedojnë për dukurinë e katarzës dhe funksionin e letërsisë;
- vërejnë kodifikimin e zhanreve sipas Aristotelit.

Rezultati edukativo - arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të përjetuar dhe analizuar tekstet letrare artistike si dhe të krijojë vetë tekste të tilla.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- shprehur me gojë dhe me shkrim përjetimet, emocionet, shfaqjet, mendimet si dhe t'i njohë ato të shkaktuara nga tekstet letrare artistike;
- vënë në dukje vlerat etike dhe didaktike të veprës letrare
- për të shprehur përjetimin estetik të veprës letrare
- për të përgatitur dhe interpretuar tekste letrare artistike nga aspekte të ndryshme
- bërë një shkrim kritik në lidhje me veprën e lexuar (përshkruan personazhin, paraqet ngjarjen, komenton veprën dhe bën një analizë letrare)
- shkruar një tekst për mbresat e veta për tekstin apo paraqet shkurtimisht veprën e lexuar.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: teksti letrar

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- dëgjojnë dhe lexojnë krijime ketrare;
- marrin shënime gjatë leximit;
- shënojnë mbresat nga vepra;
- përgatisin interpretime me gojë
- shprehen me gojë
- shkruajnë një tekst për veprën e lexuar

Rezultati edukativo- arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të receiptuar dhe kuptuar veprën letrare.

Arritjet e të nxënit**Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:**

- kuptuar raportin autor-vepër letrare-lexues;
- kuptuar rrjedhën e procesit të krijimit;
- kuptuar domosdoshmërinë e studimit të strukturës së veprës letrare dhe elementeve të saj
- kuptuar dhe përdorur nocionet teoriko-letrare (tema, motivi, fabula, kompozicioni, personazhi, syzheu, narracioni, narratori (tregimtari), mënyrat e të rrëfyerit, retardimi, motivimi;
- përdor me saktësi nocionet personazhi kryesor, heroi, personazhi, karakteri;
- kuptuar mënyrën e paraqitjes së kohës, vendit dhe hapësirës në veprën letrare.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: -vepra letrare, tema, motivi, fabula, syzheu, kompozicioni i veprës letrare, narracioni, narratori (tregimtari), format e të rrëfyerit, retardimet, motivimi, personazhi, -karakter, distanca epike e rrëfimit.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- shpjegojnë raportin autori-vepra letrare-lexuesi dhe zbulojnë veten në atë korelacion;
- veçojnë në veprën letrare kuptimin e saj, idenë dhe përmbajtjen;
- elementet e strukturës së veprës letrare i emërtojnë me nocione teoriko-letrare;
- shkurtimisht paraqesin fabulën e veprës;
- vërejnë motivet në vepër, retardimet, epizodet, digresionet;
- vetë gjejnë informacionin e kërkuar në literaturë (në fjalorin e termave letrarë, në doracakun e teorisë së letërsisë, në internet);
- në grupe të vogla apo në çift hulumtojnë domethënien e tekstit letrar;
- e kthejnë në tekst joletrar (p.sh. në artikull gazetarie, etj.), në vargje tregojnë efektet.

Rezultati edukativo- arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar se vepra letrare është tekst gjuhësor i organizuar i cili ka për qëllim të shpjegojë natyrën e gjuhës poetike.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- njohur tiparet e gjuhës poetike (emocioni, ritmi, kuptimësia)
- bërë dallimin në mes të gjuhës poetike dhe gjuhës së përditshme;
- ditur se fjala në një vepër letrare merr një kuptim të ri, përkatësisht përveç kuptimit të parë ka dhe kuptimin figurativ (dytësor),
- sqaruar çfarë është metagjuha;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: - gjuha poetike (emocionaliteti, ritmi, kuptimi i domethënies).

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë tekster informative dhe lekste letrare;
- krahasojnë gjuhën e teksteve informative me gjuhën e teksteve letrare;
- shpjegojnë dallimet në mes gjuhës poetike dhe gjuhës së përditshme;
- në tekstin letrar vërejnë të veçantat e gjuhës poetike;
- shpjegojnë përmes shembujve kuptimin e parë dhe të dytë të fjalëve

Rezultati edukativo- arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për t'i njohur figurat stilistike si mjete shprehëse të gjuhës poetike.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- njohur figurat stilistike dhe të shpjegojë funksionin e tyre artistik
- kuptuar se efektet artistike arrihen përmes përzgjedhjes së veçantë të fjalëve (metafora, metonimia, personifikimi, epiteti, alegoria, eufemizmi, sinekdoka, ironia, simboli) dhe ndërlidhjen e fjalës dhe kuptimit (figurat e kuptimit: krahasimi, antiteza, hiperbola, litota, paradoksi), figurat e sintaksës (gradacioni, elepsi, asindeta, polisindeta, figurat tingullore (të intonacionit) asonanca, aliteracioni, onomatopeja, anafora, epifora, anadiploza, simploka.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: figurat stilistike: metafora, metonimia, personifikimi, sinekdoka, eufemizmi, epiteti, alegoria, simboli, krahasimi, antiteza, hiperbola, litota, ironia, paradoksi, elipsi, asindeta, polisindeta, asonanca, onomatopeja, anafora, epifora.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- ndërtojnë listën e figurave stilistike që njohin dhe me fjalë të veta tregojnë efektet artistike që arrihen përmes tyre;
- në një tekst të dhënë njohin figurat stilistike dhe tregojnë për funksionin e tyre artistik
- pohimet i vërtetojnë duke konsultuar teorinë e letërsisë, fjalorin e termave teorikë;
- në grupe ushtrojnë duke ndërtuar vetë figura stilistike,
- i përdorin vetë figurat stilistike duke vlerësuar rëndësinë dhe efektin e tyre.

Rezultati edukativo- arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të bërë lidhjen e poezisë me vargun dhe me sistemet e vargëzimit.

Arritjet e të nxënit**Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:**

- njohur llojet e vargjeve në poezi (popullore-epike dhe lirike, gjashtërokshi, tetërokshi, dhjetërokshi, njëmbëdhjetërokshi, dymbëdhjetërokshi, heksametri);
- shpjeguar dallimin në mes vargut të matur dhe vargut të lirë;
- njohur llojet e strofave (distiku, tercina, katreni...) dhe llojet e rimave (e kryqëzuar, e alternuar, monorima, rima e puthur)
- kuptuar rolin dhe funksionin e cezurës në poezi;
- shpjeguar funksionin e refrenit
- ditur dhe shpjeguar llojet e përhershme lirike (soneti).

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: vargëzimi (vargu, strofa, rima, cezura, refreni), soneti.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në poezi dallojnë llojin e vargut, duke theksuar se a kemi të bëjmë me vargun e matur apo me vargun e lirë;
- përcaktojnë llojin e rimës dhe tregojnë si ndikon ajo në tingëllimin e poezisë;
- shpjegojnë ndikimin e refrenit në ritmin e poezisë;
- shpjegojnë se si ndikon vargu, rima dhe cezura në ritmin e poezisë;
- demonstrojnë principet e vargëzimit shqip me shembuj konkret;
- sipas zgjedhjes gjejnë tinguj muzikorë për poezinë lirike.

Rezultati edukativo- arsimor 7

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të ndërlidhur stilin me mënyrën e të shkruarit dhe të shprehurit të shkrimtarit dhe veprës letrare;

Arritjet e të nxënit**Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje të kuptojë dhe të shprehë se:**

- fjala stil përvec që përdoret në jetën e përditshme përdoret edhe në art;
- diciplina që merret me studimin e stilit është stilistika, e cila merret me studimin e ligjëritimit, shprehjes individuale përmes kodit gjuhësor.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: stil, stilistika

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- bisedojnë në grupe për stilin në aspektin e përgjithshëm- në modë, art, në përditshmëri;
- shikojnë reproduksionet e piktorëve të njohur dhe përpiqen të përcaktojnë se cilit stil i përkasin
- diskutojnë në temën : stili tradicional dhe stili modern (në art dhe në përgjithësi në jetë)
- përmes shembujve të përzgjedhur dallojnë stilin e poezisë, tregimit dhe përpiqen ta lidhin me autorin.

Rezultati edukativo- arsimor 8

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur gjinitë letrare.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- njohur veçoritë e gjinive letrare, të theksojë dallimet dhe ngjashmëritë në mes tyre;
- dalluar dhe kuptuar se një vepër letrare është e lidhur dhe i përket një gjinie letrare

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: gjinitë letrare

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- veprat letrare të përzgjedhura i shpjegojnë duke u bazuar në gjinitë letrare
- në grupe përpiqen ta kthejnë një poezi lirike në epike apo në dramë , apo të kundërtën.

Rezultati edukativo- arsimor 9

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar nocionin e llojit letrar.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar llojin letrar si një grup i veprave të ngjashme në të cilat përsëriten disa tipare të njëjta;
- njohur dhe dalluar karakteristikat e llojeve letrare.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: llojet letrare

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në grupe hulumtojnë se cili është lloji letrar më i lexuar në gjeneratën e tyre apo te mësimeve të tyre, duke e bërë këtë në formë tabelare apo përmes grafikave

- veprat e përzgjedhura i klasifikojnë sipas llojeve letrare të cilave i përkasin, duke dhënë arsyetimin se në bazë të cilit kriterium e kanë bërë këtë ndarje;
- ndërtojnë tabelën e llojeve letrare dhe shënojnë karakteristikat e tyre;
- në shembujt e përzgjedhur bëjnë listën e karakteristikave të ngjashme dhe dallimeve në mes llojeve letrare.

Rezultati edukativo- arsimor 10

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë që gjininë lirike ta lidhë me botën e emocioneve, ndjenjave dhe përjetimit subjektiv të asaj që është njëherit dhe lënda e poezisë.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar se me gjininë e lirikës lidhen ndjenjat, subjektiviteti,
- përjetuar gjininë lirike si gërshetim i elementeve tingullore, shtresës së leksikut dhe kuptimit
- njohur dhe shpjeguar llojet letrare.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: poezia lirike

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- dallojnë tekstet lirike dhe me fakte e argumentojnë përgjigjen;
- në një tekst të dhënë gjejnë elementet e poezisë lirike
- shpjegojnë efektet tingullore në një poezi lirike dhe *unë* (veta e parë njëjës – veta e lirikës), si shprehje e unit personal
- të njohin llojet e lirikës.

Rezultati edukativo- arsimor 11

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë që poezinë lirike ta përjetojë dhe kuptojë si formë e shprehjes themelore të gjinisë lirike.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- shprehur përjetimet e veta nga poezia lirike;
- shjerguar strukturën e poezisë lirike;
- treguar cilësitë e poezisë lirike (shkurtësia, shtresa e tingujve që organizohet mbi parimin e efekteve tingullore, shtresa e leksikut, e kuptimeve, emocionaliteti, subjektiviteti; temën e realizon jo përmes ndërtimeve fabulative);
- klasifikuar poezinë lirike sipas tematikës (tema e dashurisë, atdhetare, përshkruese, sociale, mendimtare apo filozofike, religjioze apo fetare), si dhe format tradicionale/ të antikitetit: himni, oda, ditirambi, elegjia, epigrami, epitafi, idila;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: Lirika

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- dëgjojnë leximin e një poezie lirike e cila realizohet përmes tonit emocional të qëndrueshëm që nuk ndryshon;
- analizojnë poezinë lirike, duke theksuar strukturën e saj, temën e motivet;
- klasifikojnë poezinë lirike sipas tematikës dhe kriterit historik të kohës;
- në poezi gjejnë motivin në bazë të së cilit përcaktojnë llojin;
- në grupe shkruajnë tekstet e këngëve rok dhe diskutojnë në lidhje me temën : A mund të konsiderohet vepër letrare teksti i një kënge rok.

Rezultati edukativo- arsimor 12

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar se gjinia e epikës ka për qëllim të trajtojë ngjarjen nga këndshikimi objektiv, përkatësisht një ngjarje të njohur historikisht në të cilën personazhe kryesore janë njerëzit e dalluar: heronjtë, prijësit etj.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar gjatësinë si një nga faktorët kryesorë të rrëfimit epik;
- kuptuar dhe dalluar llojet e gjinisë epike në vargje (epi, kënga epike) dhe në prozë (tregimi, novela, romani) dhe të shpjegojë karakteristikat e tyre;
- të kuptojë funksionin e retardimit, digresionet, epizodën, përsëritjet;
- dalluar në një vepër epike format e të rrëfyerit:
 - a) përshkrimin (portret, peizazh, enterier, eksterier)
 - b) narracionin (në vetën e parë, në vetën e tretë)
 - c) rrëfimin kronologjik dhe retrospektiv;
 - d) monologun, dialogun, monologun e brendshëm.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: epika.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë një krijim epik duke treguar karakteristikat;
- dëgjojnë pjesën nga teksti (regjistrim fonografik) dhe bisedojnë për përjetimin e tekstit;
- shpjegojnë gjatësinë e veprës epike;
- analizojnë veprën epike duke shpjeguar elementet e strukturës;
- njohin llojet e gjinisë epike, theksojnë karakteristikat e tyre dhe me modele konkrete argumentojnë të dhënat;
- bisedojnë dhe lexojnë për atë që kanë shënuar në ditarin e leximeve dhe shpjegojnë principet e seleksionimit;
- komentojnë punimet e veta dhe punimet e nxënësve të tjerë;
- shpjegojnë veprimet e personazheve dhe karakteret e tyre duke i vëzhguar nga kënde apo pikëshikime të ndryshme dhe argumentojnë qëndrimin e vet;

- prezentojnë rezultatet e analizës së bërë.

Rezultati edukativo- arsimor 13

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i/e aftë për të njohur tiparet e krijimeve epiko-lirike.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- njohur në vepër elementet epike dhe lirike;
- kuptuar se ekzistojnë lloje të përziera
- dalluar baladën, poemën dhe romancën;
- gjetur në tekst veprat epike, lirike dhe dramatike.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: llojet epiko-lirike

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- shikojnë një inçizim të një shfaqje teatrale apo dramë televizive, të ndërtuar sipas motiveve të baladës (këngës legjendare) „Gjergj Elez Alia“;
- lexojnë/dëgjojnë baladë, poemë, romancë (regjistrim fonografik);
- tregojnë për planin lirik dhe epik të poezisë duke e krahasuar me poezinë lirike;
- dramatizojnë poemën, baladën;
- ndërtojnë paralele motivore, ideore dhe tematike me baladat e tjera dhe dramatizojnë një këngë epike,
- përgatisin, realizojnë projekte e punë kërkimore për baladën, poemën dhe romancën.

Rezultati edukativo- arsimor 14

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar krijimet epike me strukturë dhe përmbajtje elementare.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje që të:

- dëgjojë një inçizim dhe të shikojë të një shfaqje teatrale apo dramë televizive, të ndërtuar sipas motiveve të baladës / këngës legjendare „Gjergj Elez Alia“;
- lexojë/dëgjojë baladë, poemë, romancë (regjistrim fonografik);
- tregojë për planin lirik dhe epik të poezisë duke e krahasuar me poezinë lirike;
- dramatizojë poemën, baladën;
- ndërtojë paralele motivore, ideore dhe tematike me baladat e tjera dhe dramatizojë një këngë epike,
- përgatisin, realizojnë projekte e punë kërkimore për baladën, poemën dhe romancën.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: format elementare

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- tekstet e përzgjedhura i lidhin me llojin përkatës duke i argumentuar me fakte;
- gjejnë dhe interpretojnë tekste të formave elementare epike;
- në mënyrë individuale apo në grupe shkruajnë fjalë të urta për klasën apo shkollën;

Rezultati edukativo- arsimor 15

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar se në prozë paraqiten vepra me elemente letrare shkencore dhe publicistike.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- njohur tekste letrare-shkencore (udhëpërshkrimi, memoaret, biografia, autobiografia, ditari, fejtani, reportazhi, eseja, monografia, studimi, diskutimi, polemika);
- vënë dë dukje tipareve karakteristike të tyre, duke bërë dallimet esenciale në mes atyre që shkruhen për komunikim të përditshëm (biografia, ditari, reportazhi).

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: llojet letrare-shkencore dhe publicistike

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë tekste të zgjedhura letrare-shkencore;
- ndërtojnë listën e tipareve apo veçorive të këtyre teksteve;
- krahasojnë tekstet letrare-shkencore me tekstet letrare;
- në tekstet letrare-shkencore veçojnë faktet letrare dhe faktet shkencore duke komentuar simbiozën letrare/shkencore.

Rezultati edukativo- arsimor 16

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar dramën si vepër e cila shkruhet për t'u shfaqur në skenën e teatrit.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- bërë lidhjen e dramës me teatrin;
- kuptuar se leximin më autentik këto vepra mund ta kenë në skenën e teatrit;
- njohur strukturën e tekstit dramatik:
(didaskali, lista e personazheve, teksti i personazheve), kompozicioni i dramës (ekspozicioni, thurja, kulminacioni, peripetia, zgjidhja);
- shpjegon kompozicionin e jashtëm të dramës (akti, pamja, skena);
- njohur llojet e gjinisë dramatike (tragjedinë, komedinë, dramën), zhvillimin e tyre historik dhe veçoritë;
- njohur llojet e dramës sikurse janë melodrama, farsa, opera, pastorala;
- kuptuar rolin e monologut, dialogut në dramë;

-shpjeguar se si transferohet një vepër dramatike në skenën e teatrit (dramaturgu, regjisori, aktori, skenografia, kostumografia, rekuizitat në skenë dhe ato që mbajnë aktorët, ndriçimi, efektet muzikore e tingullore)

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: drama

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- shikojnë një shfaqje teatrale apo inçizimin e saj dhe flasin për mbresat;
- ushtrojnë rolin e regjisorit, skenografit, aktorit;
- ushtrojnë mimikën, lëvizjet dhe gjestet;
- hartojnë një tekst dramatik për skenë;
- analizojnë strukturën dhe kompozicionin e veprës dramatike;
- njohin llojet dramatike dhe flasin për karakteristikat;
- në veprimin e dramës përcaktojnë etapat dhe sipas skemës i prezantojnë;
- shënojnë në tekst monologun, dialogun;
- bëjnë dallimin në mes personazhit, personalitetit, tipit, karakterit;
- bëjnë afishe dhe pllakate për një vepër të caktuar dramatike;
- dijen e arritur për dramën e shfrytëzojnë për të analizuar tekste dramatike.

Rezultati edukativo- arsimor 17

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar periodizimin e letërsisë nga aspekti historik; për të kuptuar rrethanat shoqërore-historike si dhe ndikimin e tyre te autori dhe vepra.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- vënë re lidhshmërinë e dryshimeve shoqërore dhe lindjen e formave të reja si në letërsi ashtu edhe në kulturë;
- vënë re elementet e stileve, të epokave të ndryshme në veprat e artit dhe kulturës bashkëkohore;
- kuptuar se letërsia përmban frymën e kohës, por edhe vlerat univerzale;
- në vepër vëren frymën e kohës dhe ndikimin e saj në poetikën e veprës;
- dalluar dhe shpjeguar në veprat e caktuara poetikën e kohës, simbolet e përgjithshme letrare dhe motivet.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: periodizimi i letërsisë

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- rikujtojnë periodizimin të cilin e kanë mësuar nga historia, arti muzikor dhe arti figurativ;
- diskutojnë për epokat letrare të cilat i njohin;
- shënojnë termet, epokat letrare dhe formacionet stilistike dhe të dhënat themelore nga fjalori i termave letrare;

- hartojnë skemën e periodizimit të letërsisë.

Rezultati edukativo- arsimor 18

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të përjetuar dhe analizuar tekstet letrare artistike të epokave të ndryshme.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- dalluar gjininë letrare të një vepre (lirike, epike, dramatike) dhe llojin letrar;
- formuluar temën e veprës dhe t'i zbërthejë ato në njësi më të vogla tematike-motivore;
- shpjeguar cilësitë e gjuhës poetike;
- dalluar figurat stilistike në një vepër lirike si dhe të përcatojë llojin e strofës, vargut dhe rimës;
- bërë lidhjen e organizimit të formës me përmbajtjen (efektet e përsëritjes, rradhën e elementeve të botës së tërësishme të një poezie);
- vënë në dukje cilësitë e elementeve strukturore epike të hapësirës, kohës dhe veprimit;
- dalluar emërtimet: përmbajtje, fabul dhe syzhe;
- paraqitur në mënyrë precize fabulën e veprës duke vënë në dukje epizodet dhe digresionet;
- kuptuar dhe për të bërë dallimin në mes motivimit dhe motivit;
- për të bërë dallimin në mes të epikës në vargje dhe epikës në prozë;
- për të theksuar vlerat etike dhe didaktike të veprës.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë një vepër letrare;
- plotësojnë ditarin e leximit;
- tregojnë si e kanë përjetuar tekstin;
- analizojnë veprën në grup, në çift apo në mënyrë individuale;
- theksojnë gjininë apo llojin letrar të cilës i përket vepra duke e argumentuar qëndrimin e vet;
- tregojnë për strukturën e veprës letrare për kompozicionin dhe elementet e tjera dhe mendimet e veta i argumentojnë
- shpjegojnë lidhjen e formës me përmbajtjen;
- shpjegojnë specifikat e disa llojeve letrare në raport me periudhën së cilës i përkasin;
- theksojnë dhe ilustrojnë karakteristikat e gjuhës poetike duke veçuar figurat stilistike më të shpeshta;
- në veprën e zgjedhur dallojnë përmbajtjen, fabulën dhe syzhenë;
- në veprën e zgjedhur dallojnë motivet;
- në veprën e zgjedhur shpjegojnë me fjalë të veta procesin e motivimit;
- flasin për idenë e veprës.

Rezultati edukativo- arsimor 19

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të përjetuar dhe analizuar me gojë dhe me shkrim veprat letrare-artistike të një periudhe të caktuar.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- shprehur me gojë dhe me shkrim përjetimet e veta, emocionet dhe mendimet e që burojnë nga vepra letrare artistike;
- krijuar një paralele të ndërtuar mbi bazën e tipareve të ndryshme në mes periudhave letrare, apo mbi bazën e motiveve, tematikës dhe ideve të ngjashme të veprave;
- vënë në dukje vlerat etike dhe didaktike të veprës;
- theksuar përmendësh një tekst të shkurtër letrar, përmes të cilit tregon aftësitë e veta interpretative dhe përjetimin estetik të tekstit;
- përgatitur dhe realizuar një interpretim me gojë për një vepër letrare artistike nga një aspekt i caktuar;
- shkruar një tekst për një vepër të lexuar (përshkruan personazhin, paraqet ngjarjen, komenton veprën dhe bënë një analizë letrare të veprës);
- shkruar një tekst për përjetimet e veta lidhur me veprën letrare.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: vepra letrare

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- analizojnë një tekst letrar-artistik duke vënë në dukje tiparet karakteristike të saj (gjininë letrare, llojin letrar, temën, personazhet etj.);
- paraqesin mbresat e veta për tekstin (ushtrime me gojë) dhe qëndrimin e tyre e argumentojnë me citime konkrete nga teksti;
- flasin për mendimet e tyre për veprën dhe i argumentojnë ato nga teksti;
- shprehin me shkrim përjetimet e veta, emocionet dhe mendimet që burojnë nga vepra letrare artistike;
- recitojnë përmendësh një tekst letrar të mësuar;
- përgatisin dhe realizojnë një interpretim me gojë për një vepër letrare artistike nga një aspekt i caktuar;
- shkruajnë një tekst për një vepër të lexuar; përgatiten për ushtrimin me gojë (mbledhin materialin, ndërtojnë kompozicionin...);
- shprehen me gojë;
- plotësojnë ditarin e leximeve;
- në bazë të shënimeve në ditarin e leximeve bëjnë një shkrim për veprën e lexuar;
- bëjnë punë hulumtuese/ punim seminarik të cilin ia paraqesin klasës.

Rezultati edukativo- arsimor 20

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të periudhës antike të letërsisë.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- zbatuar pikëpamjet historike dhe teorike në tekste religjioze, në tragjedi dhe ep; (të njohë krijimet e vjetra letrare / Epi i Gilgameshit);
- kuptuar dhe shpjeguar botën e njeriut të Homerit, besimin në shumë zota, mitin e Trojës, apsurdin e luftës, antropomorfizmin, çështjen homerike;
- dalluar në tekstin e tragjedisë, heroin tragjik, fajin tragjik, përfundimin tragjik, katarzën, strukturën e veprës;
- vërejtur në tekstin religjioz stilin dhe strukturën, domethënien alegorike dhe motivet;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: letërsia e periudhës antike

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- bëjnë krahasime dhe ndërtojnë paralele në mes teksteve letrare dhe veprave të artit e muzikës së epokave të njëjta;
- në vepër gjejnë temat universale (vdekja, njeriu dhe bota e tij, përjetësia etj.);
- përshkruajnë cilësitë e heroit dhe tregojnë karakterin e tij;
- në vepër dallojnë digresionin dhe episodin
- gjejnë shembuj në vepër të veprimeve humaniste të njeriut homerik;
- në ep dallojnë shtresimet tematike, ndërtimin kompozicional, ngjarjen epike, motivet;
- në tragjedinë *Antigona* analizojnë elementet e tragjedisë (ngjarjen, strukturën, personazhet);
- krahasojnë tekstin e “Biblës” me tekstin e “Kuranit”;
- lexojnë në dialog, diskutojnë rreth personazheve, karakterit të tyre, guximit, frikës, ashpërsisë, fundit tragjik, për temën dhe aktualitetin e saj;
- shikojnë një shfaqje teatrale (tragjedi) apo një inçizim të një shfaqje teatrale;
- shikojnë një film me skenar nga mitologjia greke, me motive biblike apo kuranore;

Rezultati edukativo- arsimor 21

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të humanizmit dhe renesansës si epokë letrare.

Arritjet e të nxënit**Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:**

- vërejtur dallimin ndërmjet stilit të letërsisë antike dhe asaj mesjetare;
- vërejtur dallimin ndërmjet teksteve me tematikë/përmbajtje fetare (apokrifet, lavdërimet) dhe teksteve laike (biografia); - të njohë kohën dhe rrethanat e paraqitjes së humanizmit dhe rilindjes (renesansës)
- të njohë veçoritë kryesore të humanizmit – dashurinë e madhe ndaj njeriut, jetës dhe veprimtarisë së tij;
- të njohë përfaqësuesit kryesorë dhe ndikimin e tyre te krijuesit e tjerë;
- të njohë zanafillën, strukturën, tematikën e veprës letrare;
- të njohë sonetin;
- të njohë barokun dhe klasicizmin si drejtime letrare me stile të veçanta
- të njohin veçoritë e veprave letrare të barokut dhe klasicizmit;

- të njohë llojet e veprave (tragjedisë) nga çka u dallua më tepër Ulijam Shekspiri
- të njohë veçoritë e romanit dhe llojet e reja të komedisë

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: Humanizmi (Dante Aligeri, Françesko Petrarka, Xhovani. Bokaçio) dhe renesanca (Ulijam Shekspiri, Miguel de Servantesi, Molieri).

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në tekstet mesjetare gjejnë motivet biblike;
- situatat e veprave letrare i lidhin me kohën e vet;
- dëgjojnë muzikë mesjetare;
- lexojnë fragmente nga krijimtaria e autorëve: Dante, Petrarka, Bokaçio dallimet ndërmjet tyre;
- lexojnë pjesë dramatike duke veçuar tragjedinë e Shekspirit;
- lexojnë fragmente nga romani “Don Kishoti i Mançes, për të treguar dy nivelet e leximit;
- lexojnë pjesë dhe analizojnë karakterin e komedisë që krijoj Molieri.

Rezultati edukativo- arsimor 22

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të humanizmit në letërsinë shqipe.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- lexuar, njohur, komentuar dhe vlerësuar rëndësinë e dokumenteve të para, dëshmitë, dorëshkrimet dhe shkrimet në gjuhën shqipe të cilat pretendojnë të jenë artefakte letrare;
- të njohë rolin e latinistëve shqiptarë (*Dhimitër Frangu, Mikel Maruli, Marin Beçikemi...*)
- të njohë humanistët shqiptarë dhe në veçanti veprën e Marin Barletit “Historia e Skënderbeut”.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: Përmbajtja/nocionet: prodhimi letrar mesjetar (epoka e Arbërit, dëshmitë, dorëshkrimet), humanizmi shqiptar

Aktivitetet për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë pjesë nga dokumentet e para të shkruara shqip Formula e pagëzimit, Fjalori i A. V. Harfit, Ungjilli i Pashkëve;
- lexojnë pjesë dhe kuptojmë këshillat dhe idet humaniste që sjellë Barleti në veprat letrare

Rezultati edukativo- arsimor 23

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të letërsisë së vjetër shqipe.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje për të:

- të njohur veprat e letërsisë së vjetër shqipe;

- të njohë autorët dhe motivet e veprimtarisë së tyre;
- shpjegojë vlerën gjuhësore
- kuptuar dhe analizuar tektet e letërsisë së vjetër;
- të njohë rëndësin letrare, gjuhësore dhe kulturore;
- të njohë karakteristikat e poezisë së Budit;
- të njohë rëndësin e fjalorit ‘latinisht – shqip’ dhe karakterin e veprës ‘Apologjia e Skënderbeut’
- të njohë strukturën e veprës ‘Çeta e Profetëve’

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: Përmbajtja/nocionet: Meshari – Gjon Buzuku, E mbësuese e krishterë – Lekë Matrënga, Poezitë e Pjetër Budit, Fran Bardhi, Kënga e Sibilave –Pjeter. Bogdani

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë pjesë nga Meshari;
- në tekste bëjnë ndarjen e elementeve letrare nga ato historike e kishtare;
- hartojnë librin mbi epokën;
- analizojnë gjuhën e veprave, karakterin fetar, kombëtar dhe laik, si dhe vlerën e madhe historike të veprave të letërsisë së vjetër shqiptare;

Rezultati edukativo- arsimor 24

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të letërsisë popullore.

Arritjet e të nxënit

Nxënësi gjatë mësimit do të jetë në gjendje:

- për të kuptuar rëndësinë kulturore dhe letrare të letërsisë popullore;
- për ta kuptuar procesin e lindjes dhe bartjes së letërsisë popullore;
- për të njohur punën e mbledhësve dhe publikuesve të hershëm të letërsisë popullore shqiptare;
- për t’i sqaruar ndarjen dhe llojet e letërsisë popullore;
- të njohë lirikën popullore, llojet dhe karakteristikat;
- për t’i kuptuar karakteristikat e këngës epike dhe epit;
- të njohë veçoritë e epikës gojore shqiptare (cikli i kreshnikëve);
- të dallojë elementin lirik dhe epik;
- të njohë personazhet, vërejnë mençurinë e njeriut të thjeshtë;
- të njohë tiparet e përrallës popullore (gojore);
- për të analizuar tekstet e zgjedhura duke vërejtur veçoritë stilistike dhe domethëniet

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve arsimore

Përmbajtja/nocionet: Letërsia popullore Këngët popullore lirike, proza popullore, baladat e vjetra, epika popullore

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë këngë popullore (lirika, epika, balada, përralla, proverbi);

- vërejnë dhe tregojnë për veçoritë e stilit epik përmes shembujve të epikës sonë;
- në këngë kërkojnë/gjejnë vende të përgjithshme;
- diskutojnë për vjetërsinë (variantat) e këngëve popullore lirike dhe epike
- vërejnë dallimet në raport me letërsinë mesjetare;
- krahasojnë vargun e lirikës me vargun e epikës popullore;
- lexojnë prozë popullore;
- kërkojnë/gjejnë simbolikë biblike në veprat e letërsisë popullore;
- bëjnë antologji të letërsisë popullore.

Tekstet e propozuara

Prozë	Poezi	Dramë
<p>Aristoteli: <i>Arti poetik</i></p> <p>Xhovani Bokaçio: <i>Dekameroni</i> (një novelë)</p> <p>Miguel de Servantesi: <i>Don Kishoti i Mançes</i></p> <p>Fjalë të urta (sipas zgjedhjes)</p> <p>Gjon Buzuku: <i>Meshari</i> (fragment)</p> <p>Marin Barleti: <i>Historia e Skenderbeut</i> (fragment)</p> <p>Një përallë nga letërsia popullore shqiptare</p> <p>Fan S. Noli: <i>Autobiografia</i> (fragment)</p>	<p>A.Z.Çajupi: <i>Kurbeti</i></p> <p>E. Gjerçeku: <i>Sofra</i></p> <p>Këngët e kreshnikëve: (<i>Muji dhe Halili</i>)</p> <p><i>Epi i Gilgameshit</i></p> <p><i>Kurani</i> (sipas zgjedhjes)</p> <p><i>Bibla</i> (sipas zgjedhjes)</p> <p>Homeri: <i>Iliada</i> (kënga VI dhe XVIII)</p> <p>Dante Aligieri: <i>Ferri</i> (fragment)</p> <p>Françesko Petrarka : <i>Libri i këngëve</i> (sipas zgjedhjes)</p> <p>Lekë Matrënga: <i>Kënga e përshpirtshme</i></p> <p>Pjetër Budi: <i>Poezi</i> (sipas zgjedhjes)</p> <p>Pjetër Bogdani: <i>Çetta e profetëve</i> (fragment)</p> <p>Gjergj Elez Alia: popullore</p> <p>Zgjedhje nga poezia antike (Safo, Pindari, Anakreonti, etj)</p> <p><i>Ç'po këndon një zog i zi</i> (popullore)</p> <p>Lasgush Poradeci: <i>Mbretëria e zemrës</i> (poezi)</p> <p>R. Zogoviq: <i>Këngët e Ali Binakut</i></p>	<p>Kolë Jakova: <i>Halili dhe Hajrija</i></p> <p>Sofokliu: <i>Antigona</i></p> <p>Aristofani: <i>Bretkosat</i></p> <p>Shekspiri: <i>Romeo e Zhuljeta</i></p> <p>M. Drzhiq: <i>Dundo Maroje</i></p>

KANONET	
<p>Sofokliu: <i>Antigona</i> Homeri: <i>Iliada</i> (kënga VI dhe XVIII) Aristofani: <i>Bretkosat</i> Ulijam Shekspiri: <i>Romeo e Zhuljeta</i> Këngët e kreshnikëve: <i>Muji dhe Halili</i> Marin Barleti: <i>Historia e Skenderbeut</i> Xhovani Bokaçio: <i>Dekameroni</i> Dritëro Agolli: <i>Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo</i> Miguel de Servantesi: <i>Don Kishoti i Mançes</i> Gjergj Fishta: <i>Mrizi i zanave</i> Esad Mekuli: <i>Poezi</i> Jevrem Brković: <i>Poezi</i></p>	

Lista e teksteve të propozuara është hartuar sipas kriterit të vlerave estetike dhe në përputhje me moshën dhe zhvillimin kulturor të nxënësit. Nga kjo listë mësimdhënësi përzgjedh tekstet sipas kriterit profesional. Lista nuk e kufizon atë. Përkundrazi, ai është i lirë të përzgjedh për lexim edhe tekste të tjera, që nuk janë në listë, por duhet të ketë kujdes për kriteret e cekura, si dhe për proporcionalitetin e gjinive dhe llojeve letrare, përkatësisht për qëllimet dhe arritjet e të nxënësit në program.

VITI II

MËSIMI I GJUHËS

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të dëgjuar, lexuar, kuptuar dhe analizuar, si dhe për të krijuar tekste joletrare, të përshtatura për moshën.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- identifikuar temën dhe bashkëbiseduesit/bashkëbisedueset;
- veçuar të dhënat kryesore të tekstit;
- sqaruar si ka përfunduar biseda;
- arsyetuar mendimin e vet;
- gjykuar për një bisedë a është ajo zyrtare apo jozyrtare;
- vlerësuar rolin e bashkëbiseduesit/bashkëbisedueses në bisedë;
- gjykuar për korrektësinë e bashkëbiseduesit/bashkëbisedueses;
- bërë vetë një bisedë të ngjashme (mundet edhe me telefon);
- udhëhequr një dialog;
- respektuar mendimin ndryshe dhe bashkëbiseduesin/-bashkëbiseduesen;
- shfrytëzuar racionalisht kohën.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 1

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas dëgjimit të parë:

- e përkufizojnë temën e bisedës/negociatave;
- tregojnë se bashkëbiseduesit/bashkëbisedueset kanë biseduar apo kanë zhvilluar negociata;
- sqarojnë si ka përfunduar biseda dhe mendimin e vet e argumentojnë;
- nxjerrin përfundimin për qëndrimet fillestare dhe finale të pjesëmarrësve/pjesëmarrëseve në biseda/negociata.

Pas dëgjimit të dytë:

- thonë a është biseda zyrtare apo jozyrtare dhe mendimin e vet e arsyetojnë.
- tregojnë çfarë janë raportet ndërmjet bashkëbiseduesve/bashkëbisedueseve dhe mendimin e vet e arsyetojnë.

- tregojnë çfarë është gjendja emocionale e bashkëbiseduesit/bashkëbisedueses, gjegjësisht (për shembull dashamirëse/jodashamirëse, e këndshme/e pakëndshme) dhe formojnë mendimin e vet;
- vlerësojnë maturinë e bashkëbiseduesit/bashkëbisedueses, a është komunikimi i tyre me gojë dhe me lëvizje adekuate e të ngjashme dhe formojë mendimin e vet;
- flasin për nevojën e njeriut për ta dëgjuar dhe kuptuar dikush;
- përgatisin dhe zhvillojnë një bisedë (për temat interesante të brezit: modë, muzikë, argëtim, film); e trajtojnë problemin, planifikojnë zgjidhjet, vendosin për zgjidhjet, paraqesin qëndrime, argumentojnë (punojnë në grupe ose në çifte);
- kohën e shfrytëzojnë racionalisht.

Rezultati edukativo – arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të dëgjuar dhe analizuar tekste joletrare të folura/ të lexuara me zë/të ekranizuara dhe aftësinë për të krijuar vetë tekste të ngjashme, përkatësisht

a) tekste shkencore që kanë lidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera mësimore (p.sh. nga kimia, biologjia, matematika, gjeografia, historia);

b) lajme për ngjarjet aktuale/interesante (raporti, lajmi);

c) reklama në radio dhe TV.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- identifikuar qëllimin dhe temën e tekstit;
- vërejtur dhe veçuar fjalët kryesore dhe të dhënat e rëndësishme në tekst;
- gjetur të dhënën e kërkuar në përmbajtje (edhe në pjesën jotekstore);
- gjykuar lidhur me vërtetësinë e të dhënave të përmendura;
- dalluar a është shkruar teksti në gjuhën standarde apo jo dhe a bëhet fjalë për një tekst letrar apo joletrar;
- dalluar ndryshimin ndërmjet stileve të të shkruarit (administrativ, publicistik, shkencor, letrar);
- gjetur fjalët kryesore dhe për t'i sqaruar ato me ndihmën e fjalorit;
- hartuar planin e ligjërimit (paraqitjes me fjalë);
- ligjëruar me gojë, për një temë paraprakisht të përgatitur.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 2

Përmbajtja / nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas dëgjimit:

- bëjnë sistematizimin dhe klasifikimin e të dhënave të fituara; nocionet kryesore dhe të dhënat e rëndësishme lidhur me to i fusin në hartën e përgatitur të nocioneve;
- e përsërisin tekstin (gjegjësisht bëjnë prezentimin me gojë/me shkrim të hartës së nocioneve të plotësuar);
- e shprehin mendimin e vet dhe përpiqen ta argumentojnë;
- e bëjnë vetë plotësimin e tekstit me përmbajtje të reja;
- pas dëgjimit/shikimit të reklamës tregojnë çfarë reklamohet dhe çfarë është thënë lidhur me të; a janë të gjitha të dhënat e sakta apo jo; mendimin e vet e arsyetojnë; thonë çfarë ka dashur të arrijë porositësi i reklamës të marrësi i reklamës dhe parashikojnë si do të përgjigjet ai/ajo;
- mendimin e vet e arsyetojnë;
- paraqiten vetë me gojë (me një temë paraprakisht të përgatitur);
- para ligjërimit me gojë mendojnë vetë çfarë do të mund të thonin për temën dhe e hartojnë planin e ligjëratës;
- të dhënat që mungojnë i kërkojnë në burime të ndryshme dhe i shënojnë në planin e ligjëratës, duke e shndërruar në bazë të shkruar të ligjërimit me gojë;
- gjatë ligjërimit (paraqitjes me fjalë) flasin të pavarur me ndihmën e bazës së shkruar (skicës me teza), qartë dhe natyrshëm;
- pas ligjërimit (paraqitjes me fjalë) dëgjuesit/-dëgjueset e thonë mendimin e vet lidhur me ligjërimin (paraqitjen me fjalë);
- marrin pjesë në lojën e roleve ose në dramatizim;
- rrëfejnë me fjalë të veta ngjarjen (në mënyrë kronologjike, retrospektive).

Rezultati edukativo – arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të njohë rëndësinë dhe qëllimin e teksteve letrare e joletrare dhe të shkruajë e lexojë vetë tekste të ngjashme;

- lutja;
- ankesa.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- identifikuar dërguesin dhe marrësin, si dhe raportet emocionale dhe shoqërore ndërmjet tyre;
- kuptuar qëllimin e dërguesit;
- njohur a është një tekst zyrtar a jozyrtar;
- gjetur të dhënat kryesore;

- shkruar vetë një tekst të ngjashëm zyrtar ose jozyrtar, duke respektuar njohuritë për atë si krijohen tekstet zyrtare dhe jozyrtare dhe duke i zbatuar rregullat drejtshkrimore; shkruan ashtu që teksti të jetë i komunikueshëm.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 3

Përmbajtja/nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas leximit të parë:

- thonë kush është autori dhe kujt i drejtohet teksti; në tekst kërkojnë elemente në bazë të të cilave e kanë kuptuar atë gjë;
- thonë çfarë raportesh shoqërore dhe emocionale ka ndërmjet atij të cilit teksti i drejtohet dhe atij që e ka shkruar; në tekst kërkojnë elementet në bazë të të cilave e kanë hartuar përfundimin;
- thonë çfarë pret dërguesi nga marrësi, gjegjësisht përse ia dërgon tekstin, kurse me të dhënat nga teksti e vërtetojnë mendimin e vet.

Pas leximit të përsëritur:

- i dallojnë të dhënat më të rëndësishme dhe i sqarojnë ato;
- e thonë mendimin e vet lidhur me atë se si do të përgjigjet marrësi i lutjes/ankesës dhe japin arsytimin;
- përcaktojnë a është teksti zyrtar apo jozyrtar dhe në të kërkojnë veçoritë gjuhësore në bazë të të cilave e kanë arritur atë përfundim;
- dallojnë elementet themelore të formës së jashtme të teksteve zyrtare dhe jozyrtare;
- në rrethana të përshtatshme krijojnë vetë tekste të ngjashme, duke pasur kujdes që shkrimi të jetë i lexueshëm, i bukur dhe i rregullt.

Numri (orientues) i orëve për realizimin e rezultateve edukativo-arsimore 1,2,3:

15 orë zhvillim + 60 orë përsëritje =75 orë

Rezultati edukativo – arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja 1.4. Zhvillon aftësinë për të lexuar, kuptuar dhe analizuar tekste shkencore dhe publicistike, për të shkruar në mënyrë të pavarur tekste të ngjashme:

- biografia, CV
- raporti, lajmi
- referati

- eseja
- përfundimi / rezymeja
- procesverbali,
- vademekumi (notesi)

Arritjet e të nxënët

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar qëllimin dhe temën e tekstit;
- vërejtur dhe veçuar nocionet kryesore dhe të dhënat e rëndësishme në tekst;
- gjetur të dhënën e kërkuar në përmbajtje (në pjesën jotekstore);
- vlerësuar saktësinë e të dhënave të përmendura;
- përcaktuar a është shkruar teksti me gjuhën standarde, a është letrar apo joletrar;
- kuptuar dallimin ndërmjet stileve të të shkruarit;
- gjetur termat/nocionet profesionale dhe t'i sqarojë me ndihmën e fjalorit;;
- hartuar planin e ligjëritimit (paraqitjes me fjalë) - skicën me tezat kryesore;
- vënë një tekst të caktuar përballë stileve të ndryshme funksionale;
- dalluar tekstet e shkruara të tipave të ndryshëm (sipas përmbajtjes, stilit);
- vlerësuar në mënyrë kritike tekstet;
- bërë analizën gjuhësore-stilistike.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 4

Përmbajtja/nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Lexojnë tekste të shkurtra joletrare dhe gjatë leximit nënvizojnë të dhënat e rëndësishme.

Pas leximit të përsëritur:

- e shprehin mendimin e vet për tekstin dhe provojnë ta argumentojnë;
- flasin për përvojat dhe mendimet e veta lidhur me tekstin;
- në tekst gjurmojnë të dhënën e kërkuar (edhe në pjesën jotekstore);
- interpretojnë pjesët jotekstore (për shembull skemat, tabelat, grafikët etj.);
- sqarojnë dallimin ndërmjet silit letrar-artistik dhe atij administrativ;
- përcaktojnë a është fjala për një tekst letrar apo joletrar, a është i shkruar në gjuhën popullore apo standarde dhe mendimin e vet e arsyetojnë;
- thonë a është një tekst i caktuar objektiv apo subjektiv dhe e arsyetojnë mendimin e vet;
- një tekst subjektiv e kthejnë në tekst objektiv;
- e përcaktojnë stilin e autorit (serioz, ironik, sentimental);
- lexojnë tekste shkencore;
- diskutojnë për atë sa janë të qartë, të kuptueshëm dhe lidhur me korrektësinë e tyre gjuhësore, bëjnë korrigjimin e tyre, po të paraqitet nevoja.

Shkruajnë vetë tekste dhe:

- rrëfejnë për jetën e një personi të cilin e kanë zgjedhur vetë;
- shkruajnë një ese të shkurtër për një vepër sipas zgjedhjes së vet;
- përshkruajnë procesin e punës;
- e komentojnë një tekst, libër, film etj. që vetë e kanë zgjedhur;
- e gjejnë apo e shkruajnë një tekst sipas modelit shkencor, e pastaj e kthejnë në një tekst letrar duke e përpunuar stilistikisht.

Para se të shkruajnë:

- mendojnë çfarë do të mund të shkruajnë dhe e punojnë planin e ligjërimit (paraqitjes me fjalë);
- në burime të ndryshme i kërkojnë të dhënat dhe i shënojnë në planin e ligjërimit;
- ideojnë projektin dhe krijojnë një lloj të caktuar teksti (për shembull një rrëfim mbi jetën e një personi të njohur, një përshkrim të një veprimtarie pune, një sqarim për lindjen e një dukurie/gjendjeje, një koment për një shfaqje/libër, një lajm, një raport, përkufizimin e një nocioni...).

Gjatë të shkruarit:

- të dhënat nga plani i paraqitjes me fjalë (ligjërimi) i shndërrojnë në tekst të shkruar; janë të kujdesshëm gjatë hartimit të kompozicionit të tekstit;
- në fund të tekstit i japin burimet;
- për një tekst të shkurtër (një ngjarje interesante muzikore, sportive) imagjinojnë sa më shumë tituj (në fund e zgjedhin më cilësorin).

Pas të shkruarit:

- e lexojnë hartimin, e përshkruajnë tekstin duke pasur kujdes formën e tij të jashtme, që të jetë i lexueshëm dhe gjuhësisht korrekt;
- e vlerësojnë tekstin e vet dhe tekstet e kolegëve të vet/kolegeve të veta.

Rezultati edukativo – arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për ta kuptuar ndryshimin e gjuhës dhe zhvillimin e alfabetit.

Arritjet e të nxënit**Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:**

- kuptuar zhvillimin (evolucionin) e gjuhës dhe konvencën gjuhësore;
- kuptuar zhvillimin e shkrimit gjatë historisë (shkrimi kuneiform, hieroglifik, linear A dhe linear B, shkrimet alfabetike, si dhe raportin e gjuhës dhe alfabetit);
- folur për përpjekjet e autorëve shqiptarë për të pasur një alfabet të njësuar për shkrimin e shqipes; vendimi i Kongesit të Manastirit;
- folur për familjet e gjuhëve (gjuhët indoeuropiane, urale, baske, afroaziatike, niger-kordofaniane, altai, kino-tibetiane, kaukaziane, dravide etj);

- sqaruar se brenda familjeve të gjuhëve ekzistojnë gjuhë të afërta,, me ngjashmëri të konsiderueshme dhe pika të përbashkëta (p. sh. familja e gjuhëve sllave, gjuhëve gjermanike, neolatine etj.);
- caktuar vendin e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve;
- kuptuar gjendjen aktuale në hapësirën e gjerë gjuhësore (në rajon);
- kuptuar dhe përdorur termat: dygjuhësi (*bilinguizëm*), shumëgjuhësi (*multilinguizëm*), *diglosi*.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 5

- **Përmbajtja/nocionet:** evolucioni i gjuhës dhe zhvillimi i shkrimit, alfabeti, dukuritë gjuhësore, konvenca gjuhësore, bilinguizmi, multilinguizmi, diglosia.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- sqarojnë nocionin konvencë gjuhësore në enciklopedi, tekste studimore, antologji ose burime të tjera; gjejnë ilustrime të alfabeve (alfabeti grek, latin, arab etj.);
- përmendin gjuhët që dinë dhe i klasifikojnë ato në familjet e gjuhëve përkatëse, bëjnë skema;
- komentojnë grafikun (trungun) e gjuhëve indoevropiane dhe statusin e gjuhës shqipe në atë trung; thonë mendimin e vet për statusin e gjuhës shqipe në Malin e Zi aktual, duke pasur parasysh bilinguizmin, multilinguizmin dhe diglosinë;
- flasin mbi tolerancën gjuhësore në mjedise ku fliten më shumë se një gjuhë.

Rezultati edukativo – arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë për ta kuptuar zhvillimin historik të gjuhës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- ndjekur dhe kuptuar zhvillimin e gjuhës shqipe deri në shekullin XIX;
- krahasuar gjendjen e gjuhës shqipe në periudhën e Rilindjes Kombëtare me gjuhën shqipe të sotme;
- kuptuar rëndësinë e të folmes (gjuhës) së arbëreshëve;
- sqaruar ndërlidhjen e ngjarjeve shoqërore me situatën gjuhësore;
- kuptuar procesin e standardizimit të gjuhës shqipe;
- dalluar gjuhën letrare nga gjuha standarde.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 6

Përmbajtja/nocionet: standardizimi, kodifikimi

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- shikojnë një dokument të vjetër të shkruar në gjuhën shqipe, vërejnë karakteristikat e shkrimit dhe të tekstit;
- flasin me argumente për gjendjen e tashme në një hapësirë të zgjeruar gjuhësore;
- i rifreskojnë dhe i ndërlikojnë njohuritë e veta në tekste të shkruara në varietetet e gjuhës së vjetër letrare, hetojnë ndryshimet dhe risitë;
- sqarojnë dallimet ndërmjet gjuhës letrare dhe asaj standarde, në shembuj.

Rezultati edukativo – arsimor 7

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për ta kuptuar vendin dhe rëndësinë e morfologjisë si disiplinë gjuhësore dhe lëndën studimore të saj.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar dhe përdorur nocionet *morfemë dhe alomorf*;
- njohur dhe bërëë klasifikimin e llojeve të fjalëve (të ndryshueshme dhe të pandryshueshme, të mëvetësishme dhe jo të mëvetësishme);
- dalluar në tekste nocionet e përmendura dhe t'i emërtojë me shprehjet adekuate;
- vërejtur dhe përdorur drejt në të folur dhe në të shkruar.
 - njohur kategoritë gramatikore;
 - **njohur funksionet sintaksore të të gjitha llojeve të fjalëve;**
 - njohur dhe përdor trajtat enklitike gjatë përdorimit të përemrave;
 - vërejtur dhe përdorur trajtat e shkurtra dhe të gjata të përemrave.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 7

Përmbajtja/nocionet: morfologjia, morfema, alomorfi, parashtesa, prapashtesa, morfema lidhëse, llojet e fjalëve

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- dallojnë në fjalë parashtesat, prapashtesat, morfemat lidhëse dhe mbaresat;
- gjejnë dhe shënojnë, në tekstet e zgjedhura, fjalë të funksioneve stilistike të ndryshme, njohin dhe klasifikojnë kategoritë gramatikore e funksionet stilistike dhe i sqarojnë ato, i sintetizojnë njohuritë;

Rezultati edukativo – arsimor 8

Në fund të mësimit nxënësi njih dhe zbaton rregullat e drejtshkrimit.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të:

a) shkruaj drejt:

- shkronjën e madhe (emrat e përveçëm, emrat gjeografikë, titujt e librave/veprave letrare/teksteve mësimore, gazetave, revistave, filmave, emisioneve, ligjeve, deklaratave, marrëveshjeve, konferencave, kongreseve, departamenteve, ngjarjeve historike; përemrat Ju dhe Juaj; titullimi i personaliteteve të lartë laikë dhe shpirtërorë);

b) shkruaj drejt:

- fjalët ndaras dhe bashkë;
- fjalët e prejardhura dhe të përbëra;
- ndarjen e fjalës në fund të rreshtit;
- nyjen e përparme;
- trajtat e shkurtra të përemrit;
- shenjat e pikësimit (pikën, pikën çuditëse, pikëpyetjen, tri pikat, thonjëzat, kllapat, vizën);

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 8

Përmbajtja/nocionet: shkronja e madhe, të shkruarit e fjalës bashkë dhe ndaras, ndarja e fjalës në fund të rreshtit, shenjat e pikësimit, shenjat drejtshkrimore

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- korrigjojnë gabimet drejtshkrimore në tekst;
- bëjnë ushtrime drejtshkrimore; i lidhin me pjesët e ligjëratës.

MËSIMI I LETËRSISË

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të letërsisë së bejtexhinjve.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- përcaktuar kohën, rrethanat dhe nevojën e paraqitjes së letërsisë së bejtexhinjve;
- dalluar veçoritë dhe karakterin laik të veprave të tyre;

- kuptuar rëndësinë e veprave të kësaj letërsie;
- përfunduar se karakteristikë e përbashkët e këtyre teksteve është se nuk shtjellojnë syzhe fetare; në to ndiehet ndikimi i madh arab e turk në shprehje dhe në format letrare të Lindjes;
- kuptuar dhe dalluar format poetike të Lindjes të cilat i krijojnë këta autorë si: kasida, gazela, rubaira dhe divanin;

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 1

Përmbajtja/ nocionet: letërsia e bejtexhinjve: përfaqësuesit kryesorë, Hasan Zyko Kamberi, poezia “Paraja”

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- paraqesin dhe ilustrojnë dallimet në mes letërsisë së vjetër dhe letërsisë së bejtexhinjve;
- lexojnë fragmente nga vepra të ndryshme të letërsisë së bejtexhinjve, duke vënë në dukje cilësitë e veçanta si jetën qytetare me përfytyrime personale e sociale, me jetën e përditshme të kohës;
- lexojnë dhe interpretojnë poezinë “Paraja”, të Hasan Zyko Kamberit duke veçuar motiv aktual të saj.

Rezultati edukativo – arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar periodizimin e letërsisë nga aspekti historik; t’i kuptojë rrethanat shoqërore e historike dhe ndikimin e tyre mbi autorin dhe gjenezën e veprës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- shpjeguar dallimet në kuadër të gjinive letrare përgjatë epokave nga baroku e deri te realizmi;
- krahasuar barokun me klasicizmin dhe të bëjë dallimin në mes tyre;
- përcaktuar veçoritë e iluminizmit;
- dalluar klasicizmin nga romantizmi dhe romantizmin nga realizmi;

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 2

Përmbajtja / nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në grupe bëjnë periodizimin e letërsisë;
- dëgjojnë dhe lexojnë vepra letrare;
- mbajnë ditarin e shënimeve
- në pjesët e zgjedhura krahasojnë epokat;
- në formë tabelare paraqesin veçoritë e epokave letrare.

Rezultati edukativo – arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar dhe analizuar tekstet letraro-artistike të epokës së caktuar.

Arritjet e të nxënit**Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:**

- analizuar një vepër letrare duke theksuar veçoritë e llojit letrar të cilit i përket;
- përcaktuar gjininë letrare të një teksti (lirika, epika, dramatika) dhe llojin letrar;
- gjetur temën dhe motivet në të;
- shpjeguar karakteristikat e gjuhës poetike;
- dalluar figurat letrare në një tekst lirik;
- analizuar vargun në një tekst poetik;
- bërë lidhjen e përmbajtjes me ndërtimin strukturor të poezisë (efektet e përsëritjes, renditjen e tablove poetike);
- vërejtur elementet strukturore të veprës epike si vendin, kohën dhe hapësirën;
- paraqitur në mënyrë koncize fabulën si dhe të vërejtë digresionet dhe episodet;
- vërejtur vlerën etike dhe didaktike të një vepre;
- zhvilluar aftësitë interpretative të një teksti letrar artistik;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 3**Përmbajtja/nocionet:****Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:**

- lexojnë/dëgjojnë një vepër letrare;
- analizojnë një vepër në mënyrë individuale, në çift apo në grupe;
- theksojnë disa karakteristika të formës së veprës letrare;
- (përcaktojnë gjininë, llojin duke e argumentuar përgjigjen);
- theksojnë karakteristikat e strukturës së veprës letrare, kompozicionin e saj dhe elementet e tjera duke e argumentuar mendimin e vet;

- bëjnë lidhjen e formës me përmbajtjen e tekstit dhe e shpjegojnë atë;
- ilustrojnë veçoritë e gjuhës poetike duke theksuar figurat më të përdorura letrare.

Numri (orientues) i orëve për realizimin e rezultateve edukativo-arsimore 1,2,3:

Rezultati edukativo – arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të përjetuar dhe analizuar tekste letrare e artistike të epokave të ndryshme dhe krijon tekste me gojë dhe me shkrim;

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- shprehur me gojë dhe me shkrim përjetime, emocione, qëndrime dhe mendime dhe t'i njohë ato në një tekst letrar artistik;
- vendosur një paralele për bazën e kontrasteve në raport me veprat e epokave të ndryshme, apo të ngjashmërive tematike, motivore e ideore;
- theksuar rëndësinë e vlerës estetike dhe didaktike të veprës;
- interpretuar përmendësh një tekst të shkurtër me ç'rast tregon aftësinë e përjetimit estetik dhe të interpretimit;
- përgatitur të shprehurit me gojë të një teksti letrar artistik nga një aspekt i caktuar;
- shkruar një tekst për një vepër të lexuar (përshkruan personazhin, paraqet ngjarjen dhe bën një analizë letrare për veprën);
- shkruar një koment mbi veprën duke u bazuar në qëndrimet dhe mendimet e veta;
- bërë shkrime të vogla hulumtuese, punime seminari duke respektuar rregullat themelore të punës shkencore;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 4

Përmbajtja/nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- analizojnë një tekst letrar artistik duke theksuar karakteristikat themelore (gjininë letrare, llojin letrar, temën, personazhet, etj.);
- shprehin përjetimin e tyre për veprën duke e shpjeguar atë;
- japin mendimin e vet për veprën duke e ilustruar me tekst;
- shpjegojnë veçantësitë e disa llojeve letrare në raport me epokën së cilës i përkasin;
- vendosin një paralele duke theksuar ngjashmëritë dhe dallimet poetike, tematiko-motivore dhe ideore të tekstit;
- mbajnë shënime për përjetimet, emocionet e paraqitura, mendimin dhe njohuritë e marra nga teksti letrar artistik;
- paraqesin të mësuar përmendësh një tekst;

- përgatisin me gojë një tekst letrar artistik nga një aspekt i caktuar;
- shkruajnë një tekst për një vepër të caktuar;
- bëjnë një shkrim të shkurtër për një vepër të caktuar;
- bëjnë punime seminari duke respektuar rregullat themelore të punës shkencore;

Rezultati edukativo – arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të barokut si drejtim letrar, historik e kulturor;

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar rrethanat historike e shoqërore të cilat kanë ndikuar në lindjen e barokut në kulturë dhe në arte;
- dalluar veçoritë e barokut në një vepër letrare si dhe në artet e tjera (muzikë, pikturë, arkitekturë);
- njohur cilësitë e barokut (hiperbolizimin e ndjenjave, ekspresivitetin e shprehjes, grumbullimin e fjalëve, subjektivitetin e heroit, shkrirjen e botës imagjinare me realitetin në përjetimet e heroit, përshkrimet e detajuara);
- dalluar karakteristikat e stilit të barokut në një tekst letrar;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 5

Përmbajtja/nocionet: - baroku (hiperbolizimi i ndjenjave, ekspresiviteti i shprehjes, subjektiviteti i heroit, shkrirja e botës imagjinare me realitetin në përjetimet e heroit, përshkrimet e detajuara)

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- shikojnë fotografi të disa objekteve karakteristike të barokut dhe i krahasojnë me ndërtimet bashkëkohore në mjedisin e tyre (pamjen, dritaret, brendësinë e objekteve sakrale);
- shikojnë monografite e piktorëve të barokut;
- dëgjojnë muzikë të barokut;
- dëgjojnë operë të periudhës së barokut;
- në një vepër letrare gjejnë elementet e barokut;
- në vepër gjejnë cilësitë e poetikës së barokut për kalueshmërinë e jetës);
- argumentojnë stilin letrar në bazë të veprave të artit figurativ dhe të arkitekturës;
- shikojnë një shfaqje teatrale për një nga veprat e dhëna;
- bisedojnë për periudhën e barokut dhe të renesancës duke bërë krahasimin në mes tyre;
- në veprat e barokut gjejnë elementet e kësaj.

Rezultati edukativo – arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të klasicizmit si drejtim letrar e historik;

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar dallimin në mes të drejtimit të klasicizmit (gjuha e zgjedhur, qartësia, harmonia, vërtetësia, ndjenja për masën, kulti i rregullave, shprehja e prerë, antika si model) dhe termave klasike;
- kuptuar se klasicizmi kishte për model letërsinë antike;
- kuptuar se në kohën e klasicizmit ka pasur krijues që konsideroheshin gjeni;
- njohur paraqitjen e personazheve të përhershëm në letërsi;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 6

Përmbajtja/nocionet: klasicizmi (gjuha e zgjedhur, qartësia, harmonia, vërtetësia, ndjenja për masën, kulti i rregullave, shprehja e prerë, antika si model)

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë/dëgjojnë tekste nga epoka e klasicizmit;
- në tekst vërejnë cilësitë e stilit të klasicizmit;
- komentojnë veprat e lindura në klasicizëm (muzika, piktura);
- bëjnë krahasimin e një vepre të klasicizmit me një vepër nga antika;
- në tekst shpjegojnë veprimet komediografike dhe formësimin dramaturgjik të tekstit;

Rezultati edukativo – arsimor 7

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të iluminizmit si epokë shoqërore e cila solli ndryshime në shkencë, letërsi dhe arsim.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar iluminizmin si një raport i ri ndaj njeriut dhe marrëdhënieve shoqërore;
- kuptuar iluminizmin si epokë shoqërore në të cilën ndërthuren formacionet stilistike dhe shkenca;
- kuptuar se në iluminizëm vepra ketrare ka, para së gjithash, karakter edukativo-moral;
- kuptuar dhe vënë theksin te lëvizja letrare e Voskopojës, dhe përfaqësuesit e saj, si pjesë përbërëse e lëvizjes së gjerë që zhvillohej në Ballkan nën ndikimin e iluminizmit perëndimor;

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 7

Përmbajtja/nocionet: iluminizmi, iluminizmi në Voskopojë – përfaqësuesit: Teodor Kavalioti, Teodor Haxhifilipi.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- mbledhin informacione nga enciklopedia dhe fjalori;
- në tekst veçojnë idetë e iluminizmit, bëjnë dallimin e letrares nga utilitarja;
- lexojnë tekste nga enciklopedia
- bisedojnë për vlerat e konceptit qytetar, lirinë e individit, qëndrimin ndaj dënimit me vdekje;
- komentojnë idetë e kohës së iluminizmit duke i lidhur ato me kohën e vet;
- vënë në dukje idetë universale të iluminizmit;
- shpjegojnë kuptimin e ligjit, rregullave dhe rregulloreve;
- diskutojnë për utilitarizmin e letërsisë (për/kundër);
- lexojnë të dhënat për autorët dhe veprimtarinë atdhetare të tyre.

Rezultati edukativo – arsimor 8

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të romantizmit, epoka e cila solli një stil të ri të shprehjes dhe një raport të ri me artin; njohin karakteristikat kryesore të romantizmit në letërsinë shqiptare.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar romantizmin si dukuri kulturore dhe letrare;
- vërejtur ndikimin e romantizmit në formimin e vetëdijes kombëtare;
- vënë në dukje raportin e krijuesve romantikë me realitetin dhe shoqërinë;
- kuptuar konceptin e *bajronizmit*;
- kuptuar se romantizmi ndërtohet mbi bazën e imagjinatës, ndjenjave dhe rikthimin në të kaluarën historike të popullit (kultin e krijimtarisë popullore);
- kuptuar aspiratat e poetit për përsosmërinë e formës dhe përmbajtjes në vepër;
- kuptuar transformimet e gojores dhe legjendares në veprën letrare, dhe transformimin e elementeve të prototipeve dhe të personalitetit;
- dalluar të vërtetën historike nga ajo letrare;
- zbuluar kuptimet universale në veprën letrare;
- njohur elementet komike dhe të humorit në vepër;
- kuptuar sonetin si një nga krijimet artistike ku poeti me mjeshhtëri harmonizon elementet në poezinë me formë të prerë;
- kuptuar në tekstet lirike sensibilitetin që sjell romantizmi;
- analizuar figurat stilistike dhe metrikën në poezitë e romantizmit, përkatësisht shpjeguar funksionin e tyre estetik dhe vlerat ideore;

- analizuar poezinë si një strukturë dinamike tingullore dhe kuptimore e shoqëruar me ide dhe përmbajtje që vë në dukje shumëkuptimësinë e veprës letrare
- kuptuar formën e poemës si një prej llojeve letrare të veçanta të romantizmit
- kuptuar qëndrimin e romantikëve ndaj së kaluarës kombëtare shqiptare;
- hetuar kohën e *Motit të madh* në veprat e romantikëve duke kuptuar porosinë.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 8

Përmbajtja/nocionet: -romantizmi, bajronizmi, romantizmi në letërsinë shqipe, shoqëritë, shkollat dhe shtypi shqiptar, mbledhësit e folklorit shqiptar- përfaqësuesit: Zef Jubani, Thimi Mitko, Spiro Dine etj.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- diskutojnë për mospërputhjet e idealeve me realitetin;
- bisedojnë për mirëkuptimin;
- lexojnë/dëgjojnë vepra letrare;
- mbajnë ditarin e shënimeve;
- shikojnë filmin e Eugjen Onjeginit;
- pasi dëgjojnë muzikë dhe kompozicione nga periudha e romantizmit paraqesin përjetimet e veta;
- dallojnë nocionet *metodë* dhe *drejtim* dhe njohin metodat në veprat e epokave të tjera;
- bëjnë krahasimin e romantizmit me klasicizmin dhe iluminizmin;
- lexojnë një tekst duke vënë në dukje poetikën e romantizmit;
- njohin cilësitë e *bajronizmit* në tekst;
- dallojnë dhe paraqesin cilësitë e romanit në vargje;
- gjejnë motivet tipike romantike dhe mjetet stilistike të shprehjes;
- përcaktojnë kuptimin e shtresimeve tingullore, ideore dhe të subjektivit;
- përcaktojnë përkatësinë zhanrore të veprës;
- krahasojnë vepra me përmbajtje të njëjtë;
- krahasojnë romantizmin me epokat e tjera;
- bëjnë lidhjen e personazheve me epokën letrare;
- shpjegojnë me shembuj konkretë cilësitë e stilit romantik;
- dallojnë cilësitë universale të personazheve të romantizmit (Skenderbeu, Fausti, Haroldi, Prometeu...)
- bëjnë projekte duke përdorur figurat stilistike;
- shikojnë një dramë dhe krahasojnë skenarin me tekstin e veprës dramatike.

Rezultati edukativo – arsimor 9

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur dhe kuptuar karakteristikat themelore të realizmit si dukuri dhe si metodë letrare.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- dalluar qasjen realiste ndaj përpunimit të temës, që dallon nga realizmi si drejtim;
- vënë në dukje fazat e ndryshme të realizmit;
- dallon realizmin kritik hiperealizmin;
- shpjegon cilësitë e romanit si lloj letar dhe klasifikimin e romanit;
- pasqyron zhvillimin e romanit dhe tregon llojet e tij;
- raporton për romanin në përgjithësi dhe analizon specifikat e tij;
- vërejtur në vepër modelin rrëfimtari të paraqitjes së botës, krijimin dhe konstituimin e tij në vetëdijen e lexuesit;
- shpjeguar parimet e romanit paralel dhe unitetin e tërësisë së veprës;
- njohur natyrën e komedisë dhe zgjidhjet dramaturgjike si dhe qasjet tradicionale dramatike (ndryshimi i identitetit);
- vërejtur elementet e satirës dhe alegorisë në vepër nga këndvështrimi dhe raporti i autorit me problemet shoqërore ;
- zhvilluar raportin kritik ndaj dukurive të devijuara shoqërore;
- kuptuar cilësitë e stilit dhe gjuhës realiste;
- vërejtur dhe shpjeguar natyrën e krijimeve lirike në raport me romantizmin;
- kuptuar alegorinë në poezi;
- përdorur literaturën në mënyrë kritike
- dalluar veçoritë e realizmit shqiptar;
- bërë krahasimin e realizmit shqiptar me atë evropian

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 9

Përmbajtja/nocionet: realizmi, llojet e romanit, realizmi në letërsinë shqipe

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- nga jeta e përditshme gjejnë situata dhe i krahasojnë me ato të realizmit;
- shikojnë shfaqje realiste;
- analizojnë krijime të artit dhe dallojnë reproduksionet;
- shënojnë veçoritë kryesore nga vepra;
- mbajnë ditarin e leximeve;
- shprehen me gojë;
- diskutojnë për besueshmërinë (motivimin) e personazheve;
- bëjnë listën e situatave tipike të personazheve...
- interpretojnë vepra duke u nisur nga qasjet problematike;
- krahasojnë forma të ndryshme të shprehjes (filmi-vepra letrare);
- lexojnë fragmente duke theksuar rolin e detajit dhe kuptimet simbolike;

- gjejnë elementet strukturore të dramës, transformimin e komedisë klasike në raport me figurat tipike komediografike dhe situatat dramatike;
- theksojnë karakteristikat e gjuhës realiste në vepër (gjuhën e rrëfimitarit dhe gjuhën e peronazheve- dialekti, sociolekti
- shkruajnë një satirë për një temë aktuale;
- përdorin fjalorin e termave letrarë.

Rezultati edukativo – arsimor 10

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar se ekziston letërsia argëtuese.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar rolin e letërsisë argëtuese (pushimi dhe zbavitja);
- shpjeguar faktin se letërsia argëtuese lexohet nga një masë e gjerë lexuesish
- krahasuar letërsinë argëtuese me letërsinë klasike;
- kuptuar letërsinë triviale;
- kuptuar dalimin në mes letërsisë argëtuese dhe kështu letrar.

Rekomandime didaktike për realizimin e rezultateve edukativo – arsimore 10

Përmbajtja/nocionet: letërsia argëtuese

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë pjesë nga letërsia argëtuese
- përmendin tituj që i përkasin letërsisë argëtuese;
- krahasojnë veprën e letërsisë argëtuese me filmin/serialin TV të xhiruar në bazë të veprës;
- vërejnë elementet e kështu;
- organizojnë diskutime për temën e kështu në artin bashkëkohor.

Prozë	Poezi	Dramë
Viktor. Hygoi: <i>Dita e fundit e një të burgosuri (fragment)</i> Leon Tolstoi: <i>Ana Karenina</i> Honore de Balzaku: <i>Evgjeni Grande</i> Xhek London: <i>Martin Iden (fragment)</i> Naum.Veqilharxhi: <i>Fletëqarkorja</i> Konstandin Kristoforidhi: <i>Gjahu i malësorve</i>	Xhorxh Gordon Bajroni: <i>Çajld Haroldi</i> Aleksandër Pushkini: <i>Eugjen Onjegini (fragment)</i> Edgar Alen Po: <i>Korbi</i> Jeronim.de Rada: <i>Këngët e Milosaos (fragment)</i> Gavrill Dara i Riu: <i>Kënga e sprasme e Balës</i> Zef Serembe: <i>Më të bukurës në Strigar</i>	Molieri: <i>Tartufi</i> Gogoli: <i>Revizori</i> Johan.Volfgan. Gëte: <i>Fausti (fragment)</i> Sami Frashëri: <i>Besa (fragment)</i> Anton Santori: <i>Emira</i>

	<p>Naim Frashëri: <i>Historia e Skenderbeut (fragment), Lulet e verës (poezi sipas zgjedhjes)</i> Ndre Mjedja: <i>Vaji i bylbylit</i> Petar Petroviq Njegoshi: <i>Kurora e maleve (fragment)</i> Ivan Gunduliqi: <i>Osman (fragment)</i> Andon Z.Çajupi: <i>Baba Tomorri, poezitë: Shqiptar, Vaje</i> Aleksandër Stavre Drenova-Asdreni: <i>Luftari lypës, Larg vatrës</i> Ali .Asllani: <i>Hanko Halla</i> Hasan Zyko Kamberi: <i>Paraja</i></p>	
<p>KANONET</p>		
<p>Pashko Vasa : <i>Bardha e Temalit</i> Jeronim de Rada: <i>Këngët e Milosaos</i> Naim Frashëri: <i>Lulet e verës</i> Andon Zako Çajupi: <i>Pas vdekjes</i> Aleksander S. Pushkini: <i>Eugjen Onjegini</i> Honore de Balzaku: <i>Xha Gorio</i> Leon Tolstoi: <i>Ana Karenina</i> Ernest Heminguej: <i>Plaku dhe deti</i> Ismail Kadare: <i>Kronikë në gur</i> Rexhep Qosja: <i>Vdekja më vjen prej syve të tillë</i> Petar Petroviq Njegoshi: <i>Kurora e maleve</i></p>		

Lista e teksteve të propozuara është hartuar sipas kriterit të vlerave estetike dhe në përputhje me moshën e zhvillimin kulturor të nxënësit. Nga kjo listë mësimdhënësi përzgjedh tekstet sipas kriterit profesional. Lista nuk e kufizon atë. Përkundrazi, ai është i lirë të përzgjedhë për lexim edhe tekste të tjera, që nuk janë në listë, por duhet të ketë kujdes për kriteret e cekura, si dhe për proporcionalitetin e gjinive e llojeve letrare, përkatësisht për qëllimet dhe arritjet e të nxënit në program.

VITI III

MËSIMI I GJUHËS

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të dëgjuar, lexuar, kuptuar, analizuar dhe krijuar tekste joletrare të përshtatura me moshën. Zhvillon shkathtësinë për të dëgjuar dhe analizuar tekste të folura me zë/, të ekranizuara dhe aftësinë për të krijuar në mënyrë të pavarur tekste të tilla si tekste shkencore të lidhura me përmbajtjet nga lëndët e tjera mësimore (histori e artit, histori e religjionit, sociologji...).

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur qëllimin dhe temën e tekstit;
- vërejtur fjalët kryesore dhe të rëndësishme në tekst dhe për t'i veçuar ato;
- vlerësuar vërtetësinë e të dhënave të përmendura;
- përcaktuar a është shkruar teksti në gjuhën standarde, a është tekst letrar apo joletrar;
- gjetur termat ose nocionet profesionale dhe për t'i sqaruar me ndihmën e fjalorit;
- hartuar planin e ligjërimit dhe për të realizuar vetë një paraqitje me fjalë;
- respektuar gjatë ligjërimit rregullin e kontinuitetit në tekst;
- mbrojtur me argumente qëndrimet e veta, për të polemizuar për përmbajtjen e tekstit, duke respektuar bashkëbiseduesin;
- dalluar stilet funksionale dhe krijuar aftëstë për t'i komentuar ato;
- qenë i kujdesshëm ndaj saktësisë dhe kuptueshmërisë së gjuhës.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 1

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas dëgjimit:

- bëjnë sistematizimin dhe klasifikimin e të dhënave të fituara;
- mësojnë nocionet kryesore dhe të dhënat e rëndësishme lidhur me to, i fusin në hartën e nocioneve të përgatitur më herët dhe i prezentojnë ato;
- shprehin mendimin e vet për tekstin dhe e arsyetojnë;
- flasin për përvojat, mendimet e veta;
- e plotësojnë vetë tekstin;
- bëjnë vetë paraqitje me gojë (për një temë të përgatitur më herët).

Para ligjërimit me gojë:

- mendojnë çfarë do të mund të thonin për temën dhe e hartojnë planin e ligjëratës;
- në burime të ndryshme kërkojnë të dhënat që u mungojnë dhe i shënojnë në planin e ligjëratës.

Gjatë ligjërimit me gojë:

- flasin në mënyrë të pavarur me ndihmën e **planit të ligjërimit** dhe janë të kujdesshëm për qartësinë dhe kuptueshmërinë e të folurit të vet.

Pas ligjërimit me gojë:

- e komentojnë paraqitjen me fjalë;
- polemizojnë për tema të caktuara;
- analizojnë, përmendin detaje nga teksti, u përgjigjen pyetjeve të shtruara;
- veten e vendosin në situatat e të tjerëve;
- zgjidhin probleme;
- gjykojnë për gjendjen aktuale dhe mundësinë e përdorimit të përmbajtjeve (të dhënave) nga tekstet e zgjedhura.

Rezultati edukativo – arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar nocionin dhe kuptimin e mediave.

Arritjet e të nxënit**Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:**

- identifikuar tipin e porosisë /informacionit që mund ta gjejë në ndonjërin nga llojet e mediave;
- dalluar llojet dhe zhanret e teksteve të mediave (informacioni, lajmi, reklama, porosia politike, zhanret argëtuese...);
- vërejtur dallimin ndërmjet ngjarjeve të botës empirike dhe mënyrës se si ato janë paraqitur në media (nuk e shprehin realitetin empirik, por krijojnë një realitet mediatik).

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 2**Përmbajtja/ nocionet:****Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:**

- në tekste vërejnë dhe analizojnë ngjashmëritë dhe dallimet në raport me atë se si e njëjta ngjarje (ndeshje sporti, tubim politik ose publik etj.) prezentohet në media të ndryshme (TV, shtyp, radio, internet);
- i shfaqin vërejtjet e veta për interpretimin e së njëjtës ngjarje në media të ndryshme dhe në kuadrin e një medie, dhe bëjnë reagimin/përjetimin e vet të parë;
- i vërejnë faktet në tekste (numrin, ngjashmëritë, dallimet, gjërat e njëjta...);
- në bazë të analizës, nxjerrin përfundimet në nivelin e grupit, në çift ose individualisht.

Rezultati edukativo – arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të lexuar, kuptuar dhe analizuar tekste shkencore e publicistike dhe aftësinë për të shkruar në mënyrë të pavarur tekste të ngjashme:

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur qëllimin dhe temën e tekstit;
- vërejtur dhe veçuar nocionet kryesore dhe të dhënat e rëndësishme në tekst;
- interpretuar pjesët jotekstore në kuadrin e tekstit;
- vlerësuar vërtetësinë e të dhënave të përmendura;
- përcaktuar a është shkruar teksti në gjuhën standarde, a është tekst letrar apo joletrar;
- dalluar ndryshimin ndërmjet stileve të shkrimit;
- gjetur nocionet profesionale dhe për t'i sqaruar me ndihmën e fjalorit;
- punuar planin e ligjërit;
- shkruar tekste publicistike, sipas zgjedhjes së vet;
- shkruar ese lidhur me një temë të caktuar (për një vepër letrare ose një sferë të veprimtarisë shoqërore);
- shkruar vetë një tekst të ngjashëm (diskutim, mbresë, prezentim);
- zgjedhur vetë temën e tekstit dhe për ta përpunuar në mënyrë adekuate, duke shfrytëzuar stilin e përshtatshëm funksional;
- përgatitur dhe shkruar tekste në njërin prej stileve publicistike (lajm, raport, intervistë, reportazh).

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 3

– **Përmbajtja/ nocionet:** diskutimi, mbresa, prezentimi, komentimi, intervista

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas leximit:

- shprehin mendimin e vet për tekstin dhe provojnë që ta mbështesin në argumente;
- rrëfejnë për përvojat dhe mendimet e veta lidhur me tekstin;
- përcaktojnë a është teksti letrar apo joletrar, i shkruar në variantin popullor apo në variantin standard dhe mendimin e vet e mbështesin në argumente;
- përcaktojnë a është teksti objektiv apo subjektiv dhe e formojnë mendimin e vet;
- e kthejnë një tekst subjektiv në tekst objektiv.

Shkruajnë vetë tekste, dhe:

- komentojnë një tekst/libër/film që e kanë zgjedhur vetë;
- rrëfejnë për një ngjarje sipas zgjedhjes, e përshkruajnë...

Para se të shkruajnë:

- mendojnë çfarë do të mund të shkruanin dhe e punojnë planin e shkrimit;
- kërkojnë të dhëna në burime të ndryshme dhe i fusin në planin e shkrimit;
- ideojnë dhe krijojnë një lloj të caktuar teksti.

Duke shkruar:

- të dhënat e planit të të shkruarit i shndërrojnë në tekst të shkruar, njëkohësisht janë të kujdesshëm për kompozicionin e tekstit;
- në fund të tekstit i përmendin burimet;
- sajojnë sa më shumë tituj (në fund e zgjedhin më të mirin) për një tekst të shkurtër (ngjarje interesante muzikore).

Pas shkrimit:

- e lexojnë tekstin dhe së pari në mënyrë të pavarur, e pastaj së bashku i korrigjojnë gabimet përmbajtësore, gramatikore dhe drejtshkrimore;
- e krahasojnë tekstin e vet me punimet e shokëve/shoqeve të klasës dhe japin vlerësime.

Rezultati edukativo – arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar procesin e fjalëformimit.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- sqaruar fjalëformimin (parashtesat dhe prapashtesat; kompozitat dhe fjalëformimi);
- sqaruar rolin e prapashtesës, parashtesës dhe morfemave lidhëse në fjalëformim;
- argumentuar me shembuj formimin e emrave, mbiemrave, foljeve dhe ndajfoljeve, duke i shkruar drejt;
- formuar familje fjalësh

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 4

Përmbajtja/ nocionet: fjalëformimi, parimet themelore të fjalëformimit, tipat produktivë të fjalëformimit.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në shembujt e dhënë sqarojnë fjalëformimin;
- japin shembuj (sipas analogjisë);
- ushtrojnë të shkruajnë drejt, bëjnë korrigjimin e gabimeve (vetëkorrigjimin).

Rezultati edukativo – arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për ta kuptuar lëndën e studimit të leksikologjisë dhe i emërton disiplinat e afërta me të.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- përdorur nocionet leksikologjike dhe njësitë leksikore dhe të vërejë marrëdhëniet zyrtare dhe semantike ndërmjet leksemave;
- ilustruar larminë leksikore;
- njohur sinonimin, homonimin/paronimin, hiponimin, antonimin dhe të mësojë për t'i përdorur ato;
- redaktuar tekstin, duke shfrytëzuar kuptimin e parë, kuptimin e figurshëm (metaforik) dhe kuptimin metonimik të fjalës;
- kuptuar ndikimin, gjegjësisht begatinë e arritur të domethënies;
- zhvilluar sensibilitetin gjuhësor, kulturën e të shkruarit;
- përdorur lloje të ndryshme fjalorësh;
- kuptuar dhe shfrytëzuar termat *lokalizëm, krahinarizëm, dialektizëm, ndërkombëtarizëm, arkaizëm, barbarizëm, neologjizëm, zhargonizëm, vulgarizëm, familjarizëm, kolokvializëm, purizëm*;
- vlerësuar tipin dhe karakterin e tekstit në bazë të leksemave;
- kuptuar domethënien e nocionit *purizëm* (pastërti gjuhësore);
- kuptuar çfarë është nocioni dhe cili është kuptimi i termave: lokucion, shprehje frazeologjike, klishe dhe kalk;
- bërë një vlerësim me stil lidhur me përdorimin e leksikut të ndryshëm;
- njohur një numër të caktuar fjalësh me prejardhje të huaj dhe krijojë aftësi për të gjetur trajtat adekuate në gjuhën shqipe.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 5

Përmbajtja/ nocionet: leksikologjia, leksikografia, fjalori, leksema, semantika leksikore, kategoritë leksiko-semantike, sinonimi, homonimi/paronimi, hiponimi, antonimi; lokalizmi, krahinarizmi, dialektizmi, ndërkombëtarizmi (fjalë me përdorim në shumë gjuhë), arkaizmi (fjalë e vjetër), neologjizmi, zhargonizmi, vulgarizmi, familjarizmi, kolokvializmi, lokucioni, shprehja frazeologjike, klishea, barbarizmi/huazimi, kalku.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- bëjnë ndërrimin e fjalëve në tekst, tërheqin vërejtjen për dallimet stilistike dhe semantike;
- zgjedhin fjalët, bëjnë redaktimin stilistik të tekstit përmes leksemave të zgjedhura, duke arritur kuptime të shumta;

- kërkojnë dhe sqarojnë domethënien e fjalëve që kanë trajta të ngjashme si: i rrejshëm - rrenacak, i tmerrshëm - tmerrues, interes – interesim etj.;
- njohin leksemat në tekst, vërejnë shembujt, vërejnë vlerën e tyre stilistike, i formësojnë ato;
- i dallojnë fjalët për nga prejardhja (nga cila gjuhë vijnë), kërkojnë fjalë të ngjashme në gjuhën shqipe;
- flasin për vlerën e stilit të tekstit;
- përmendin nocione të shkencave të ndryshme dhe nxjerrin përfundime a jemi „puristë“ a jo;
- hulumtojnë dhe shënojnë njësi frazeologjike nga jeta e përditshme;
- i sqarojnë dhe i vlerësojnë stilistikisht, japin shembuj për kalke;
- shkruajnë tekste duke përdorur fraza;
- njohin terminologjinë e një shkence të caktuar ose të një veprimtarie tjetër në tekstet e zgjedhura;
- punojnë fjalorë të sinonimeve, antonimeve;
- kërkojnë nocione në fjalorët përkatës;
- japin shembuj;
- përkthejnë dhe përshtasin në gjuhën shqipe.

Rezultati edukativo – arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar objektin e studimit të sintaksës; numëron njësitë sintaksore, bën dallimin e tyre dhe kupton marrëdhëniet hierarkike; në tekst vëren dhe kupton nocionet dhe funksionin e tyre në gjuhë.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- identifikuar gjymtyrën kryesore dhe të varur të togfjalëshit (ose sintagmës) dhe të bëjë klasifikimin e togfjalëshave: emërorë, përemrorë, numërorë, foljorë, ndajfoljorë, parafjalorë;
- vërejtur lokucionet/shprehjet frazeologjike pa kallëzues, për të kuptuar se ato janë fjali të paplota dhe plotësohen nga situata (konteksti) e bisedës;
- kuptuar se një tipar i fjalisë është ndarja në gjymtyrë;
- njohur dhe përdorur tipat e fjalive sipas llojit të kumtimit (fjalja dëftore, thirrmore, pyetëse, urdhërore, dëshirore);
- njohur dhe kuptuar domethënien dhe funksionin e gjymtyrëve të fjalisë (kallëzuesi, kryefjala, kundrinori, rrethanori, përcaktori, ndajshtimi);
- **kuptuar rregullin e përputhjes së kallëzuesit me kryefjalën në gjini e numër, si dhe të kryefjalës dhe kallëzuesit shumëgjymtyrësh.**

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 6

- **Përmbajtja/ nocionet:** sintaksa, fjalia dhe pjesët e fjalisë,
- sintagma (togfjalëshi)
- kongruenca e kryefjalës dhe e kallëzuesit

- kongruenca e përcaktorit
- të shënuarit e raporteve sintaksore
- struktura e fjalisë së thjeshtë
- koncepti i gjymtyrëve të fjalisë
- tipologjia e fjalisë së thjeshtë (fjalë pavetore, fjalë pa pjesët kryesore të zhvilluara)

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në tekstin e zgjedhur njohin tipat dhe ndërtimet e fjalive;
- hartojnë ndërtime fjalish sipas modelit;
- sqarojnë funksionalitetin e tyre dhe vlerat e stilit;
- simulojnë situata në të cilat përdorin ndërtime të caktuara;
- formojnë, ndërrojnë formën, vërejnë ngjashmëritë dhe dallimet;
- në tekst gjejnë shembuj, ushtrojnë të shkruajnë, korrigjojnë gabimet;
- në fjali vërejnë pjesët e saj, e njohin funksionin dhe domethënien.

Rezultati edukativo – arsimor 7

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të zbatuar rregullat e drejtshkrimit.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar dhe për t'i përdorur termat *transkriptim dhe transliterim*;
- bërë transkriptimin e fjalëve nga gjuhët e huaja, për t'i përshtatur me natyrën e gjuhës shqipe;
- ndryshuar fjalët me prejardhje të huaj dhe për t'ia përshtatur ato frymës së gjuhës shqipe;
- përdorur drejt termat e frekuentuar;
- shkruar drejt fjalët me origjinë të huaj;
- dalluar ndryshimin e emrave të huaj.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: transkriptimi, transliterimi

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- i vërejnë rregullat brenda tekstit;
- e korrigjojnë tekstin e vet ose tekstin e shokut/shoqes;
- vërejnë ndryshimin e emrave dhe mbiemrave të huaj, si p.sh. Zhan Pol Sartri, emrat femërorë anglezë, emrat mashkullorë të tipit Volt Dizni etj.;
- korrigjojnë gabimet drejtshkrimore në tekstet e zgjedhura.

MËSIMI I LETËRSISË

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar periodizimin e letërsisë nga aspekti historik; të kuptojë rrethanat historike-shoqërore si dhe ndikimin e tyre te autori dhe vepra.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar tekstet letrare të epokës moderne, drejtimin letrar të shekullit XX dhe letërsinë në mes dy luftave;
- shpjeguar ndryshimin e sensibilitetit dhe gjuhës poetike tradicionale në veprat moderne.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 1

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në grupe bëjnë periodizimin e letërsisë;
- lexojnë dhe dëgjojnë vepra letrare artistike;
- mbajnë ditarin e shënimeve;
- me shembujt konkretë krahasojnë epokat letrare;
- në formë tabelare parqesin veçoritë e secilës epokë.

Rezultati edukativo – arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të përjetuar dhe analizuar tekste letrare artistike të epokave të caktuara.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- analizuar një vepër të caktuar letrare duke theksuar veçantitë e llojit të cilit i përket;
- përcaktuar gjininë letrare të një teksti (lirika, epika dramatika) dhe llojin letrar;
- formuluar temën e veprës duke e zbërthyer në njësi më të vogla tematike, motive;
- shpjeguar veçoritë e gjuhës poetike;
- në tekstin lirik dallon figurat letrare më të përdorura;
- analizuar vargun në një poezi;
- analizuar formën dhe përmbajtjen e poezisë;
- vërejtur veçoritë e elementeve strukturore të veprës epike, hapësirën kohën dhe ngjarjet;
- paraqitur fabulën e veprës duke theksuar epizodet dhe digresionet;
- vërejtur sensibilitetin e autorit në dramën moderne dhe elementet moderniste në të;

- vërejtur dhe theksuar vlerat etike dhe didaktike të veprës.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 2

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- lexojnë një vepër letrare;
- analizojnë një vepër letrare në mënyrë individuale, në çift apo në grupe;
- theksojnë gjininë letrare apo llojin letrar të veprës dhe argumentojnë mendimet e veta;
- theksojnë elementet strukturore të veprës dhe të kompozicionit si dhe elemente të tjera duke i argumentuar mendimet e veta;
- shpjegojnë specifikat e disa llojeve letrare në raport me epokat, të cilave u përkasin;
- paraqesin dhe ilustronë cilësitë e gjuhës poetike duke theksuar figurat letrare;
- arsyetojnë përdorimin e ndonjë figure letrare duke treguar efektin e saj letrar.

Rezultati edukativo – arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar tekste letrare të epokave të ndryshme dhe për të krijuar vetë tekste me gojë dhe me shkrim.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- shprehur me gojë dhe me shkrim përjetimet, emocionet, mendimet e shkaktuar nga vepra letrare;
- theksuar vlerat etike dhe didaktike të veprës letrare;
- interpretuar përmendësh një tekst të shkurtër me ç' rast tregon aftësinë e përjetimit estetik dhe të interpretimit;
- përgatitur të shprehurit me gojë të një teksti letrar artistik nga një aspekt i caktuar;
- shkruar një tekst për një vepër të lexuar (përshkruan personazhin, paraqet ngjarjen dhe bën një analizë letrare për veprën);
- shkruar një koment për veprën duke u bazuar në qëndrimet dhe mendimet e veta;
- bërë shkrime të vogla hulumtuese, punime seminari duke respektuar rregullat e punimit shkencor.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 3

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- mbajnë ditarin e shënimeve;

- analizojnë një tekst letrar duke theksuar karakteristikat themelore (gjininë, llojin letrar, temën, personazhet etj.)
- paraqesin përjetimet e veta për tekstin;
- bisedojnë për mendimet e veta lidhur me me tekstin duke dhënë shembuj konkret nga teksti;
- paraqesin me shkrim përjetimet, emocionet, mendimet të shkaktuara nga vepra latrare;
- krijojnë një paralele në mes veprave të përzgjedhura;
- recitojnë përmendësh një tekst;
- përgatisin të shprehurit me gojë të një teksti letrar artistik nga një aspekt i caktuar;
- bëjnë punime seminari duke respektuar rregullat e punimit shkencor.

Rezultati edukativo – arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të njohur epokën moderne si dukuri letrare që karakterizohet me originalitetin e shprehjes.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar sintagmën letërsi moderne në shumë aspekte, si drejtim, si lëvizje, siç janë simbolizmi, impresionizmi;
- kuptuar ndikimin e shoqërisë në letërsinë moderne;
- shpjeguar pozitën dhe rolin e shkrimtarit në shoqëri, raportin e tij me shoqërinë (refuzimin e normave shoqërore të sjelljes, ikja nga shoqëria, mërzia dhe zbrastësia shpirtërore);
- përjetuar letërsinë moderne si ngacmim për lexuesin në kontekstin kohor të epokës si dhe jashtë saj
- sqaruar veçoritë e modernizmit evropian, shqiptar, malazias;
- sqaruar shkaqet e paraqitjes me vonesë të modernizmit në letërsinë tonë në raport me letërsinë evropiane.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 4

Përmbajtja/ nocionet: letërsia moderne, letërsia moderne evropiane (drejtimet kryesore), letërsia shqipe në gjysmën e parë të shekullit XX, prirjet sociale në letërsinë shqipe gjatë viteve të tridhjeta, prirjet e tjera në letërsinë shqipe gjatë viteve të tridhjeta.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- shpjegojnë termat modë, modern, modernizëm, moderne;
- shkruajnë ese për modën e veshjes, për muzikën, për stilit e jetesës, e të menduarit, e qëndrimit ndaj jetës;
- bëjnë lidhjen e poezisë moderne me lindjen e dukurive të më vonshme (rep, hip-hop, pank...);
- krahasojnë një vepër muzikore apo një fotografi nga epoka moderne me përmbajtjen e një vepre letrare;

- punojnë në grupe për interpretimin e pjesëve të rëndësishme të tekstit;
- shënojnë ngjashmëritë në mes të poezisë, pjesës muzikore dhe fotografisë;
- ndërtojnë paralele në çifte për sensibilitetin në romantizëm dhe sensibilitetin në letërsinë moderne;
- diskutojnë gojarisht temën Letërsia moderne kërkon një lexues modern...

Rezultati edukativo – arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar simbolizmin dhe impresionizmin si drejtime në suaza të modernes.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar ndikimin e letërsisë dhe të intelektualizmit në shfaqjen e simbolizmit;
- kuptuar rëndësinë e persiatjes drejt të bukurës ideale dhe bindjes se e bukura shfaqet përmes artit;
- shpjeguar shndërrimin e simboleve jetësore në simbole poetike;
- njohur në vepër veçoritë e simbolizmit dhe impresionizmit;
- dalluar në veprën moderne pesimizmin, iracionalen, dëshprimin, urrejtjen ndaj shoqërisë, përjashtimin nga shoqëria, ëndrrat, peizazhet;
- shpjeguar përdorimin e simbolit, metaforës në veprat moderne;
- shpjeguar ndikimin e letërsisë evropiane në letërsinë shqipe;
- njohur gërshetimin e motiveve tradicionale dhe moderne në veprën moderne dhe rëndësinë e elementeve folklorike
- folur në mënyrë kritike për lirinë, tabutë dhe ndalimet;
- vërejtur këndvështrimin e brendshëm dhe të jashtëm;

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: simbolizmi, impresionizmi

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- me shkrim dhe me gojë shprehin përjetimet e veta për tekstin letrar; të talentuarit për vizatim, vizatojnë;
- gjejnë dhe klasifikojnë figurat: simbolin, metaforën, oksimoronin etj.
- bëjnë krahasimin e termave modernë dhe bashkëkohorë;
- krahasojnë raportin e krijuesit modern me shoqërinë me raportin e krijuesit romantik;
- vënë në dukje se biografia e krijuesit/krijueses (sjellja publike) dhe arti i tij/i saj nuk janë çdo herë shprehje me të cilat identifikohen termat *nirvana*, *dekadent*, *hermetik*, *imanent*, ...
- krahasojnë përkthime të ndryshme të poezive lirike;
- krahasojnë një dramë impresioniste me një dramë klasike;
- dëgjojnë muzikë moderne dhe flasin për mbresat;
- shkruajnë ese me temën *Gruaja në letërsinë moderne dhe në epokat e tjera*;

- bëjnë punë kërkimore;
- shikojnë një film dhe e krahasojnë me veprën.

Rezultati edukativo – arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të treguar se cilat lëvizje dhe drejtime letrare përfshin pjesa e parë e shekullit XX.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- klasifikuar dukuritë letrare të shekullit XX (avangardën, modernizmin e vonshëm, postmodernizmin);
- shpjeguar kontekstin shoqëror e historik në të cilat shfaqet dhe zhvillohet avangarda;
- theksuar momentet kryesore në të cilat do të lindin dhe formohen dukuritë letrare në letërsi dhe në artet e tjera, që rezultuan me drejtimet dhe rrymat avangarde;
- kuptuar avangardën si mënyrë e ikjes nga tradicionalja në letërsi drejt ideve të reja e përparimtare;
- vënë në dukje cilësitë e avangardës në lirikë;
- vërejtur lidhjen e gjuhës poetike avangarde me shprehjen tradicionale të neoromantizmit dhe përmbajtjes romantike;
- kuptuar lindjen e kushtëzuar të më shumë drejtimeve, programeve e manifesteve letrare;
- kuptuar prirjet dhe parimet programore të ekspresionizmit, futurizmit, dadaizmit dhe prirjet sociale në letërsi;
- shpjeguar karakteristikat e veprës poetike avangarde (strukturën e veprës, modelin e transformimit të realitetit, prozën dhe dramën;
- vërejtur figurat stilistike (hipërbolën, ironinë,sarkazmin, krahasimet e pazakonshme, personifikimin, metaforën, vulgarizmat, neologjizmat);
- kuptuar se në këtë periudhë letrare kanë lindur vepra të cilat i takojnë të ashtuquajturit realizëm pa kufi;
- vërejtur botën hermetike të lirikës moderne;
- argumentuar ndryshimin e këndvështrimeve;
- treguar zhvillimin e romanit veçanërisht atij psikologjik, roman-kronik, roman-parabolë;
- folur për nacionalen dhe humanen në veprën letrare;
- njohur arketipet themelore;
- shkruar ese për një vepër të lexuar duke respektuar rregullat e shkrimit eseistik.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 6

Përmbajtja/ nocionet: letërsia avangarde në fillim të shekullit XX (ekspresionizmi, surealizmi, futurizmi, prirja sociale në letërsi)

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- theksojnë zbulimet më të mëdha të shekullit XX;

- bisedojnë rreth ndikimit të rrethanave historike (revolucionet, luftrat, regjimet, ideologjitë) që ndikuan në lindjen dhe zhvillimin e letërsisë si dhe lidhjen e letërsisë me këto rrethana;
- shikojnë fotografitë e Pikasos dhe Dalit dhe të piktorëve të tjerë duke komentuar shfaqjen realiste;
- në shprehjet gjuhësore gjejnë vulgarizmat, neologjizmat dhe shpjegojnë funksionin e tyre letrar;
- në grupe punojnë tekste surrealistë;
- në tekste gjejnë elemente të ekspresionizmit, surealizmit, futurizmit dhe prirjet sociale në letërsi;
- ndërtojnë tabelën e autorëve dhe drejtimeve avangarde të cilave i përkasin;
- dëgjojnë muzikë avangarde;
- hartojnë tekste lidhur me veprën dhe opusin krijues të autorit;
- në grupe në mënyrë argëtuese përkufizojnë poezinë moderne;
- sjellin në klasë revista letrare dhe lexojnë tekste;
- shikojnë një film;
- analizojnë një ese;
- shkruajnë ese;
- komentojnë esetë e nxënësve të tjerë;
- shkruajnë variantin e përmirësuar të esesë së vet.

Tekstet e propozuara

Prozë	Poezi	Dramë
Gystav Flober: <i>Zonja Bovari (fragment)</i> Fjodor Dostojevski: <i>Krimi e dënimi</i> Sterjo Spasse: <i>Pse (fragment)</i> Haki Stërmilli: <i>Sikur t' isha djalë (fragment)</i> Faik Konica: <i>Doktor Gjilpëra (fragment), eseistikë: Shqipëria kopsht shkëmbor i Evropës juglindore (fragment)</i> Mitrush Kuteli: <i>E madhe është gjëma e mëkatit</i> Ernest Koliqi: <i>Tregtar flamujsh</i> Migjeni - <i>Proza të zgjedhura</i>	Sharl Bodleri: <i>Albatrosi</i> Stefan Malarme: <i>Mjellma</i> Artur Rembo: <i>Ofelia</i> Lasgush Poradeci: <i>Vdekja e Nositit</i> Fan Noli: <i>Anës lumejve e poezi të tjera</i> Migjeni: <i>Poema e mjerimit</i> Esad Mekuli: <i>Kush i pari bani</i> Vitomir Nikoliq: <i>Poezi (sipas zgjedhjes)</i> Jovan Duçiq: <i>Luledielli</i>	A. Çehovi: <i>Xhaxha Vanja</i> Gjergj Fishta: <i>Juda Makabe (fragment)</i>

KANONET:

Sharl Bodleri: *Lulet e së keqes*

Ndre Mjeda: *Juvenilja*

Gjergj Fishta: *Lahuta e Malcis*

Ernest Koliqi: *Pasqyrat e narçisit*
Mitrush Kuteli- *Tregime e novela të zgjedhura*
Anton Harapi- *Andrra e Pretashit*
Faika Konica: *Doktor Gjilpëra*
Lasgush Poradeci: *Vallja e yjeve*
Ismail Kadare: *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*
Mehmet Kraja: *Udhëzime për kapërcimin e detit*

Lista e teksteve të propozuara është hartuar sipas kriterit të vlerave estetike dhe në përputhje me moshën dhe zhvillimin kulturor të nxënësit. Nga kjo listë mësuesi përzgjedh tekstet sipas kriterit profesional. Lista nuk e kufizon atë. Përkundrazi, ai është i lirë të përzgjedh për lexim edhe tekste të tjera, që nuk janë në listë, por duhet të ketë kujdes për kriteret e cekura, si dhe për proporcionalitetin e gjinive dhe llojeve letrare, përkatësisht për qëllimet dhe arritjet e të nxënësit në program.

Viti IV

MËSIMI I GJUHËS

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të dëgjuar, lexuar, kuptuar dhe analizuar tekste joletrare, si dhe për të krijuar vetë tekste të tilla.

Arritjet e të nxënësit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur qëllimin dhe temën e tekstit;
- vërejtur dhe veçuar fjalët kryesore dhe të dhënat e rëndësishme në tekst;
- gjykuar lidhur me (pa) vërtetësinë e të dhënave të theksuara;

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 1

Përmbajtja/nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Pas dëgjimit:

- shkruajnë përgjigje që përmbajnë informata të rëndësishme;
- bëjnë sistematizimin dhe klasifikimin e të dhënave të fituara, duke i veçuar të rëndësishmet nga të parëndësishmet;
- nocionet kryesore dhe të dhënat e rëndësishme që kanë lidhje me to i fusin në hartën e gatshme të nocioneve;

- shprehin mendimin e vet dhe provojnë ta arsyetojnë;
- flasin mbi përvojat, mendimet e veta;
- e plotësojnë vetë tekstin;

Para ligjërimit me gojë:

- mendojnë çfarë do të mund të thonin për temën dhe hartojnë planin e ligjëratës; kërkojnë në burime të ndryshme të dhënat që u nevojiten, duke e shndërruar planin në një bazë të shkruar për ligjërimin me gojë.

Gjatë ligjërimit:

- flasin të pavarur me ndihmën e bazës (skicës) me shkrim, qartë dhe natyrshëm; pas ligjërimit (paraqitjes me fjalë) dëgjuesit i shprehin mbresat e veta.

Rezultati edukativo – arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të dëgjuar dhe analizuar tekste joletrare të folura, të lexuara, me zë/të ekranizuara dhe për të krijuar tekste të ngjashme, dhe tekste shkencore, që kanë lidhje me përmbajtjen e lëndëve të tjera mësimore (për shembull të artit viziv, individit në grup, filozofisë...).

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- dalluar a është shkruar teksti në gjuhën standarde, a është letrar apo joletrar,
- njohur dallimin ndërmjet stileve të shkrimit, ligjëruar (një temë të përgatitur më parë), duke pasur përgatitjen me shkrim.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 3

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- zbulojnë dhe e sqarojnë artin e të bindurit në tekstet e mediave të ndryshme (konstatime nxitëse, stile joshëse të të jetuarit, trende popullore, luks, personalitete të lavdishme, dëshmi personale);
- zbulojnë dhe i sqarojnë dallimet në receptim te grupet e ndryshme shoqërore (sipas moshës, seksit, statusit shoqëror, shkallës së arsimit, interesave specifike, etnicitetit...);
- ligjërojnë vetë me gojë (me një temë paraprakisht të përgatitur).
- pas ligjërimit (paraqitjes me fjalë) dëgjuesit i shprehin mbresat e veta.

Rezultati edukativo – arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar nocionet, funksionin dhe rëndësinë e mediave.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur dhe krahasuar tipin e porosisë/informatës që mund ta gjejë në media të veçanta;
- dalluar mediat njëkahëshe prej atyre interaktive,
- vërejtur dallimin ndërmjet ngjarjeve në botën empirike dhe mënyrës si ato ngjarje paraqiten në media, gjegjësisht se të gjitha tekstet e mediave janë konstruksione;
- vërejtur mënyrat në të cilat tekstet e mediave ndikojnë te marrësi (recipienti);
- kuptuar në cilën mënyrë kuptimi i porosisë varet nga karakteristika e recipientit.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 3**Përmbajtja/ nocionet: informata, porosia, media njëkahëshe, marrësi (recipienti)****Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:**

- zbulojnë dhe e sqarojnë artin e të bindurit në tekstet e mediave të ndryshme (konstatime nxitëse, stile joshëse të të jetuarit, trende popullore, luks, personalitete të lavdishme, dëshmi personale);
- zbulojnë dhe i sqarojnë dallimet në receptim te grupet e ndryshme shoqërore (sipas moshës, seksit, statusit shoqëror, shkallës së arsimit, interesave specifike, etnicitetit...).

Rezultati edukativo – arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar dhe analizuar tekste shkencore dhe publicistike dhe për të shkruar vetë tekste të ngjashme (për shembull të artit viziv, individit në grup, filozofisë..., ditarin, paraqitjen në konkurs).

Arritjet e të nxënit**Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:**

- kuptuar qëllimin dhe temën e tekstit;
- dalluar nocionet kryesore dhe të dhënat e rëndësishme në tekst dhe për t'i veçuar ato;
- gjetur të dhënën e kërkuar në përmbajtje (në pjesën jotekstore);
- vlerësuar vërtetësinë e të dhënave të përmendura;
- përcaktuar a është shkruar teksti në gjuhën standarde, a është tekst letrar apo joletrar;
- dalluar stilet e ndryshme të shkrimit;
- hartuar planin e ligjërimit dhe për të ligjëruar vetë me gojë (për një temë të përgatitur më herët);
- njohur dhe dalluar stilet funksionale.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 4**Përmbajtja/ nocionet: ditari, paraqitja në konkurs, lektorimi, korrektura, redaktimi**

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

Lexojnë tekste joletrare të shkurtra.

Pas dëgjimit:

- shprehin mendimet e vet mbi tekstin dhe përpiqen që ta arsyetojnë;
- flasin mbi përvojat dhe mendimet e veta lidhur me tekstin;
- përshkruajnë pjesët jotekstore (p. sh. skemat përmbajtësore, grafikat etj.);
- sqarojnë dallimin ndërmjet stilit artistik dhe stileve të tjera.

Shkruajnë vetë tekste:

- rrëfejnë për një ngjarje sipas zgjedhjes së vet;
- shkruajnë tekste sipas mostrës dhe me zgjedhje (hulumtojnë, vjelin material);
- shkruajnë informata administrative (paraqitje në konkurs, shpallje për vende të lira pune, ditar).

Gjatë shkrimit:

- mbi bazën e planit të shkrimit krijojnë një tekst të shkruar; duke pasur kujdes ndaj kompozicionit të tekstit;
- në fund të tekstit shënojnë burimet.

Pas shkrimit:

- e lexojnë tekstin dhe me ndihmën e doracakut korigjojnë gabimet gjuhësore dhe stilistike;
- e krahasojnë tekstin e vet me punimet e shokëve/shoqeve të klasës dhe bëjnë vlerësimin e tij;
- analizojnë formën e konsoliduar të shkrimit (klishe);
- japin mendimin e vet;
- ushtrojnë analizën, sintezën, induksionin, deduksionin, dëshminë, nxjerrjen e përfundimit, përgjithësimin, konkretizimin etj;
- provojnë të shkruajnë një tekst për një problematikë komplekse nga fusha shoqërore, shkencore, artistike duke përdorur operacionet e theksuara;
- bëjnë lektorimin (redaktimin gjuhësor) të teksteve të ofruara.

Rezultati edukativo – arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar dhe përdorur, në kuadrin e sintaksës, format rasore dhe për t'i përdorur drejt ato në të folur dhe në të shkruar, në trajtën e shquar dhe të pashquar.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur përdorimin e rasave pa dhe me parafjalë, konstruktionet rasore dhe disa domethënie duke i lidhur me raportet e fjalëve në fjali;
- shkruar/përdorur drejt rasat;
- korrigjuar tekstin i pavarur (pa ndihmën e të tjerëve).

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 5

Përmbajtja/ nocionet: sistemi i rasave / sistemi rasor

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në shembujt e dhënë ose në tekst i njohin format rasore të trajtës së shquar dhe të pashquar, ua përcaktojnë funksionin;
- në shembujt e dhënë ose në tekst i njohin format rasore me dhe pa parafjalë;
- shprehin mendimin në forma të ndryshme.

Rezultati edukativo – arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të sqaruar kongruencën kuptimore dhe gramatikore.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- vërejtur dhe kuptuar kongruencën kuptimore dhe gramatikore në fjali, si dhe dallimin ndërmjet kongruencës së plotë dhe të paplotë.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 6

Përmbajtja/ nocionet: kongruenca (përputhja), kongruenca gramatikore dhe semantike, kongruenca e plotë dhe e paplotë

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- shkruajnë tekste mbi tema të ndryshme, duke pasur kujdes për kongruencën në fjali;
- analizojnë shembujt, japin shembuj për kongruencën.

Rezultati edukativo – arsimor 7

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të vërejtur dhe kuptuar marrëdhëniet e fjalive në periudha me fjali të bashkërenditura dhe në periudha me nënrenditje.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar sistemin dhe funksionin e fjalive në periudhat me bashkërenditje;
- kuptuar sistemin dhe funksionin e fjalisë kryesore dhe fjalive të varura në periudhat me nënrenditje;
- njohur llojet e ndryshme të fjalive dhe për të kuptuar vlerën e tyre informative dhe stilistike;
- shprehur mendimin e vet në mënyrë të rregullt dhe qartë, duke përdorur fjali llojesh të ndryshme.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 7

Përmbajtja/nocionet: llojet e fjalive, lidhja semantike dhe sintaksore e fjalive, ndarja e periudhës

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në tekst dallojnë tipin e periudhës, kurse në periudhë gjejnë fjalinë kryesore dhe fjalinë/fjalitë e varura/a;
- i ndryshojnë llojet e fjalive (nga një periudhë me fjali të bashkërenditura krijojnë një periudhë me nënrenditje);
- vërejnë vlerën informative dhe stilistike të fjalive të lexuara, krijuara.

Rezultati edukativo – arsimor 8

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të shpjeguar kategoritë e foljeve.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur dhe përdorur drejt format gramatikore të foljes (diatezat, mënyrat, kohët);
- kuptuar dallimet ndërmjet mënyrave të foljes duke pasur parasysh kohët e foljes;
- kuptuar domethëniet kohore të formave të foljes;
- kuptuar funksionin sintaksor të foljeve ndihmëse dhe për t'i përdorur drejt ato;
- njohur foljet modale dhe për ta kuptuar funksionin e tyre;
- njohur foljet pavetore, duke kuptuar funksionin sintaksor të tyre;
- njohur format e pashtjelluara të foljes;
- kuptuar vlerat dhe funksionin e stilit.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 8

Përmbajtja/nocionet: kohët dhe mënyrat e foljes, foljet ndihmëse, foljet modale, trajtat vetore dhe pavetore të foljes

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- ushtrojnë identifikimin e mënyrave dhe kohëve në tekst;
- ushtrojnë riformulimin e tekstit duke përdorur kohë dhe mënyra të ndryshme;
- kërkojnë folje ndihmëse, folje pavetore/ modale në tekst dhe analizojnë funksionin e tyre sintaksor;

- vërejnë dallimin ndërmjet trajtave foljore vetore dhe pavetore;
- vërejnë dhe sqarojnë shenjat e stilit;
- shqyrtojnë ndikimin e stilit.

Rezultati edukativo – arsimor 9

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të zbatuar rregullat e drejtshkrimit.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- përdorur dhe shkruar drejt fjalinë e formës pohore dhe fjalinë e formës mohore;

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 9

Përmbajtja/ nocionet: fjalia e formës pohore, fjalia e formës mohore

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- fjalitë pohore i shndërrojnë në mohore dhe anasjelltas;
- formojnë fjali me negacion të dyfishtë;
- shkruajnë tekste duke i respektuar rregullat e drejtshkrimit.

Rezultati edukativo – arsimor 10

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të zhvilluar komunikim të suksesshëm.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur aktet e të folurit;
- kuptuar rolin e gjuhës në sfera të ndryshme të jetës (ideologji, propagandë);
- kuptuar rolin e elementeve jashtëgjuhësore në komunikim;
- dalluar komunikimin verbal nga ai joverbal;
- kuptuar se ku bazohet kultura gjuhësore e individit dhe e shoqërisë;
- kuptuar se çfarë nënkuptohet me termin/nocionin *gjuhë popullore*;
- përmirësuar komunikimin.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: aktet e të folurit, elementet jashtëgjuhësore të komunikimit, komunikimi joverbal, kultura gjuhësore, gjuha popullore.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- flasin për përdorimin dhe keqpërdorimin e gjuhës; për komunikimin masiv;

- japin shembuj;
- simulojnë situata në të cilat i zbatojnë aktet e të folurit;
- bëjnë vlerësimin e bisedës, përshtatshmërinë e dialogut në situata të caktuara.

MËSIMI I LETËRSISË

Rezultati edukativo – arsimor 1

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar periodizimin e letërsisë nga aspekti historik - rrethanat historike-shoqërore si dhe ndikimin e tyre te autori dhe vepra.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- lexuar dhe kuptuar tekstet letrare të letërsisë bashkëkohore (letërsia e postmodernizmit).

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 1

Përmbajtja/ nocionet:

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në grupe bëjnë periodizimin e letërsisë;
- dëgjojnë dhe lexojnë vepra letrare;
- mbajnë ditarin e shënimeve;
- në shembujt e zgjedhur krahasojnë epokat letrare;
- në formën tabelare paraqesin cilësitë e secilës epokë.

Rezultati edukativo – arsimor 2

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të përjetuar dhe analizuar tekstet letrare artistike të epokave të ndryshme dhe për të krijuar vetë tekste me gojë dhe me shkrim.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- zbatuar njohuritë për veprat letrare, autorët, epokat letrare dhe dukuritë që i ka mësuar gjatë shkollimit;
- përkufizuar letërsinë nga aspekte të ndryshme duke theksuar njohuritë e veta për të;
- shprehur me gojë dhe me shkrim përjetimet, emocionet, mendimet të shkaktuar nga vepra letrare;
- theksuar vlerat etike dhe didaktike të veprës letrare;
- interpretuar përmendësh një tekst të shkurtër me ç' rast tregon aftësinë e përjetimit estetik dhe të interpretimit;
- përgatitur të shprehurit me gojë të një teksti letrar artistik nga një aspekt i caktuar;
- shkruar një tekst për një vepër të lexuar (përshkruan personazhin, paraqet ngjarjen dhe bën një analizë letrare për veprën);
- shkruar një koment për veprën duke u bazuar në qëndrimet dhe mendimet e veta;
- bërë shkrime të vogla hulumtuese, punime seminari duke respektuar rregullat e punimit shkencor.

Rezultati edukativo – arsimor 3

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar dhe shpjeguar mënyrën si studiohet letërsia (metodat e studimit të letërsisë).

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- njohur nocionet *metodologji* dhe *metodologji e studimit të letërsisë*;
- njohur cilësitë metodike (sistematike, besueshmërinë, kontrollueshmërinë, vetëdijsimin)
- kuptuar metodat e studimit të letërsisë rolin dhe domethënien e tyre gjatë interpretimit të një vepre letrare;
- zbuluar ndikimin pozitiv që kanë përdorimi i metodave gjatë qasjes së një vepre letrare;
- zbatuar njohuritë gjatë interpretimit të një pjese të shkurtër të një vepre letrare duke u bindur kështu në ndikimin e drejtpërdrejtë që kanë përdorimi i metodave përkatëse gjatë leximit, përjetimit dhe interpretimit të veprës letrare.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 4

Përmbajtja/nocionet: metodat e studimit të letërsisë

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- numërojnë metodat shkencore dhe komentojnë metodat e shkencave natyrore dhe shoqërore;
- interpretojnë tekste duke përdorur shumë metoda;
- diskutojnë për temën: besueshmëria e qasjes shkencore në interpretimin e veprës letrare.

Rezultati edukativo – arsimor 4

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të shpjeguar se studimi i letërsisë mund të jetë studim i brendshëm dhe studim i jashtëm i saj.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- avancuar aftësitë interpretative estetike, dhe të leximit;
- njohur fushat e shkencës mbi letërsinë si dhe metodat e studimit të cilat përdoren në letërsi;
- kuptuar cilësitë e studimit të jashtëm dhe atij të brendshëm;
- njohur dhe përdorur metodat e njërit dhe tjetrit studim;
- shpjeguar përparësitë dhe të metat e studimit të jashtëm dhe të brendshëm të letërsisë;
- treguar se studimi i brendshëm lidhet me analizën tematike, personazhet, gjuhën, kohën, hapësirën dhe strukturën e veprës letrare;
- treguar se studimi i jashtëm i veprës bazohet në elementet jashtëm të veprës letrare.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: studimi i jashtëm dhe i brendshëm i letërsisë

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në mënyrë ilustrative paraqesin metodat me të cilat i qaset një teksti letrar;
- theksojnë metodat e studimit të jashtëm të letërsisë (pozitivizmi, metoda sociologjike, psikologjike dhe historike); dhe diskutojnë rreth mangësive dhe përparësive të tyre;
- studimin e brendshëm e lidhin me metodat: kritika e re, formalizmi rus, strukturalizmi metoda fenomenologjike, teoria feministe;
- diskutojnë rreth përparësive dhe mangësive të këtyre metodave;
- realizojnë qasje të ndryshme ndaj tekstit (analizë, interpretim, paraqitje).

Rezultati edukativo – arsimor 5

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar pluralizmin e metodave si qasje ndaj tekstit nga aspekte të ndryshme.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar domosdoshmërinë e përdorimit dhe përparësinë e më shumë metodave gjatë interpretimit të një vepre;
- të shpjeguar kuptimin e shprehjes *vepër e hapur*;
- përdorur më shumë metoda gjatë leximit dhe interpretimit të një vepre letrare.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative 6

Përmbajtja/ nocionet: vepër e hapur

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- analizojnë një vepër letrare duke përdorur metoda të ndryshme;
- diskutojnë për temën: Vepra letrare “përcakton” metodën.

Rezultati edukativo – arsimor 6

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar qasjet e ndryshme ndaj veprës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar teorinë e receptimit si pjesë e shkencës së letërsisë e cila në qendër të vëmendjes ka lexuesin;
- kuptuar se kritika e re bazohet në interpretimin e tekstit duke u nisur nga leximi me vëmendje i vetë tekstit (close reading);
- ditur ç’është *horizonti i pritjes*;
- kuptuar metodën e formalizmit rus si metodë e cila merret me formën e tekstit letrar;
- kuptuar rolin e arketipave gjatë analizës së veprës letrare.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: teoria e receptimit, kritika e re, formalizmi rus, strukturalizmi, kritika e arketipeve

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në bazë të titullit dhe dukjes bisedojnë rreth horizontit të pritshmërive të veta lidhur me veprën letrare;
- rezonojnë për lexuesin bashëkohor dhe për aktin e leximit;
- pas leximit të një vepre paraqesin mbresat nga vepra duke i krahasuar me horizontin e pritjes;
- analizojnë strukturën e brendshme të tekstit letrar;
- në veprën letrare dallojnë ngjarjet dhe shpjegojnë se si janë të lidhura me tërësinë e veprës;
- komentojnë formën e veprës;
- shpjegojnë ndikimin e formës në përjetimin estetik;
- arrijnë të gjejnë arketipet themelore dhe praninë e ndërtimeve mitologjike;
- kërkojnë personazhet arketipe.

Rezultati edukativo – arsimor 7

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar tekstin letrar në shumështresshmërinë e tij (shtresa tingullore, kuptimore, e ideve, e aspekteve, e subjektit).

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- lidhur, para së gjithash, shtresimet me krijimet në poezi;
- kuptuar dhe përdorur termin *shumëkuptimësia*;
- kuptuar përdorimin konotativ dhe denotativ të shprehjeve gjuhësore;
- vërejtur në gjuhën e poetit ekspresivitetin, ritmin, shumëkuptimësinë e shprehjes;
- studiuar në një poezi të zgjedhur lirike shtresimin strukturor;
- shkruar ese ku në mënyrë individuale tregon njohuritë dhe dijen për shtresimet strukturore të veprës e diskuton për esetë mostër dhe kriteriumin e vlerësimit;
- sintetizon njohuritë e arritura për veprën përmes metodës së studimit të shtresimeve strukturore.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: shtresat e veprës letrare, shumëkuptimësia

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në tekst vërejnë kuptimin e shtresimeve;
- në tekstet përkatëse shpjegojnë kuptimin denotativ dhe konotativ të shprehjes;
- në gjuhën e poezisë gjejnë ekspresivitetin, ritmin;
- shkruajnë ese duke paraqitur njohurit e veta për shtresat e strukturës së veprës letrare.

Rezultati edukativo – arsimor 8

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të sqaruar narratologjinë si një fushë të re të teorisë së letërsisë.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar se objekt i studimit të narratologjisë është forma, mënyra dhe mundësitë e të rrëfyerit;
- përdorur termat: diskurs, fokalizatori, fokalizëm;
- njohur përmbajtjen, kuptimin dhe domethënien e narratologjisë si disiplinë shkencore teorike e cila merret me mënyrën, format dhe mundësitë e të rrëfyerit;
- zbatuar të gjitha njohuritë mbi narratologjinë ;
- analizuar nocionin diskurs;
- paraqitur diskursin si dukuri me karakter të përgjithshëm gjuhësor;
- demonstruar në ushtrime njohjen e termave diskurs publik dhe diskurs privat, duke ditur të bëjnë dallimin në mes këtyre diskurseve dhe diskursit të krijimeve estetike.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: narratologjia: fokalizatori, fokalizmi dhe diskursi.

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- narracionin e lidhin me rrëfimin;
- bëjnë projekte: zbatojnë dijen mbi narratologjinë në të gjitha strukturat narrative (film, strip, vepër letrare)

- në pjesët e zgjedhura demonstrojnë arritjet teorike mbi narratologjinë;
- bëjnë një ushtrim në çifte: diskursi publik, diskursi privat dhe diskursi i krijimeve estetike.

Rezultati edukativo – arsimor 9

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të shpjeguar veçoritë e antidramës dhe të romanit modern.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- shpjeguar dallimin në mes antidramës dhe dramës klasike;
- kuptuar copëzimin estetik si dhe kontradiktat në antidramë;
- lidhur antidramën me motivin e absurdit dhe ta shpjegojë atë;
- kuptuar sistemin e shenjave në dramën moderne-antidramën;
- vërejtur dhe argumentuar procedurën e tekstit dramatik postmodernist;
- kuptuar transformimin e romanit: roman-parabol filozofike, roman i ndërdijes, roman mbi bazën e mitologjisë, roman filozofik –realist, roman postmodernist.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: antidrama, romani modern (llojet).

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- theksojnë elementet karakteristike të antidramës në tekstin e zgjedhur;
- shprehen me gojë lidhur me temën: Qëndrimet kritike kundër ligjësive shoqërore, mëzsisë dhe absurdit në antidramë;
- shikojnë një shfaqje teatrale apo një dramë në televizion ose në internet të Samjuel Beketit apo të ndonjë autori tjetër;
- komentojnë shfaqjen/ dramën e shikuar.

Rezultati edukativo – arsimor 10

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të sqaruar letërsinë bashkëkohore të bazuar mbi “letrarësinë” e veprës letrare dhe jo si nocion që paraqet një epokë letrare.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar nevojën e përcaktimit në mënyrë precize të idesë bashkëkohore në letërsi dhe në artet e tjera;
- bërë dallimin në mes të modernes dhe bashkëkohores;
- bërë lidhjen e letërsisë bashkëkohore me termin postmodernizëm;
- zbatuar njohuritë teorike, të zhvillojë aftësitë receptive të përjetimit dhe të kuptuarit e teksteve komplekse të letërsisë bashkëkohore.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: letërsia bashkëkohore

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- bëjnë anketë për tekstet e letërsisë bashkëkohore më të preferuara dhe rezultatet e arritura i prezantojnë në paralelet e tjera;
- në çifte bëjnë dallimin e nocioneve moderne dhe bashkëkohore;
- bëjnë një listë të vetën për tekstet e preferuara bashkëkohore;
- shkruajnë një rekomandim për leximin e një vepre nga letërsia bashkëkohore;
- në një tekst analizojnë funksionin estetik të mjeteve të theksuara karakteristike.

Rezultati edukativo – arsimor 11

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të sqaruar lidhjen e modernizmit të vonshëm me veprat letrare që lindin pas Luftës së Dytë Botërore

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- theksuar të rejat në poetikën e një vepre në raport me letërsinë avangarde;
- modernizmin e vonshëm e kupton si sintezë të tradicionales dhe modernes;
- kuptuar qasjen realiste ndaj temës si metodë e jo si drejtim;
- kuptuar se fusha e interesimit lëviz drejt botës së brendshme të heroit.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: modernizmi i vonshëm

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në tekst bëjnë dallimin e elementeve tradicionale dhe moderne;
- në vepër njohin dhe shpjegojnë metodën realiste;
- mbledhin material për shkrimin e esesë;
- bëjnë planin e hartimit të esesë në bazë të materialit të përzgjedhur;
- shkruajnë një variant të esesë për një vepër letrare;
- lexojnë esenë në klasë dhe e komentojnë atë;
- shkruajnë variantin e përmirësuar të esesë.

Rezultati edukativo – arsimor 12

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të sqaruar postmodernizmin si letërsi e veçantë me një poetikë të posaçme.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar rolin e mediave, globalizimin, informatikën, teknologjinë informuese, shoqërinë konsumatore në krijimin e idesë së botës postmoderniste;
- kuptuar dhe përdorur drejt nocionet metatekst dhe prototekst;
- sqaruar elementet e stilit letrar postmodernist.
- njohur disa nga autorët, respektivisht veprat më të spikatura të letërsisë bashkëkohore shqiptare dhe botërore;
- njohur letërsinë bashkëkohore malazeze me elemente postmoderne (në prozë: Andrej Nikollajdis, në poezi: Mlladen Llompar, Pavle Goranoviq);
- njohur dhe komentuar pjesë nga krijimtaria e disa autorëve të spikatur të letërsisë bashkëkohore shqipe në Malin e Zi, në prozë (Fran Camaj, Anton Gojçaj) dhe në poezi (Ibrahim Berjashi, Haxhi Shabani).

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/nocionet: postmodernizmi: intertekstualiteti, dekonstrukcioni

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- bisedojnë për rolin e mediave në jetën bashkëkohore;
- diskutojnë për temën globalizmi dhe këndvështrimi bashkëkohor mbi botën, ndikimin e teknologjisë te njeriu, frymën e konsumatorizmit dhe vlerat etike universale;
- në tekst vërejnë dhe shpjegojnë intertekstualitetin, dekonstrukcionin, transformimin, metatekstin, hipertekstin, fragmentarizmin, faktet dhe fiksionet...

Rezultati edukativo – arsimor 13

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të kuptuar nocionin letërsi në formim si letërsi në lindje e sipër për të cilën ende nuk ka vlerësime objektive.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- përcaktuar termin letërsi në formim përmes nocionit letërsi bashkëkohore;
- letërsinë në lëvizje e lidh me dekadat dhe autorët të cilët vazhdojnë të paraqiten;
- kuptuar se llojllojshmëria e tyre nuk është e barabartë me cilësinë;
- kuptuar ndikimin e mediave mbi letërsinë në lëvizje;
- kuptuar se kjo letërsi te lexuesi arrin jo vetëm përmes librit por edhe përmes internetit, video- dhe audio-materialeve;
- kuptuar llojllojshmërinë e zhanreve;
- zhvilluar shijen e lexuesit dhe për të marrë pjesë vepruese në jetën kulturore.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: letërsia në lëvizje

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- tregojnë vepra dhe autorë të letërsisë në lëvizje;
- sjellin në klasë audio apo video materiale për një vepër letrare;
- diskutojnë në temën: leximi nga libri dhe përmes ekranit;
- gjejnë web – adresa në të cilat ka vepra të letërsisë në lëvizje;
- në veprat e zgjedhura zbulojnë mënyrën se si tekstet e letërsisë në lëvizje i paraqesin dhe shpjegojnë dukuritë dhe ngjarjet nga surealiteti;
- bëjnë listën e çmimeve letrare në vend, rajon e botë dhe diskutojnë për rëndësinë e tyre për fituesit;
- identifikojnë dhe përjetojnë vlerat letrare, vlerësojnë revistat letrare dhe zhvillimin e përparimin e shprehjes letrare-artistike.

Rezultati edukativo – arsimor 14

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të ndërlidhur përjetimin e filmit me shprehjet letrare bashkëkohore, si art që në vete ngërthen shprehjet ekspresive të më shumë arteve.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- kuptuar mjetet shprehëse të filmit (skanari, kuadrot, montimi, skenografia, fotografia, kostumografia, muzika) dhe mënyrën e realizimit të tyre;
- njohur sinopsisin, skenarin, librin e xhirimit;
- kuptuar raportin e filmit me letërsinë;
- bërë dallimin në mes të skenarit origjinal të filmit dhe skenarit i cili bazohet në veprën letrare.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: filmi dhe letërsia

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- në film gjejnë motive nga vepra letrare;
- krahasojnë skenarin e filmit me tekstin e veprës;
- bëjnë dallimin në mes të ekranizimit dhe adaptimit të veprës letrare;
- shkruajnë librin e xhirimit;
- shkruajnë listën e dialogut;
- bëjnë skenarin;
- bëjnë sinopsisin;
- shpjegojnë transformimin e veprës letrare në film.

Rezultati edukativo – arsimor 15

Në fund të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë për të gjetur në mënyrë të pavarur në internet materiale me përmbajtje letrare.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje për të:

- menduar për raportin e letërsisë dhe internetit;
- kuptuar dukurinë e formateve të reja që mundësojnë leximin e veprës letrare;
- njohur përmbajtjen themelore, funksionin rëndësinë e përmbajtjeve të formës elektronike nga fusha e letërsisë dhe shkencës mbi letërsinë
- kuptuar funksionin informativ dhe njohës të materialeve nga interneti (baza e të dhënave përkatëse në internet);
- kuptuar nocionin e hipertekstit.

Rekomandime didaktike për arritjen e rezultateve arsimore – edukative

Përmbajtja/ nocionet: interneti dhe letërsia

Veprimtari për të mësuar. Nxënësit:

- gjejnë web-adresa të shkrimtarëve;
- gjejnë vepra letrare në formën elektronike dhe i lexojnë ato;
- bisedojnë rreth përparësive dhe mangësive të leximit të veprës letrare nga libri dhe interneti;
- përdorin materialet nga interneti si kritikë;
- bëjnë përgatitje për të hartuar hipertekst;
- diskutojnë në temën : Çfarë do të bënit sikur të kishit një libër i cili do të ndryshonte sa herë që e lexoni - mundësitë e hipertekstit!?
- shkruajnë ese me temën: Ardhmëria e leximit/librit.

Lista e teksteve të propozuara është hartuar sipas kriterit të vlerave estetike dhe në përputhje me moshën dhe zhvillimin kulturor të nxënësit. Nga kjo listë mësuesdhënësi përzgjedh tekstet sipas kriterit profesional. Lista nuk e kufizon atë. Përkundrazi, ai është i lirë të përzgjedh për lexim edhe tekste të tjera, që nuk janë në listë, por duhet të ketë kujdes për kriteret e cekura, si dhe për proporcionalitetin e gjinive dhe llojeve letrare, përkatësisht për qëllimet dhe arritjet e të nxënit në program.

Viti IV

Tekste të propozuara		
Prozë	Poezi	Dramë
<p>Lui Borhes: <i>Prozë e zgjedhur</i> Gabriel Garsia Markes: <i>Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë</i> (fragment) Albert Kamy: <i>I huaji</i> (fragment) Franc Kafka- <i>Procesi</i> (fragment) Virxhinia Vulf: <i>Një dhomë për vete</i> (fragment) Martin Camaj: <i>Rrungaja në mars</i> Ismail Kadare: <i>Kush e solli Doruntinën</i> Anton Pashku: <i>Tregime fantastike</i> (zgjedhje) Mehmet Kraja: <i>Selvitë e Tivarit</i> (fragment) Fatos Kongoli: <i>Lëkura e qenit</i> (fragment) Studiuesit dhe kritikët e letërsisë shqiptare: Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja (zgjedhje) Studiuesit dhe kritikët e letërsisë: Sabri Hamiti, Ibrahim Rugova, Aurel Plasari, Anton Berishaj Ivo Andriqi: <i>Ura mbi Drinë</i> Mesha Selimoviq: <i>Dervishi dhe vdekja</i> Andrej Nikollaidis : <i>Ardhja Letërsia në gjuhën shqipe në Malin e Zi: Prirje të prozës realiste, moderne e postmoderne: Fran Camaj- Rruga e pamëshirmshme, Anton Gojçaj-Midis kapakëve</i></p>	<p>Fatos Arapi-<i>Poezi (zgjedhje)</i> Dritëro Agolli: <i>Poezi të zgjedhura</i> Azem Shkreli-<i>Poezi (sipas zgjedhjes)</i> Rrahman Dedaj-<i>Poezi të zgjedhura</i> Ali Podrimja: <i>Poezi (sipas zgjedhjes)</i> Visar Zhiti-<i>Poezi të zgjedhura</i> Xhevahir Spahiu: <i>Poezi (zgjedhje)</i> Frederik Reshpja: <i>Poezi të zgjedhura</i> Basri Çapriqi: <i>Poezi (zgjedhje)</i> Mimoza Ahmeti: <i>Armiku im</i> Mlladen Llompar-<i>Poezi të zgjedhura</i> Poezia në gjuhën shqipe në Malin e Zi: Nga prirjet realiste në modernizëm deri në postmodernizëm: Ibrahim Berjashi - <i>Ora e Rumisë</i>, Haxhi Shabani – <i>Vizatim hënor me shkëlqim yjesh</i></p>	<p>Ulliam Shekspiri: <i>Hamleti</i> Samuel Beketi: <i>Duke pritur Godonë (fragment)</i> Stefan Çapaliku -<i>Një dramë (sipas zgjedhjes)</i></p>

KANONET:

Uilliam Shekspiri: *Hamleti*

Albert Kamy: *I huaji*

Ismail Kadare: *Darka e gabuar*

Samuel Beketi: *Duke pritur Godonë*

Vath Koreshi-Ulku dhe uilli

Danillo Kishi-Enciklopedia e të vdekurve

Xhejms Xhojsi: *Uliksi*

Zuvdija Hoxhiq: *Viti i Gucisë*

D. UDHËZIME DIDAKTIKE PËR REALIZIMIN E LËNDËS MËSIMORE

Udhëzime të përgjithshme

Nxënësit punojnë në shkollë gjithsej katër hartime gjatë një viti shkollor. Në vitin e parë hartimet i punojnë një orë, ndërsa në vitet e tjera nga dy orë mësimore. Korrigjimi punohet në një ose më shumë orë mësimore, varësisht nga vlerësimi i mësimdhënësit. Rekomandohet që temat e hartimit me shkrim t'i përshtaten moshës dhe interesimeve të nxënësve dhe të mundësojnë që ata të demonstrojnë aftësinë e vet gjuhësore dhe stilistike, kreativitetin, lirinë e të shprehurit. Përveç temave që nënkuptojnë bazën empirike dhe qëndrimin subjektiv, duhet të përfshihen edhe tema të cilat kërkojnë paraqitjen kritike të realitetit të gjerë e të ndërlikuar dhe dukuritë shoqërore aktuale.

Nxënësit në një periudhë klasifikuese punojnë një test nga materiali i asaj periudhe (gjuhë dhe letërsi). Në test duhet bërë përpjekje që pyetjet të modelohen sipas mostrës së pyetjeve të provimit të maturës.

Nxënësit punojnë **një detyrë shtëpie** (formë e përshtatur e punimit seminarik) lidhur me një vepër sipas zgjedhjes së vet. Veprat për të cilat do të shkruajnë detyrën e shtëpisë (në vitin e tretë dhe të katërt - ese) i shpall mësimdhënësi në fillim të vitit shkollor, kurse nxënësi e paraqet përzgjedhjen e vet deri në fundin e periudhës së parë klasifikuese. Lidhur me pjesën e zgjedhur nxënësi është në gjendje të përgatisë dhe të zbatojë paraqitjen me gojë.

Nxënësit gjatë vitit shkollor thonë përmendësh, duke e interpretuar, së paku një tekst të zgjedhur letrar.

Nxënësit mbajnë ditarët e leximit për veprat e caktuara me program dhe për ato që i lexojnë sipas zgjedhjes së vet. Në ditarin e leximit shënohen: të dhënat mbi veprën, përjetimet, faktet e reja dhe vlerësimet e nxënësit, shënime të shkurtra për fabulën, personazhet, gjuhën e veprës, idetë, si dhe fragmente të zgjedhura, të shkurtra. Ditarët e leximit duhet të përmbushin funksionin emocional, estetik dhe intelektual të studimit të letërsisë.

Do të ishte një gjë e mirë që nxënësit gjatë katër vjetëve të bëjnë antologjinë e vet të poezisë (të poetëve/poeteshave nga antikiteti deri tek ata/ato bashkëkohorë) ose antologjinë e një epoke. Për të do të shkruanin edhe parathënien ku do të shpjegojnë kriteret që i kanë respektuar gjatë përzgjedhjes së poezive.

Pasi që ekziston një problem përcaktues i mësimin të kësaj lënde – kompetenca funksionale e rrezikuar e nxënësve tanë, duhet t'i kushtohen më shumë orë zhvillimit të kulturës së të shprehurit me gojë dhe me shkrim në kuadrin e të dy fushave të lëndës, edhe mësimin të gjuhës edhe mësimin të letërsisë.

Kompetenca mediatike dhe informatike. - Lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë përmban elemente nga i ashtuquajtimi *edukimi mediatik*. Këto rezultate përfshijnë lidhjen e veprimtarive gjuhësore, përdorimin aktiv të fjalorëve dhe njohuri bazike me qasje kuptimplote në informata, si dhe vlerësimin kritik dhe përdorimin e tyre krijues për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve. Përfshijnë edhe aftësitë e komunikimit dhe të prezentimit: krijimin e mesazheve për media dhe transmetimin e tyre me përgjegjësi, qëndrimin kritik ndaj mesazheve të mediave, të kuptuarit e ndikimit të mediave dhe mesazheve të tyre për shoqërinë dhe individin. Në këtë mënyrë zhvillojnë ndërgjegjësimin për vlerën unike të mendimeve, qëndrimeve dhe ideve, shoqërive dhe kulturave të ndryshme, me qëllim të komunikimit të suksesshëm dhe të kuptuarit e tjetrit dhe të atyre që janë ndryshe.

E kuptuar si një koncept kompleks, kompetenca informative dhe mediatike, përmes pjesëmarrjes aktive dhe demokratike të qytetarëve dhe mundësimin e diversitetit, dialogut dhe tolerancës, përfshin njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që u mundësojnë nxënësve: të kuptojnë rolin dhe funksionet e medias dhe të burimeve të tjera të informatës në shoqëritë demokratike, t'i kuptojnë kushtet në të cilat ato funksione mund të realizohen, të njohë dhe shprehin nevojën për informata, të gjejnë dhe të kenë qasje në informatat relevante, të vlerësojnë në mënyrë kritike informatat dhe përmbajtjet të cilat i ofrojnë mediat dhe burimet e tjera, përfshirë edhe ato në internet, në kuptimin e kompetencës, besueshmërisë dhe përdorimit aktual; të shkarkojnë dhe të organizojnë përmbajtjen informative dhe mediatike, të sintetizojnë apo të punojnë në idetë që i kanë shkarkuar nga përmbajtja, të komunikojnë si e kuptojnë vetë diturinë e krijuar për publikun apo lexuesit në formë të përshtatshme, në median e duhur dhe në mënyrë etike dhe të përgjegjshme, të aplikojnë aftësitë e veta të TIK-ut në mënyrë që të ndërveprojnë me informatën

dhe të prodhojnë përmbajtjen e tij, t'i qasen punës me mediat dhe furnizuesit e tjerë të informatës, duke përfshirë ato në internet, me qëllim të vetë-prononcimit, lirisë së shprehjes, dialogut ndërkulturor dhe pjesëmarrjes demokratike. (UNESCO, 2013). Duke pasur parasysh mundësitë që hap IMP, ajo duhet të kuptohet jo vetëm si aftësi për të kërkuar, përdorur dhe shkëmbyer informatat në shumë formate dhe modalitete, por edhe si kërkim i dijes dhe të mësuarit gjatë tërë jetës.¹

Mësimi i gjuhës

Të mësuarit e gjuhës lidhet me përvojën dhe njohuritë e nxënësit nga shkolla fillore dhe më shumë është mbindërtim dhe vënie e bazave të njohurive dhe vazhdim i përvetësimit të arsimimit (kompetencës) funksional (e). Gjuha mësohet në mënyrë sistematike, ndërsa korrektësia gjuhësore në të folur dhe në të shkruar kontrollohet në çdo klasë.

Mësimdhënia e gjuhës realizohet me tekste joletrare që duhet të kenë vlera informative dhe stile të ndryshme, të jenë aktuale dhe në përputhje me interesimet e nxënësve. Një tekst mund të përdoret për të zbatuar disa arritje të të nxënësve (identifikuese dhe për të shpjeguar rregullat e drejtshkrimit dhe ato gramatikore, performancën me gojë, krijimin e hartave konceptuale etj).

Gjatë studimit të teksteve joletrare nxënësit i zhvillojnë të katër shkathtësitë e komunikimit (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit). Strategjitë e të dëgjuarit, të lexuarit dhe të krijuarit të teksteve joletrare, të përvetësuara në shkollën fillore vazhdojnë të zhvillohen në të gjitha vitet e shkollës së mesme. Mësimdhënësi duhet të bëjë vlerësimin e nevojave të komunikimit të nxënësve para njohurive dhe aftësive të fituara dhe në bazë të tyre të planifikojë përmbajtjet dhe veprimtaritë për të mësuar, varësisht nga profili arsimor i nxënësit. Nëse nxënësit nuk kanë fituar një aftësi të veçantë komunikimi, mësimdhënësi planifikon veprimtaritë për të mësuar të cilat do të bëjnë të mundur përvetësimin e saj.

Studimi i teksteve joletrare në shkollë përfshin faza para, gjatë dhe pas dëgjimit/shikimit/leximit, kurse secila prej fazave të përmendura nënkupton veprimtari të caktuara për të mësuar. Mësimdhënësi gjithmonë përpiket për të kontrolluar nëse nxënësi e kupton tekstin që dëgjon dhe lexon.

¹ Shih: *Polazne osnove za izradu strategije razvoja informacione i medijske pismenosti kroz mrežu biblioteka*, (2016-2020), Nacionalna biblioteka „Đurđe Crnojević, Cetinje, 2015.

Gjithashtu, nxënësit hartojnë tekste të stileve të ndryshme funksionale dhe ashtu nxënë kompetencën funksionale. Duke pasur parasysh se këto janë procese komplekse të të menduarit rekomandohet testimi i shpeshtë përmes llojeve të ndryshme të testimit me shkrim (pa nota), që nxënësit të mund të korrigjojnë gabimet dhe ta vlerësojnë punën e vet.

Duhet theksuar në mënyrë të posaçme se nocionet gjuhësore nuk duhet të arrihen në nivelin e *reproduksionit*, por të *zbatimit të atyre njohurive*.

Është e nevojshme që të nxitet puna në grupe dhe në çifte për shkak të mësimit bashkëpunues (kooperativ) dhe ndihmës së ndërsjellë. Një herë a dy në vit duhet lejuar nxënësit që ata vetë të jenë krijues në orë (me arritje të caktuar të të nxënësve).

Veprimtaritë e propozuara për të mësuar rrjedhin nga rezultatet e caktuara edukativo-arsimore dhe janë në funksion të drejtim-dhënies për mësimdhënësit, por mund edhe t'i plotësojnë ato.

Mësimi i letërsisë

Në kontekstin e mësimit të letërsisë duhet t'i jepet rëndësi kulturës së të shprehurit - me gojë dhe me shkrim, përmes zhvillimit të katër veprimtarive të komunikimit (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit).

Në fund të tabelës, pas çdo viti, gjendet lista e teksteve të propozuara. Kjo është bërë në bazë të kritereve të vlerës estetike dhe përshtatshmërisë së teksteve, moshës së nxënësve dhe përvojës së tyre kulturore dhe jetësore. Nga kjo listë mësimdhënësi përzgjedh tekstet në bazë të kritereve të veta profesionale dhe lista nuk duhet ta kufizojë atë. Përkundrazi - mund të zgjedhin edhe ndonjë tekst tjetër të përshtatshëm, që nuk është në këtë listë, por duhet të ketë parasysh kriteret e mësipërme, si dhe proporcionin ndërmjet llojeve, si dhe objektivat dhe rezultatet e mësimit.

Përveç teksteve të propozuara, në listë janë përfshirë edhe veprat e detyrueshme (kanoni). Nxënësi e ka për detyrë që t'i lexojë dhe t'i njohë ato. Njohuritë që nxënësit kanë për veprat e detyrueshme (kanonin) testohen edhe në provimin e maturës.

Programi mësimor (kurikula) i gjimnazit paraqet një kombinim të qasjes zhanrore dhe historike - në raport me letërsinë. Gjysmëvjetori i parë i vitit të parë është paraparë për mënyrat e qasjes në studimin e veprës/veprave letrare, dhe një fushë e tillë, ashtu e bazuar teorikisht, ekziston edhe në vitin e dytë dhe të tretë. Në vitin e katërt është paraparë studimi dhe përvetësimi i metodave moderne në qasjen ndaj veprës/veprave letrare.

Duke qenë se në vitin e parë të gjimnazit mësohet teoria e letërsisë dhe periudhat letrare që janë larg në kohë dhe hermetike për nxënësin e sotëm, është e nevojshme të përfshihen edhe forma

tërheqëse të prezentimit të mitologjisë greke, tregimeve biblike, tregimeve nga Kurani, nga periudha e humanizmit dhe renesansës (filma, regjistrime të shfaqjeve teatrale etj.). Nocionet teoriko-letrare lidhen funksionalisht me tekstin letrar të paraparë për lexim dhe sqarohen vetëm ato nocione që janë të përfaqësuara në tekstin e zgjedhur, që mësohen vetëm për ta kuptuar mirë tekstin.

Caktimi i pjesëve të cilat duhet t'i lexojnë nxënësit, dhënia e ditarëve të leximit, eseve dhe paraqitjet me gojë duhet bërë me kohë. Rekomandohet që të gjitha tekstet e shkurtra të lexohen në klasë dhe që nxënësit të punojnë detyra hulumtuese në grupe të vogla. Në një vepër me vëllim më të vogël, e cila në masë të mjaftueshme e ilustron procedurën letrar, nxënësi mund të zhvillojë aftësitë interpretuese dhe të përvetësojë nocionet teoriko-letrare. Mësimdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm që teksti letrar gjithmonë përjetohet individualisht, dhe shpesh ai përjetim ndryshon nga njëri nxënës te tjetri.

Që përjetimi i tekstit të jetë i plotë, është e domosdoshme që nxënësit të nxiten një herë për të lexuar, e pastaj ata vetë krijojnë një tekst, në trajtën e një sublimimi krijues të përjetimit dhe informatave që dalin nga teksti. Pra, qëllimi i procesit është të shprehurit kreativ, duke respektuar dallimet individuale (përvojat personale).

Pas leximit, lexuesi/nxënësi duhet të inkurajohet për të reflektuar mbi atë që ka lexuar, për të marrë një qëndrim lidhur me përmbajtjen dhe për të folur arsyeshëm për përvojën e vet.

Edhe pse një pjesë e nocioneve dhe përmbajtjeve të përmendura në klasët e mëparshme nuk përsëriten në të mëpastajmet, mësimdhënësi, së bashku me nxënësit, e ka për detyrë përsëritjen e vazhdueshme dhe avancimin e njohurive të arritura, si në kontekste të ngjashme ashtu edhe në ato të ndryshmet. Me fjalë të tjera, postulati i korrelacionit vertikal në kuadrin e lëndës mësimore kërkon që mësimdhënësi ta njohë programin në tërësi.

Në procesin mësimor duhet zhvilluar (nxitur) bashkëpunimi ndërmjet nxënësve, kërkimi i zgjidhjeve alternative, përdorimi me invencion i materialeve dhe mjeteve mësimore dhe vlerësimi i rezultateve. Te nxënësi duhet të zhvillohet aftësia për të gjetur informata dhe për ta shqyrtuar në mënyrë kritike përdorimin e burimeve të ndryshme të dijes (fjalorët, enciklopeditë, interneti etj.).

DH. PËRSHTATJA E PROGRAMIT PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE DHE PËR NXËNËSIT E TALENTUAR

a) Përshtatja e programit dedikuar nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

Programi arsimor për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore mund të realizohet duke shtuar kushtet dhe mjetet, duke përshtatur realizimin dhe duke shtuar ndihmën profesionale, në mënyrë që ata nxënës të arrijnë të njëjtin standard arsimor, të përkufizuar në programin arsimor, në përputhje me mundësitë e tyre individuale dhe në pajtim me ligjin.

Shkolla e ka për detyrë që të hartojë programin individual të arsimit për nxënës me nevoja të veçanta arsimore, në pajtim me ligjin. Programi individual i arsimit përkufizon: format e punës edukativo-arsimore për fushat edukativo-arsimore, gjegjësisht lëndët dhe modulet, mënyrën e realizimit të ndihmës profesionale të shtuar, fluiditetin ndërmjet lëndëve, përshtatjen gjatë organizimit të mësimit, arritjet e të nxënës, kriteret për përmbushjen e arritjeve të të nxënës, vlerësimin dhe notimin e arritjeve të të nxënës dhe të avancimit të nxënësit, si dhe orarin.

Për përgatitjen, zbatimin, përcjelljen dhe përshtatjen e programit, shkolla formon ekipin profesional në përbërje: mësimitdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës ose të qendrës burimore, me pjesëmarrjen edhe të prindërve.

Gjatë vitit, Programin individual i arsimit mund të ndryshohet gjegjësisht të përshtatet varësisht nga avancimi dhe zhvillimi i nxënësit.

b) Përshtatja e programit dedikuar nxënësve të talentuar

Potencialët e nxënësve të talentuar mund të shprehen më mirë në një mjedis pedagogjik stimulues, prandaj qasja sistematike është shumë e rëndësishme për zhvillimin e tyre. Mjedi shkollor, gjegjësisht mësimi, me organizimin dhe atmosferën e vet të përgjithshme duhet të nxisë punën, angazhimin maksimal dhe të ngacmojë kureshtjen intelektuale të çdo nxënës.

Identifikimi i nxënësve të talentuar mund të bëhet përmes vlerësimit të tipareve të nxënësit (raportet, të vërejturit) nga mësimitdhënësi, prindi, shokët, vetëvlerësimi i nxënësit të talentuar ose përmes matjes (testimit) të shkollës zhvillimore të tipareve (inteligjencës, aftësisë së veçantë apo specifike, kreativitetit etj.).

Karakteristikat e nxënësve të talentuar, qofshin *intelektuale* (aftësia shumë e zhvilluar për të rezonuar dhe nxjerrë përfundime logjike; vërejtja e marrëdhënieve, ligjshmërive; aftësia për ndërlikohen e informatave; aftësia për zgjidhjen e problemeve; kureshtja intelektuale; mendimi

divergjent i zhvilluar; invencioni; rrjedhshmëria e ideve, imagjinata, kujtesa e shkëlqyeshme...), qofshin ato që janë *tipare të personalitetit* (motivacioni i brendshëm i zhvilluar; këmbëngulja dhe qëndrueshmëria; sensi i humorit; ndjeshmëria e theksuar emocionale; rishqyrtimi i rregullave dhe autoriteteve; empatia; ndërgjegjja e zhvilluar për veten...) mund të zbulohen në të dy fushat mësimore – edhe në mësimin e gjuhës shqipe edhe në mësimin e letërsisë.

Pasurimi i kurikulës së lëndës, si model përmes të cilit kënaqen nevojat e nxënësve të talentuar, nënkupton angazhimin e tyre të mëtejshëm në mësimin e rregullt dhe jashtë tij. Kur bëhet përshtatja e programit për nxënësit e talentuar duhet pasur kujdes që përmbajtjet të kenë nivel të lartë të kompleksitetit, në mënyrë që në përzgjedhjen e tyre të marrin pjesë nxënësit e talentuar dhe që metodat e mësimin/të nxënës të jenë relevante.

Paradispozita natyrore (dhuntia e lindur) për arritjen e rezultateve shumë të mira në një fushë të caktuar është kusht i nevojshëm, por jo edhe i mjaftueshme për arritjen e rezultatit. Nxënësve të talentuar duhet ofruar strategji të ndryshme të të mësuarit dhe të nxënës varësisht nga niveli i talentit të tyre. Në pajtim me arritjet e të nxënës duhet krijuar situatat mësimore në të cilat nxënësi do të mund: të përgatisë dhe formësojë në mënyrë të pavarur punime në të cilat shprehet kreativiteti, prirja për inovacione, origjinaliteti dhe mendimi kritik i tyre; të ndryshojë zhanrin e një teksti, të bëjë dramatizimin e një teksti në prozë; t'ia ndryshojë trajtën një teksti të dramës duke përdorur teknika narrative dhe duke zbatuar dijen e vet mbi shenjat zhanrore dhe të strukturës; të shkruajë një sinopsis; të përgatisë shfaqje skenike dhe të dramës; të inskenojë dhe organizon shfaqje; të hartojë një libër me figura (strip), fjalor, doracak; të krijojë një tekst të ri në formën gojore dhe të shkruar - në të folmen lokale, ose në dialekt, në zhargon ose në gjuhën standarde, i nxitur nga përvojat e ndryshme, zgjidh situata problematike të ndryshme, i motivuar nga teksti letrar etj.

Dhuntia (të qenit i talentuar për diçka) është një kategori zhvillimore, prandaj mësimdhënësit duhet të kenë parasysh edhe aspektet e tjera të personalitetit të nxënësit – aspektin afektiv dhe social. Te nxënësi duhet inkurajuar zhvillimin e të menduarit logjik dhe kreativ, por edhe vetëdijen për aftësitë, këmbënguljen, qëndrueshmërinë e vet dhe raportin pozitiv me të tjerët.

Gjatë realizimit të programit të pasuruar nxënësit e talentuar nuk duhet veçuar nga paralelja, por duhet t'u mundësohet puna individuale ose grupe në detyra ose projekte të drejtuara profesionalisht nga mësimdhënësit. Duke respektuar individualizimin dhe duke zbatuar mësimin e diferencuar do t'u mundësohej nxënësve të talentuar që të avancojnë më shpejt në paralele heterogjene dhe në shoqërinë e moshatarëve të vet. Është me rëndësi që mësimdhënësit të përdorin qasje interdisiplinare e cila bazohet në integritetin e kërkesave problemore nga fusha të ndryshme mësimore sepse ashtu nxënësit e talentuar motivohen për t'i zgjeruar dhe thelluar njohuritë.

Për nxënësit shumë të talentuar është e nevojshme të sigurohet qasja individuale që nënkupton organizimin e punës së mentorimit jashtë mësimin të rregullt.

E) VLERËSIMI I REZULTATEVE EDUKATIVO - ARSIMORE

a) Elementet e observimit dhe vlerësimit të nxënësve

Vlerësimi i rezultateve edukativo-arsimore bëhet gjatë gjithë vitit shkollor duke mbledhur dhe analizuar informata të ndryshme për zhvillimin e shkathtësive dhe njohurive, qëndrimeve dhe vlerave të përvetësuara:

- shkalla e zhvillimit të shkathtësive të komunikimit (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit);
- shkalla e përvetësimit të njohurive (në nivele të ndryshme kognitive);
- shkalla e zhvillimit të qëndrimeve dhe vlerave (ndjekja e rregullt e orës, kryerja e rregullt e detyrave të shtëpisë, zelli dhe pjesëmarrja në veprimtari gjatë orës, interesimi për përmbajtje nga lënda, sipërmarrja etj.).

Elementet e vlerësimit rrjedhin nga rezultatet edukativo-arsimore dhe arritjet e të nxënësve dhe kanë të bëjnë me të gjitha domenet e nxënies. Në bazë të elementeve të dhëna, mësuesi dhe/ose aktiviteti profesional përcaktojnë kriteret e vlerësimit me të cilat bëhet vlerësimi se në çfarë niveli nxënësi ka përvetësuar arritjen e të nxënësve. Mësuesi duhet t'i informojë nxënësit për mënyrat e përcjelljes, vlerësimit dhe notimit dhe në atë mënyrë i motivon për angazhim maksimal.

b) Kriteret e përcjelljes dhe vlerësimit të nxënësve

Me kriteret e vlerësimit (notimit) bëhet vlerësimi se në çfarë niveli nxënësi e ka përvetësuar arritjen e caktuar të të nxënësve. Diferencimi i niveleve kognitive të përpunimit të përmbajtjeve bëhet duke pasur parasysh bazën e kuptimit të nxënësve faktet dhe informata në formën burimore, a i verifikon raportet ndërmjet elementeve të dijes, apo ka ndërtuar një raport autonom ndaj përmbajtjes që mëson.

Shembuj:

Krijimi i teksteve funksionale me qëllim dhe dedikim të caktuar, nga ana e nxënësve, duhet vlerësuar sipas këtyre kriterëve:

Vlerësohen:

- përmbajtja (burimësia) dhe respektimi i veçorive të stilit funksional të paraparë;
- forma;
- kompozicioni;

- respektimi i rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore;
- koherenca.

c) Obligimet e nxënësit në mësim

- angazhimi në orë gjatë realizimit të veprimtarive të planifikuara të mësimnxënies;
- paraqitja e pavarur me gojë;
- të kuptuarit e tekstit të dëgjuar dhe të lexuar;
- krijimi në mënyrë të pavarur i teksteve funksionale me qëllim dhe dedikim të caktuar;
- kryerja e detyrave të shtëpisë,
- hartimi i eseve;
- punimi i hartimeve (katër gjatë vitit shkollor);
- ardhja në shprehje gjatë punës në grup/çift dhe në diskutime.

ç) Format e observimit dhe kontrollimit

Kontrollimi i njohurive bëhet gjatë procesit mësimor dhe në fund të periudhave klasifikuese.

Observimi, pyetjet gjatë orës mësimore, fletët e punës, ushtrimet kontrolluese, testet e diagnostikimit, vlerësimi i ndërsjellë i nxënësve etj. janë disa nga format e observimit dhe të kontrollimit të arritjeve të nxënësve me qëllim për të drejtuar procesin mësimor.

Testet diagnostikuese bëhen në fillim të vitit shkollor me objektivin për të kontrolluar nivelin e njohurive të arritura dhe për të drejtuar procesin mësimor, si dhe gjatë vitit shkollor për të verifikuar çfarë suksesi kanë dhënë metodat dhe format e punës që ka përdorur mësimdhënësi. Rezultatet e testimit diagnostikues duhet analizuar në mënyrë që kjo të shërbejë si orientim për punën e mëtejshme, por ato nuk duhet notuar.

Për të ndjekur avancimin mund të përdoren teste joformale pas fushës së caktuar. Ata duhet të kenë lidhje të ngushtë me arritjet e përcaktuara të të nxënësve dhe të bazohen në tipat e detyrave dhe metodat e praktikuara në orë.

Përfshirja e nxënësve në procesin e vlerësimit mund ta përmirësojë cilësisë e punës së tij dhe të mësimit. Vetëvlerësimi ndikon që nxënësit t'i dallojnë pikat e veta të forta dhe dobësitë dhe që të formojnë gjykime të mençura lidhur me përparimin e vet. Për shembull, në një fletë vetëvlerësimi mund t'u shtrohen pyetje të cilat ua bëjnë të mundur për të menduar për suksesin e vet (p. sh. çfarë më ka pëlqyer më shumë te eseja ime, çfarë duhet ta bëj më mirë herën tjetër, besoj se kam merituar notën 5, 4, 3, 2, 1 për arsye se...). Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i paraqitjes me gojë ose të teksteve të hartuara nga nxënësit e tjerë bëhet sipas mostrave të vlerësimit që i përgatit mësimdhënësi ose në përputhje me marrëveshjen dhe në pajtim me detyrën.

Për çdo nxënës do të duhej të ekzistonte një „karton“ në të cilin mësimit do të shënonin rezultatet e të gjitha testeve – numerike dhe përshkruese. Te notimi formativ është e dëshirueshme të punohet një formular me elementet përkatëse të observimit (njohuritë – me gojë dhe me shkrim, motivimi – interesimet dhe qëndrimet për lëndën dhe shkollën, shprehjet e punës – detyrat e shtëpisë, puna e pavarur, shfrytëzimi i burimeve etj.).

Të vlerësuarit e nxënësit në **domenin kognitiv** do të pasonte taksonominë e reviduar të Blumit me mënyrat adekuate të të vlerësuarit për çdo kategori:

- njohuritë (plotësimi i përgjigjeve të shkurtra në teste, detyrat e ndërlidhjes, pyetjet me përgjigje të shumëfishta);
- të kuptuarit (esetë, detyrat problemore, diskutimet në orë, pyetjet me shumë përgjigje, hartat konceptuale);
- zbatimin (detyra problemore, simulimet);
- analiza (analiza e teksteve, ushtrimet e stilit, zgjidhja e problemeve, diskutimet, esetë, veprimtaritë hulumtuese);
- evaluacioni (vështrimet kritike, detyrat problemore, diskutimet);
- projektet krijuese (dramatizimi i tekstit, projektet hulumtuese, esetë, përgatitja e prezentimve dhe panove etj.).

Në kuadrin e mësimit në gjimnaz shkalla fillestare nënkuptohet.

Realizimi i rezultateve të të mësuarit në **domenin social** mund të konstatohet përmes observimit (vëzhgimit). Mësimit në bazë të vëzhgimit të punës së nxënësit në grup dhe në çift mund ta vlerësojë a i ka zotëruar shkathtësitë themelore të komunikimit interpersonal (respektimi i rregullave, toleranca, bashkëpunimi).

Aspekte të dëshirueshme të përcjelljes dhe të vlerësimit të realizimit të rezultateve të mësimit në **domenin afektiv** janë raportimi i nxënësit dhe vëzhgimi i punës së tij nga ana e mësimit. Në këtë mënyrë mësimit e vlerëson shkollën e arritjes së qëndrimeve dhe vlerave të pranuar nga të gjithë nxënësit, përgjegjësinë, mëvetësinë e tij etj.

Vendosja e lidhjeve ndërmjet njohurive dhe shkathtësive në të tri domenet mund të observohet duke krijuar situata mësimore stimuluese, siç është organizimi i diskutimeve sipas parimit pro et contra, si nëpërmjet përmbajtjeve të cilat vetë i mbështesin, ashtu edhe duke mbajtur një qëndrim ndryshe apo edhe të kundërt i nxënësit që të vihen në pozitën e „tjetrit“.

Të vlerësuarit sumativ është vlerësimi i të mësuarit kurse mjetet e vlerësimit janë: testet, ushtrimet me shkrim, pyetja me gojë.

Vlerësimi është publik, arsyetimi i notës bëhet para nxënësve/nxënësive. Nota përfundimtare formohet në bazë të shumë treguesve për nivelin e arritjes së rezultateve edukativo-arsimore nga ana e nxënësit dhe është tregues i përparimit të nxënësit në mësim dhe në zhvillimin e shkathtësive.

Verifikimi ekstern parashihet në fundin e klasës së katërt dhe realizohet përmes testimit të standardizuar të njohurive nga fusha e gjuhës dhe letërsisë. Nxënësit, prindërit dhe mësime dhënësit kanë qasje në informata lidhur me rezultatet e testimit dhe kriteret e vlerësimit.

Ë. KUSHTET PËR REALIZIMIN E LËNDËS MËSIMORE (PËRGATITJA PROFESIONALE DHE LITERATURA)

a) Kushtet materiale

Për t'u realizuar në mënyrë cilësore lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë është e nevojshme që shkolla të sigurojë kushte të mira materiale.

Kushtet materiale nënkuptojnë mësonjëtores, kabinete cilësore dhe mjete për trajnimin e mësime dhënësit. Përveç tyre, duhet mobiluar bibliotekën e shkollës, gjegjësisht të bëhet transformimi i saj në qendër bibliotekare-informative me sallë leximi për nxënësit.

Programi nuk mund të realizohet në mungesë të kompletit adekuat të teksteve mësimore (sipas mundësisë edhe manualit të mësime dhënësit). Në lëndën mësimore gjuhë shqipe dhe letërsi teksti mësimor është mjet për të mësuar dhe për të studiuar në të cilin nxënësi zhvillon veprimtaritë gjuhësore të marrjes (të dëgjuarit dhe të lexuarit) dhe të prodhimit (të folurit dhe të shkruarit) prandaj edhe i përmban.

Burimet e të mësuarit duhet të jenë të ndryshme, të arritshme për të gjithë nxënësit në procesin mësimor dhe të harmonizuar (në përputhje) me rezultatet edukativo-arsimore dhe arritjet e të nxënësit. Në procesin mësimor duhet të kombinohen resurse të ndryshme për të mësuar:

- vizuale (materiale të shtypura, fotografi);
- auditive (audio regjistrime);
- audio-vizuale (film);
- interaktive (teknologjitë informative dhe të komunikimit (ICT) – kompjuteri, tabela e “mençur” etj.).

Përmbajtjet jashtë mësonjëtores kanë të bëjnë me realizimin e shëtitjeve, ekskursioneve, vizitave në teatër, kinema dhe në institucionet e kulturës, organizimin e tribunave me shkrimtarë dhe autorë të ndryshëm, pjesëmarrja në punëtori përmbajtjesh të ndryshme, përmbajtjet e internetit (portalet kulturore) etj.

Resurset duhet të mundësojnë stile të ndryshme të të mësuarit, pastaj do të jenë më efektive nëse janë zgjedhur në bazën e funksionit që duhet ta kenë dhe në kuadrin e programit mësimor dhe në bazë të shkallës së ndikimit në motivimin e nxënësit.

b) Profili dhe përgatitja profesionale e mësimitdhënësit

Mësimin nga gjuha shqipe dhe letërsia mund ta realizojnë mësimitdhënësit/mësimitdhënëset që kanë mbaruar studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe, për gjuhë shqipe dhe letërsi. Diplomat nga universitetet e vendeve fqinje duhet më parë të nostrifikohen nga shërbimet kompetente, në pajtim me Ligjin e gjimnazit.

Kompetencat që duhet t'i ketë mësimitdhënësi i cili e realizon programin kanë të bëjnë me kompetencat kryesore të realizimit të procesit të të nxënimit dhe të mësimitdhënies, me pjesëmarrësit në atë proces dhe kontekstin në të cilin zhvillohet. Në pajtim me standardet e kompetencave për mësimitdhënësit përmendim siç vijon:

1. 1. NXËNËSIT DHE PROCESI MËSIMORI/ TË NXËNIMIT – Mësimitdhënësi i kupton aspektet njohëse, sociale, gjuhësore, emocionale dhe fizike të procesit mësimor, i njeh dallimet individuale ndërmjet nxënësve (përfshirë nxënësit me nevoja të posaçme arsimore) dhe i respekton gjatë planifikimit dhe organizimit të mësimin në mënyrë që të jetë në përshtatje me karakteristikat, nevojat dhe mundësitë e tyre zhvillimore; vendos pritshmëri të mëdha të cilat frymëzojnë, motivojnë dhe paraqesin një sfidë për nxënësit; promovon përparimin dhe është i orientuar te arritjet e të nxënimit të nxënësve.

2. MJEDISI EFEKTIV DHE I SIGURTË I TË NXËNIMIT - Mësimitdhënësi është i aftë të krijojë një mjedis të sigurtë dhe stimulues për të mësuar, që bazohet në respektin e ndërsjellë, pritjet e mëdha në raport me sjelljen dhe arritjet e nxënësve, ndërsa e karakterizon të mësuarit aktiv, nxitja dhe mbështetja e interesimeve të nxënësve dhe interaksioni social pozitiv; e kontrollon orën me zotësi, duke e drejtuar në mënyrë efektive sjelljen e nxënësve me qëllim të sigurimit të një mjedisi të qetë dhe stimulues për të mësuar.

3. NJOHJA E PROFESIONIT DHE E PROGRAMIT TË LËNDËS - Mësimitdhënësi e njeh mirë profesionin e vet dhe veprimet njohëse në kuadrin e tij; e njeh mirë programin e lëndës; i kupton termat dhe nocionet kryesore, marrëdhënien dhe klerarkinë e tyre, specifikat e lëndës, çështjet dhe diskutimet aktuale brenda profesionit, si dhe gabimet e shpeshta në të kuptuar dhe gabimet tipike të nxënësve.

4. NJOHJA E METODIKËS SË LËNDËS – Mësimitdhënësi i njeh dhe i zbaton praktikatat didaktike bashkëkohore (kombinimet e metodave mësimore dhe teknikave të punës, format e punës etj.) në mënyrë që nocionet dhe njohuritë e programit t'i bëjë të kapshme, të kuptueshme dhe të mundshme për të mësuar dhe për zhvillimin e personalitetit/karakterit të nxënësit; i inkurajon nxënësit për të kuptuar, verifikuar dhe analizuar idetë nga perspektiva të ndryshme, për të kuptuar nocionet/konceptet në mënyrë të drejtë, si dhe për t'i zbatuar njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në situata konkrete; përdor burime të ndryshme dhe teknologji arsimore në mënyrë adekuate dhe efektive.

5. PLANIFIKIMI DHE PËRGATITJA E MËSIMIT – Mësimitdhënësi e planifikon mësimin, në nivelin vjetor dhe mujor, në pajtim me programin arsimor në fuqi, duke respektuar aftësitë, nevojat dhe njohuritë e mëparshme, në mënyrë që të arrihet përparim në mësim dhe të realizohen arritjet e përcaktuara të të nxënimit; planifikon rregullisht dhe në hollësi orët e strukturuar mirë;

planifikon në nivelin e vitit dhe të muajit zhvillimin e shkathtësive socio-emocionale dhe shkathtësive të shekullit 21, në përputhje me programin arsimor në fuqi.

6. VLERËSIMI DHE NOTIMI – Mësimdhënësi përdor në vazhdimësi dhe në mënyrë efektive vlerësimin formativ dhe sumativ për të mbështetur, arsyetuar dhe dokumentuar procesin mësimor; u ofron nxënësve rregullisht dhe me kohë *informata kthyes* për arritjet në të mësuar, i inkurajon për të bërë vetëvlerësimin dhe caktimin e qëllimeve të të mësuarit vetjak; di t’i analizojë të dhënat e fituara në bazë të verifikimit intern dhe ekstern të njohurive, shkathtësive dhe të të kuptuarit dhe i përdor për avancimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënës.

7. NGRITJA PROFESIONALE – Mësimdhënësi i përkushtohet mësimin gjithëjetësor, i thellon në kontinuitet njohuritë e veta profesionale, metodike dhe të tjerat dhe merr mbi vete përgjegjësinë për pjesëmarrje në veprimtaritë e ngritjes profesionale; në vazhdimësi e vetëvlerëson punën e vet, reflekton për të, në bazë të dëshmimeve të mbledhura dhe avanco praktikën e vet, vendos dhe ruan raportet profesionale, merr pjesë në mënyrë aktive në punën e rrjeteve profesionale, përpiqet të bashkëpunojë me kolegët në shkollë dhe në bashkësinë e gjerë profesionale.

8. LIDERIZMI DHE BASHKËPUNIMI - Mësimdhënësi ka rolin udhëheqës në procesin mësimor dhe i shfrytëzon të gjitha mundësitë për të siguruar përparimin e nxënësit; kërkon në mënyrë aktive mënyrat për vendosjen e bashkëpunimit të mirë me nxënësit, prindërit/kujdestarët, kolegët dhe bashkësinë vendore.

c) Lista kornizë e literaturës

I. Në gjuhën shqipe:

1. Aliu, Ali: Teori e letërsisë (ribotim i plotësuar), botoi: Vatra, Shkup, 2001.
2. Beci, Bahri: Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, SHB Dituria, Tiranë, 2002.
3. Beci, Bahri: Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë, 2004.
4. Berisha, Anton: Shumësia kuptimore, Rilindja, Prishtinë 1990.
5. Bishqemi, Prof. as. Dr. Astrit, Histori e letërsisë botërore për fëmijë, Sejko, Elbasan, 2006.
6. Bishqemi, Prof. as. Dr. Astrit: Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj - Dy lindje dhe dy perëndime, Tiranë, 2008.
7. Bishqemi, Prof. as. Dr. Astrit: Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, Sejko, Elbasan, 2004.
8. Dodi, Anastas: Fonetika: dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2004.
9. Grup autorësh: Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2006.
10. Grup autorësh: Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.
11. Grup autorësh: Historia e letërsisë shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1989.
12. Grup autorësh: Mësimdhënësi, shkolla dhe shoqëria, Prishtinë, 1997.
13. Grup autorësh: Studio gjithçka, arsyes vendin e parë, Tiranë, 1998.
14. Grup autorësh: Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, Tiranë, 1998.

15. Elsie, Robert: Historia e letërsisë shqipe, botimi i dytë, botoi: Dukagjini, Tirana & Peja 2001.
16. Hamiti, Sabri: Vetëdija letrare, Rilindja, Prishtinë, 1989.
17. Ismajli, Rexhep: Gjuhë dhe etni, Rilindja, Prishtinë, 1991.
18. Memushaj, Rami: Shqipja standarde, Botimet TOENA, Tiranë 2004.
19. Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003.
20. Qosja, Rexhep: Histori e letërsisë shqipe, Romantizmi I, II, III, Rilindja, Prishtinë, 1984-1986.
21. Rrahmani, Zejnullah: Teoria e letërsisë, Fakulteti Filologjik, Prishtinë, 1996.
22. Solar, Milivoj: Teoria e letërsisë, Prishtinë, 1978.
23. Sopaj, Nehas: Letërsia për fëmijë, Shkup, 2007.
24. Shamku – Shkreli, Ledi: Standard dhe neostandart, botoi: Çabej, Tiranë, 2007.
25. Shkodra, Faik: Letërsi për fëmijë - nga fillimet deri sot, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2002.
26. Shkurtaç, Gjovalin: Si të shkruajmë shqip, Tiranë, 2013.
27. Shkurtaç, Gjovalin: Urgjencë gjuhësore, Tiranë, 2016.
28. Velek R./ Voren O.: Teoria e letërsisë, Prishtinë, 1982.
29. Vinca, dr Agim: Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980), Rilindja, Prishtinë, 1985.
30. Zeneli, Isuf: Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim, Prishtinë, 2003.
31. Zheji, Prof. Gjergj, Xhafka, Prof. as. dr. Natasha: Fjalor enciklopedik letrar, Tiranë, 2001.
32. Zheji, Prof. Gjergj, Xhafka, Prof. as. dr. Natasha: Komenti letrar (në ndihmë të mësuesve), Tiranë, 1998.

II. Në gjuhën malazeze:

1. Bagić, K.: *Rječnik stilskih figura*, Školska knjiga, Zagreb, 2012.
2. Bahtin, Mihail: *O romanu*, Nolit, Beograd, 1989.
3. Bart, Rolan: *Književnost, mitologija, semiologija*, Nolit, Beograd, 1971.
4. Biti, Vladimir: *Pojmovnik suvremene književne teorije*, Matica hrvatska, Zagreb, 1997.
5. Ejhenbaum, Boris: *Književnost*, Nolit, Beograd, 1972.
6. Gadamer, Hans Georg: *Istina i metoda*, Logos, Veselin Masleša, Sarajevo, 1978.
7. Jaus, Hans Robert: *Estetika recepcije*, Nolit, Beograd, 1978.
8. Juvan, Marko. *Nauka o književnosti u rekonstrukciji: uvod u savremene studije književnosti*, prevod sa slovenačkog: Miljenka Vitezović, Službeni glasnik, Beograd, 2011.
9. Kajzer, Wolfgang: *Jezičko književno djelo*, Književna misao, Beograd, 1973.
10. Kristal, D.: *Enciklopedijski rečnik moderne lingvistike*, Nolit, Beograd, 1988.
11. Kristal, Dejvid: *Kembrička enciklopedija jezika*, Nolit, Beograd, 1996.
12. Kompanjon, Antoan: *Pet paradoksa modernosti*, Institut za crnogorski jezik i književnost, Podgorica, 2012.
13. Lešić, Z.: *Jezik i književno djelo*, Zavod za izdavanje udžbenika, Sarajevo, 1971.
14. Lešić, Zdenko, *Teorija književnosti*, Beograd, Službeni glasnik, 2010.
15. Lotman, Jurij: *Zapažanja o umetničkom prostoru*, *Književna kritika*, Beograd, jul-avgust, 1989.
16. Marinković, S.: *Metodika kreativne nastave srpskog jezika i književnosti*, Kreativni centar, Beograd, 1995.

17. Meletinski, E.M.: *Poetika mita*, Nolit, Beograd, s.a.
18. Milosavljević, Petar: *Metodologija proučavanja književnosti*, Trebnik, Beograd, 2000.
19. Jovanović, N., Bajković, R.: *Podrška darovitim učenicima*, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva, Podgorica, 2014.
20. Oraić Tolić, Dubravka: *Teorija citatnosti*, Grafički zavod Hrvatske, Zagreb, 1990.
21. Petković, Novica: *Od formalizma ka semiotici*, BIGZ, Beograd, 1984.
22. Popović, Dušanka: *Čitati, razumjeti, znati*, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva, Podgorica, 2014.
23. *PISA 2012 – Crna Gora, preliminarni izvještaj*, Ispitni centar Crne Gore, Zavod za školstvo, Podgorica, 2013.
24. *PISA 2015. u Crnoj Gori*, rezultati, Ispitni centar Crne Gore, Podgorica, 2017.
25. *Polazne osnove za izradu strategije razvoja informacione i medijske pismenosti kroz mrežu biblioteka*, (2016-2020), Nacionalna biblioteka „Đurđe Crnojević, Cetinje, 2015.
26. Rosandić, D.: *Metodika književnog odgoja*, Školska knjiga, Zagreb, 2005.
27. Solar, Milivoj: *Povijest svjetske književnosti*, Institut za crnogorski jezik i književnost, Podgorica, 2012.
28. Sosir, Ferdinand: *Opšta lingvistika*, Nolit, Beograd, 1977.
29. Šklovski, Viktor: *Energija zablude*, Prosveta, Beograd, 1981.
30. *Teorija filma*, priredio Dušan Stojanović, Nolit, Beograd, 1978.
31. Turković, Hrvoje, *Razumijevanje filma*, Grafički zavod Hrvatske, Zagreb, 1988.
32. Uspenski, Boris: *Poetika kompozicije Semiotika ikone*, Nolit, Beograd, 1979.
33. Vuković, N.: *Uvod u književnost za djecu i omladinu*, Unireks, Podgorica, 1996.

Programin e lëndës mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin I, II, III dhe IV të gjimnazit të përgjithshëm e ka punuar **Komisioni** në përbërjen:

Dr. Haxhi Shabani, kryetar

Mr. Anton Gojçaj, Enti i Shkollimit, Podgoricë, anëtar

Ma. Sehad Lulanaj, Gjimnazi “25 maj”, Tuz, anëtar

Gjatë hartimit të programit të lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi janë shfrytëzuar programet e kësaj lënde mësimore (2004, 2009, 2011 dhe 2013) dhe *Udhëzimi metodologjik për hartimin e programeve që bazohen në rezultatet e të mësuarit, 2017.*